


BIBLIOTEKA

929

V48

BIBLIOTEKA PEDAGOGJIKË



MYSLIM ISLAMI

NAUM PANAJOT BREDHI

VEQILHARXHI

U dorëzua për shtyp në mars 1967. Doli nga shtypi në prill 1967.

Tirazhi: 3000 kopje

Formati 78 x 109/32

Stash: 2204-65

Shtypur në N.I.S.H. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» — Tiranë



NAUM P. VEQILHARXHI

Naum Panajot Bredhi, i mbiquajtur Veqilharxhi, patriot i madh, iluminist dhe demokrat i shquar i shekullit XIX, njihet tashmë si ideologu i parë i lëvizjes shqiptare të çlirimit kombëtar dhe si flamurtari i parë i periudhës së Rilindjes sonë kombëtare, që zuri fill aty nga vitet 40-të të shekullit të kaluar. Me gjith atë, duhet pranuar se për jetën dhe veprimtarinë e tij mjerisht të dhënat janë shumë të pakta. Naum Veqilharxhi i takon atij numri njerëzish të shquar, për të cilët ne dimë më shumë rreth veprave që kanë dalë nga duart e tyre se sa për jetën dhe veprimtarinë që kanë zhvilluar jashtë këtyre veprave. Burimet historike dokumentare apo letrare, që do të na jepnin dorë të njihnim në mënyrë të kënaqëshme jetën dhe veprimtarinë e patriotit të madh vithkuqar, mund të themi se janë jashtëzakonisht të varfëra. Kjo varfëri e theksuar përbën padyshim një pengesë serioze për një punim, që synon të pasqyrojë në mënyrë të plotë veprimtarinë politike, shoqërore, kulturele, letrare dhe të analizojë në mënyrë të saktë veprimtarinë e gjithanëshme të Naum Veqilharxhit.

Në këtë punim jemi përpjekur të japim të dhëna rreth jetës dhe veprimtarisë së Naum Veqilharxhit. Në disa raste na është dashur të formulojmë ndonjë supozim, duke u nisur nga disa pikëmbështetje të pamjaftueshme për një tezë të shtruar. Me gjithë atë, u lutemi lexuesve ta konsiderojnë këtë punim si një hap të parë për një punim në të ardhmen, më të gjërë dhe më të shëndoshë për flamurtarin e parë të Rilindjes Kombëtare Shqiptare.

E ndjej për detyrë, me këtë rast, të falenderoj profesor Aleks Budën për ndihmën dhe përkrahjen që më ka dhënë për hartimin e kësaj monografie. Gjithësehtu falenderoj edhe shokun Dhimitër Fullani për sugjerimet dhe vërejtjet që më ka bërë.

HYRJE

GJENDJA E SHOIPËRISË NË 30 VJETËT E PARË TË SHEKULLIT XIX

Për ta patur më të qartë rolin e shquar, që ka lojtur kjo figurë në lëvizjen politike-kulturale të popullit tonë, është e nevojshme të paraqitet, së pari, një kuadër i rrethanave politike-shoqërore të vendit tonë në vitet kur filloi aktivitetin e vet Naum Veqilharxhi.

Që prej tre shekujsh e gjysëm po rëndonte mbi shpatullat e popullit tonë zgjedha e rëndë e osmallinjve, që pati rrjedhime shkatërrimtare dhe bëri që Shqipëria të mbetej një nga vendet më të pazhvilluara në Europë. Regjimi i feudalizmit ushtarak tashmë e kishte kaluar kohën e tij. Në një kohë kur në Europë ishin kryer një varg revolucionesh borgjeze dhe po kryhej revolucioni industrial, klasa sunduese feudale e perandorisë, e paaftë për reforma rrënjësore, kënaqej me disa reforma gjysmake e të përcipta, të cilat ndryshonin vetëm pamjen e jashtme administrative të perandorisë.

Borgjezia turke ende nuk ishte formuar plotësisht si klasë që të mund t'u jepte lëvizjeve që shpërthenin në këto vite një drejtim dhe program të përcaktuar dhe të qartë.

Në perandori mbizotronte prapambetja ekonomike, politike dhe kulture, gjendje e cila bëhej gjithmonë e më shumë një pengesë për zhvillimin e popujve që përfshiheshin në të. Ky kalbëzim i Perandorisë otomane pasqyrohej edhe në Shqipëri, në të gjitha fushat e jetës, si në ekonomi, administratë, kulturë dhe arësim. Kjo

tatëpjetë vërtetohet edhe nga fakti se popullsia grabitej dhe shfrytëzohej nga lloj lloj taksash dhe detyrimesh, nga shërbimi shumëvjeçar dhe i rëndë ushtarak, që i hiqte tokës krahë pune të shumtë, nga ekspeditat e vazhdueshme grabitqare dhe ndëshkimore, nga anarkia dhe zullumi në sistemin administrativ, që ishte i bazuar në unitete të vogla ekonomike të pa lidhura; mbi këto shtoheshin edhe pasojat shkatërrimtare që rodhën nga shkak i vartësisë së perandorisë së prapambetur turke nga shtetet kapitaliste më të zhvilluara dhe më të përparuara të Europës, të cilat filluan ta kthejnë atë në një gjysmëkoloni dhe mbi popujt që përfshiheshin në këtë perandori filloi të rëndoje barra e një shfrytëzimi të dyfishtë.

Gjendja e rëndë u duk edhe në fushën e arësimit dhe të kulturës. Përveç rrezikut të turqizimit, popullin tonë e kërcënonte dhe rreziku i helenizimit, pasi Porta e Lartë, duke dashur të përdorte fenë për qëllimet e saja politike, lejonte që edhe Patrikana t'i cilësonte ortodoksët shqiptarë «grekë». Kjo e fundit, që t'i greqizonte këta, hapi shumë shkolla në gjuhën greke në Shqipërinë e Jugut. Në Veri i zellshëm për hapjen e shkollave u tregua Vatikani, i cili përpigëj që, nëpërmjet kishës katolike dhe shkollës së saj, të shtonte ndikimin e vet në këtë teritor, për realizimin e qëllimeve të tij.

Regjimi otoman ishte regjim i obskurantizmit të plotë në kulturë. Gjuhë kulture ishin arabishtja, greqishtja, turqishtja, pa lidhje me gjuhën e traditat kulturore të popullit tonë.

Sundimi shekullor në fakt solli varfëri, prapambetje, vuajtje, por në asnjë mënyrë nuk mundi të zhdukë përpjekjet për liri, qëndresën kundër çdo orvatjeje asimilimi dhe çkombëtarizimi. Shtypja e egër ekonomike dhe politike u bë shkak që në Shqipëri, si dhe në vendet e tjera të Ballkanit, të zhvilloheshin një varg lëvizjesh.

Të shumta janë faktet që vërtetojnë se, shpesh herë, kushtet e jetës nën të njëjtin regjim shtypës bëhen bazë e një bashkëpunimi luftarak të popujve të robëruar kundra të njëjtit armik; ky bashkëpunim politik del qartë në marrëdhëniet midis antarëve të vëllamërive të

vendeve ballkanike. Në «hymnin luftarak» të rrethit të Rigas Fereos (Velenshtinliut) thuhet:

*«Bullgarë dhe shqiptarë
Sërbë dhe Romej
Banorë të ishujve dhe të steresë
Me një vrull të përbashkët
Për lirinë
Të çveshim shpatat(1)*

Ky bashkëpunim luftarak u çfaq më me forcë gjatë revolucionit antiturk dhe antifeudal në provincat e Danubit në vitin 1821, në revolucionin grek më 1821 dhe gjatë përlëshjeve serbo-malazeze kundër turqve. Por, prapa këtij solidariteti filluan të nxjerrin krye synimet shoviniste të qarqeve borgjeze greke, të fanariotëve dhe të forcave reaksionare, të cilat idetë e të drejtave të barabarta të popujve ballkanas filluan t'i mbysin me dogmën e tyre të vazhdimësisë së helenizmit antik.

Më së miri i ka stigmatizuar këto synime shoviniste revolucionari demokrat bullgar H. Botev, i cili shkruan: «Greqia, që nga çlirimi i saj e deri në ditët tona, nuk është marrë me gjë tjetër veçse me ëndërimë për një farë Perandorie Bizantine, e cila duhej të përfshinte në kufijtë e vet më shumë se gjysmën e Gadishullit Ballkanik. së bashku me kryeqytetin e saj të mëparëshëm dhe me brigjet e detit të Zi dhe atij Adriatik. Ajo ka parë, bile dhe sot sheh, të Shqipëria, Maqedonia dhe Thraka provincat e saj të ardhëshme...»(2).

Kur tek popujt e tjerë të Ballkanit po piquej ndër-gjegja kombëtare, në Shqipëri zhvillimi i kësaj ndër-gjegje u vonua për shkak të gjendjes së keqe ekonomike, nga përçarja fetare, mungesa e shkollës dhe e librit shqip dhe nga prapambetja në fushën e kulturës.

Lëvizjet kundra sundimit otoman në Shqipëri kanë qenë të pandërprera, por duke filluar nga vitet 30 të

1) J. Irmischer — Shqiptarët në themelimin e shtetit grek, në librin — Konferenca e parë albanologjike, Tiranë 1962, ff. 509-510.

2) H. Botev — publicistika, Moskë, 1952, f. 156.

sheskullit XIX këto po rriteshin dhe po qartësoheshin gjithmonë e më shumë, sepse në vendin tonë po zhvilloheshin premiset e reja ekonomike shoqërore, po lindnin marrëdhëniet kapitaliste. Lidhja e ekonomisë së çifligarëve dhe fshatarëve me tregun shtohet gjithmonë më shumë për shkak të nevojave për prodhime bujqësore që kishin qytetet dhe eksporti. Ndryshimet në ekonominë bujqësore i dhanë zhvillim prodhimit zejtar të mallrave, filloi shfrytëzimi i punës me mëditje. Rritja e lidhjeve monetare e pakësonte izolimin e krahinave, qendrave dhe ndihmonte në formimin e tregut të përbashkët. Qendra më rëndësi ekonomike e politike u bënë Janina, Elbasani, Prizreni, Shkodra, Berati etj., ku u zhvillua, në kushtet e reja, borgjezia vendase. Ndihej në zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste edhe pozita gjeografike e Shqipërisë, si krahina më perëndimore e perandorisë, në skelat e së cilës hynin vazhdimisht mallra të ardhura nga Europa kapitaliste. Si rrjedhim, borgjezia tregëtare shqiptare filloi t'i lidhë interesat e veta me tregun ndërkombëtar dhe të lozë rolin e përçueses së ndikimit perëndimor në Shqipëri dhe në brendësi të perandorisë.

Në këto kushte fillojnë të çfaqen edhe elemente të reja në lëvizjen kryengritëse dhe politike-kulturale në Shqipëri, megjithëse në kompleks ato mbeten, s'gjithmonë, lëvizje spontane të paorganizuara si duhet të paqarta dhe me karakter lokal.

Në këto vite filluan të duken shënjat që tregonin se disa ide po përvetësoheshin nga masat e gjera popullore, megjithëse në mënyrë më të qartë këto u dukën tek një pjesë e elementeve të dalë nga radhët e tregëtarëve dhe zejtarëve, të cilët kishin kontakte më të shpeshta me botën e jashtme. Filluan të hyjnë në Shqipëri idetë e reja që lidheshin me rrymat më të përparura të kohës. Pa dyshim ndikuan dhe ndryshimet e rëndësishme politike që po thelloheshin në këtë kohë në vendet fqinje të Shqipërisë si dhe në vetë Perandorinë Turke. Më 1816 serbët formuan principatë autonome, më 1828 u bënë autonome dhe principatat e Vllahisë dhe Moldavisë, ndërsa më 1829 Greqia fitoi pavarësinë.

Për të rimëkëmbur fuqinë e perandorisë dhe për të shpëtuar nga procesi i thellë i dekompozimit social politik, i shtyrë nga Anglia dhe Franca, më 3 nëndor 1839 sulltani i ri Abdyl Mexhiti shpalli «Hati-sherif-in» (dekretin e shenjtë) të Gjylhanesë. «Çereku i dytë i shekullit XIX dallohet nga dy ngjarje të rëndësishme: nga shpallja e Tanzimatit, që i hapte rrugën zhvillimit borgjez të Perandorisë turke dhe, si pasojë e zbatimit në vendin tonë të reformave të Tanzimatit, nga kryengritjet e vazhduara që filluan në vitin 1833 dhe që arritën kulmin më 1847»(3).

Zbatimi me dhunë i Tanzimatit solli në fuqi një administratë, e cila mund të dallohej nga format, por jo nga përmbajtja, prej administratës së vjetër grabitqare.

K. Marksi shkruante: «...padituria, paturpësia, grabitjet e tyre mbetën po ato që kishin qenë në lulëzim të arbitrariseteve të satrapëve aziatikë»(4).

Sulltani nuk shpejtoi të vinte në zbatim menjëherë Hati Sherifin e Gjylhanesë në Shqipëri, ku Porta e Lartë hasi më shumë se kudo rezistencë. Në këtë kohë në Shqipëri kryengritjet drejtoheshin kundër taksave, grabitjeve, nizamit e në disa raste shihen edhe elemente të luftës antif feudale.

Lëvizjet vuanin nga ana e organizimit dhe programit politik, nga prapambetja që kufizonte perspektivën për të kuptuar arësyet e thella të kësaj gjëndjeje e, mbi të gjitha, për shkak të mungesës së udhëheqjes. Me gjithë atë, ana pozitive e këtyre lëvizjeve të gjëra popullore ishte e madhe: ato jo vetëm tregonin armiqësinë e madhe të masave të gjëra të popullit kundrejt pushtuesit shekullor, por edhe forcën, masivitetin, rezistencën dhe sukseset e përkohëshme të fshatarësisë sonë të shumëvujtur.

Shtresa së cilës i përkiste të mendonte më seriozisht për organizimin e këtyre lëvizjeve dhe për ta udhë-

3) S. Pollo — Mbi formimin e kombit shqiptar dhe lëvizjen nacionale shqiptare, në Buletinin e Shkencave shoqërore 2 (1953) 32-49.

4) K. Marksi dhe F. Engels, Veprat, botimi i parë rus, vëll. X f. 656.

hequr këtë forcë të madhe në fitore ishte borgjezia e re shqiptare, e cila po hidhte hapat e para të formimit të saj në këtë periudhë dhe s'mundi të frymëzojë dhe të veprojë si borgjezia greke dhe serbe. Me gjithë atë, disa përfaqësues më të përparuar të mendimit shoqëror në Shqipëri, që e kuptonin se kështu nuk mund të vazhdohej, duke parë si arsye themelore prapambetjen e popullit shqiptar dhe mungesën e arësimit dhe të kulturës, filluan të mendoheshin për nevojën e lëvrimit të gjuhës shqipe.

Më i avancuari nga këta, që e shtroi çështjen në mënyrë programatike dhe në një shkallë më të lartë, duke u mbështetur mbi një platformë më të përparuar, qe Naum Veqilharxhi. Ky u bë ideologu i parë i lëvizjes kombëtare, për të cilën, tashmë, qenë pjekur kushtet.

**RINIA
E NAUM P. VEQILHARXHIT —
PJESËMARRJA
NË RËVOLUTIONIN E VITIT 1821**

Së shpejti pema do të japë frut

Naum Veqilharxhi

Në veprën e parë, që njohim, të rilindasit të shquar, me titull: «*Fort i shkurtër e i përdorçim Ëvetar shqip*» (5), pirografuar më 1844, ndeshim me emrin e plotë dhe datelindjen e saktë të autorit. Në kopertinën e shkruar greqisht autori e ka shenuar emrin «Naum P. Veqilharxhi nga Bythkuqi i Kolonjës». Fill pas kopertinës është ngjitur një fletë me portretin e autorit në gravurë, i vetmi portret që njohim, nën të cilin është shkruar shqip: «Naum Panajot Veqilharxhi, pjellë mbë 1797, mbe 6 të Dheqembrit». Tek frontespici, përkundrazi, nën titullin e plotë të veprës, emri i autorit është shënuar në këtë mënyrë: «Naum Panajot Haxhi Llazar Bredhi që i thonë edhe Naum Veqilharxh nga Bythkuqi i Kolonjes. Në botimin e dytë të abetarit të shtypur më 1845 me titull «*Fare i ri Ëvetar shqip për dielm nismëtare*» (6) Autori ka nënshkruar «Naum P. Veqilharxhi Brednasi nga Bythkuqi i Kolonjës». Nga këto të dhëna del se emri i vertetë i rilindasit ishte *Naum Panajot Haxhi Llazar Bredhi*. Panajot ishte emri i të jatit. Llazar quhet gjyshi i tij, i cili kishte kryer haxhillëkun në Jeruzalem, udhëtim që i kishte dhënë atij të drejtën e titullit «haxhi», pra haxhi Llazar. Bredhi është emri i lagjes së fshatit Vithkuq, emër i cili ruhet edhe sot dhe

5) Këtëj e tutje Ëvetari i vitit 1844 do të quhet *Ëvetari i parë*
6) Më tej do të quhet *Ëvetari i dytë*

që ka shërbyer edhe si mbiemër për familjen(7). Bythkuqi është emri i vjetër i fshatit Vithkuq, etnografikisht pjesë e krahinës së Kolonjës, kurse administrativisht brenda kufijve dikur të sanxnakut, kurse sot të rrethit të Korçës. Nga këto të dhëna del gjithashtu se qysh në kohën e vet, rilindasi ynë njihej me shumë me emrin Naum P. Veqilharxhi. Ketë version e pohon edhe një nga nxënësit më të hershëm të Ëvetarit, Spiro Risto Dine, i cili shkruan se në vitin 1854 ai pa për të parën herë djemtë e shkollës së fshatit Trebickë (8) «me nga një abetare, bërë prej Naum Bredhit, të cilin më të shumtët e dinin me emrin Naum Veqilharxhi...»(9). Mbiemëri Veqilharxh është turqisht, është titull ofiqi dhe do të thotë intendent. Nga shënimi që ndodhet nën gravurën e autorit mësojmë datëlindjen e rilindasit të shquar. Muaji dheqember është dhjetori. Data 6 duhet të jetë sipas kalendarit julian, që perdorej në mbarë zonën e kishës lindore, duke përfshirë edhe Rumaninë, ku mendohet se është pirografuar Ëvetari i parë. Sipas kalendarit tonë i takon 17 dhjetor 1797. Shënimi i vënë në të dy Ëvetarët «nga Bythkuqi i Kolonjës» dhe kujtimet e transmetuara që ruajnë akoma sot pleqtë e moçëm vithkuqarë, tregojnë se vendi ku Naumi lindi dhe u rrit ishte Vithkuqi.

Nga sa u tha, mund të arimë në përfundim se Naum P. Veqilharxhi, biri i Panajot Llazar Bredhit, lindi në Vithkuq më 17 dhjetor 1797.

Vithkuqi është ngritur në një pllajë me brigje të bukura, nga të cilat burojnë shumë ujra të ftohta, është rrethuar nga male që shumë vjet më parë kanë qenë të veshura me pyje të dendura. Përfund tij rrjedh lumi Osum, Vithkuqi sot është një fshat rreth 30 kilometra në jug-perëndim të qytetit të Korçës.

Në kohën kur lindi dhe u rrit Naum Veqilharxhi Vithkuqi ishte një qytet i vogël, por i lulëzuar. Panajot

7) Shumë familje në Vithkuq edhe sot gëzojnë si mbiemra emrat e lagjeve të dikurshme si: Shore, Jano, Strati etj.

8) Fshat në thellësi të malësisë së Vithkuqit.

9) Spiro Risto Dine, Valët e detit, Sofje 1908, ff. 19-20.



Pamje nga Vithkuqi

Aravantinoj në veprën «Hronografia tes Epeirou», vëllimi II, botuar më 1854, shkruan se Vithkuqi ka patur, para se të rrënohej, pesëmijë familje(10). Numri është sigurisht i tepëruar, me gjithë atë, është jehonë e faktit se Vithkuqi dikur ka qenë një qytet. Në një shënim kronikal të vënë në Kodikun e Mitropolisë së Korçës e të Selasforit me datën 1879 thuhet se «Vithkuqi para njëqind vjetëve (domethënë rreth vitit 1779 M.I.) numëronte rreth 8000 banorë»(11). Që ka patur madhësinë e një qyteti e dëshmojnë: hapësira që zenë gërmadhat e shtëpive të rrënuara, lagjet e shumta të dikurshme (12), që ruajnë edhe sot emrat e tyre, numri i madh i kishave(13) të ngritura sidomos në shekullin XVIII, bashkë me to edhe egzistenca e dy manastireve, që qëndrojnë edhe sot (manastiri i Shën Pjetrit dhe manastiri i Shën Minait). Nga një shënim që përmban kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit kuptohet se Vithkuqi ka qenë në shekullin XVIII seli e një mitropolie kishëtare, e cila kishte nën varësinë e vet kishat e krahinës së Kolonjës, kurse vetë Mitropolia e Vithkuqit

10) P. Aravantinos — Hronografia tes Epeirou, vëll. II, Athinë, 1854, f. 113.

11) P. Pepo — Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit, Tiranë, 1967, (dorëshkrimi f. 334 Dokumenti 197).

12) P. Pepo — Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit, Tiranë 1967 faqe 645 Dok. 197). «Dokumenti i shkruar më 17 gusht 1792, shënohen këto mëhallë të Vithkuqit: Borishë, Llasi, Qyrsa, Syr bashi, Kresasi, Palasi, Kolaqerkasi, Kovaçasi, Saraçi, Rusasi, Dukasi» si dhe Bredhasi, Strataj, Shore, Janoj etj.

13) Në jugë Shëndëllia, në perëndim në malin e Rungajës Shën Pandejleimoni, në veri Shën Kostandini, Shën Vangjelizmoi, Shën Minai, në lindje Shën Thanasi. Kisha e Shën Mërisë mendohet të jetë e shekullit XVI, pra më e vjetra nga të tjerat. Kisha e Shën Gjergjit — sfondi është blu me varak pikturat janë të Kostandin dhe Athanas Zografit. Kisha e Shën Mëhillit është ndërtuar në shek. XVII (1682) datë e shkruar në një mbishkrim që ruhet mbi derën jugore të kishës. Është pikturuar në vitin (1728) dhe kjo datë ruhet në të njëjtin mbishkrim. Manastiri i Shën Pjetrit pikturuar nga Kostandin e Athanas Zografi në vitin 1764 (mbishkrimi ruhet brenda mbi derën veriperëndimore të kishës. konostasi i gdhëndur në dru shumë bukur — viti 1773 nga Kostandin Shpataraku. Kisha e Shën Kozmajit dhe Damjanojt — mbi portë ruhet mbishkrimi 1750 — 18 maj. Pikturat nga Kostandin e Athanas Zografi. Kisha e Krye-Ergjëjve, e Shën Spiridonit dhe e Shën Anargjirëve.

23173

varej nga peshkopi i Kosturit (14). Banorët e Vithkuqit ishin shqiptarë (15). Për këtë dëshmojnë si emrat e lagjeve që përmendëm më lart, ashtu edhe emrat e vjetër të banorëve të Vithkuqit, të cilët nuk kanë asnjë ngjashmëri me emrat me origjinë greke dhe vllahe (16). Ata merreshin me përpunimin e leshit, lëkurëve dhe bulmetit, sepse mbanin kopera të mëdha me dhen në malet me kullota të pasura të Sherës, Rugajës, Faqekuqit, Makrëzës e deri në malin e Ostrovicës. Në Vithkuq kishte edhe zejtarë që përpunonin drurin dhe metalet. Edhe sot, brenda kufive të fshatit, ruhet emëri i lagjes që quhej «Kovačas». Në bazë të materialeve të mbledhura nga Shoku Petraq Pepo, themi se Vithkuqarët zhvillonin tregëti jo vetëm me Voskopojën dhe Korçën fqinje, por edhe me qendrat më të largëta (Durrësin, Shkodrën, Kosturin); bile dhe me qendra të rëndësishme tregëtare të Ballkanit (Selanikun, Korfuzin) dhe të Europës (Vienën, Triestën). Të gjitha këto tregojnë se Vithkuqi kishte tiparet e një qyteti të zhvilluar për kohën edhe nga ana ekonomike.

Nga pikëpamja e zhvillimit kultural, mund të thuhet se në shekullin XVIII Vithkuqi ishte një qendër e rëndësishme. Në një raport të lëshuar më 1699 thuhet se në shkollën e Himarës, ku mësohej edhe shkrimi i shqipes nga mësues bazilianë të ardhur nga Italia, vinin

14. P. Pepo — Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit, Tiranë, 1967 (dorëshkrimi f 334. Dokumenti 197). «Me që Vithkuqi bën pjesë në juridiksionin shpirtëror të të shenjtit të Kosturit... sipas informatave ka qenë dhe mitropoli me emrin «E Vithkuqit dhe e Kolonjës».

15. Në lidhje me kombësinë e popullsisë së Vithkuqit, hodhi për një farë kohe një hije dyshimi shkrimtari dhe kronisti grek P. Aravantinos, i cili, në botimin e përmendur dhe në faqen e cituar më lart, shkruante se banorët vithkuqarë ishin me origjinë vllahe. Qysh në vitin 1860 folkloristi patriot Thimi Mitko, në një polemikë të botuar në revistën greke të Athinës «Panhora», vërtetoi me fakte bindëse se banorët e Vithkuqit nuk kanë qenë asnjëherë vllahë por thjeshtë shqiptarë. Këtë konkluzion e pranon më vonë dhe vetë P. Aravantinos.

16. S.R.Dine — Valët e Detit Sofie 1908 faqe 795 «Këta emra të vjetër që shënojnë më poshtë, i kam gjetur të shkruara në radhuan (kodikun) e kishave të Vithkuqit, të cilat kanë dhuruar ndihma, siç u ka dashur e bardha zemër, për t'u quajtur mirëbërës: Dudë, Dudi, Dila, Konxhe, Konda, Lula, Bufkë, Lilo, Vitora, Nicë, Zogë, Xinxife, Narencë, Dona, Rake, Bespinë etj.»

nxënës edhe «nga Bitulki (Biltulchi) i Shqipërisë, i cili është pesë ditë larg Himarës... dhe ka një mijë frymë» (17). Po që se kemi të bëjmë me Vithkuqin, ne mund të nxjerrim nga ky fakt konkluzionin e rëndësishëm se dashuria e Vithkuqarëve për arësimin shqip çfaqet nëpër dokumenta të paktën qysh në fund të shekullit XVII në një shkallë të tillë sa prindërit nuk nguronin t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkolla që ndodheshin pesë ditë larg rrugë më këmbë. Dashuria për kulturën përparimtare në përgjithësi dhe për shkrimin e shqipes në veçanti vërtetohet edhe më vonë.

Gjatë shekullit XVIII në Vithkuq u ngrit një shkollë në gjuhën greke (18), mbasi vetëm te tilla shkolla mund të funksiononin në krahina të cilat ndodheshin nën autoritetin kishëtar e klerikal të Patrikanës greko-bizantine të Stambollit. Arësye tjetër është se vetëm nga të tilla shkolla mund të përgatiteshin nxënës për të vazhduar studimet në «Akademine e re» të Voskopojës fqinje, e cila, siç dihet, ndodhej nën ndikimin e kulturës iluministe, por të praktikuar në gjuhën greke. Gjatë shekullit XVIII Vithkuqi ka patur një bibliotekë të pasur në Manastirin e Shën Pjetrit (19). Po në atë shekull, në qytet u ndërtuan një varg kishash, vepra të bukura arti. Kishat nga ana e tyre u zbukuruan me piktura në afreske e ikona, disa nga të cilat u punuan nga ata artistë të talentuar (Kostandin Zografi, Athanas Zografi, Kostandin Shpataraku etj.), që zbukuruan edhe kishat e Voskopojës.

Dihej se Voskopoja njohu një ngritje kulturele e arësimore qysh nga çereku i fundit i shekullit XVII, por lulëzimin e arriti sidomos në vitet 1720-1760, me ngritjen e shtypshkronjës dhe hapjen e shkollës «Akademia e re». Disa nga idetë e iluminizmit, që shënojnë kulmin me enciklopedistët francezë në shekullin XVIII hynë në Shqipëri dhe u përfaquan për herë të

17) DH.S. Shuteriqi, Shkrimi i shqipes dhe shkolla në bregdetin e Himarës gjatë shekullit XVII-XVIII, në «Mësuesi» 28 qershor dhe 5 korrik 1963.


18) E. Kurilla — Lavriotis, Studime Shqiptare Grigorios Argirokastritis, Athinë 1933.

19) E. Kurilla — Lavriotis, Po aty.

parë nga intelijenca e Voskopojës. Sistemi arësimor i Voskopojës synonte përhapjen e njohurive shkencore dhe të kulturës në përgjithësi nëpërmjet gjuhës greke. Gjithashtu, nga nevojat e përditëshme në Voskopojë është shtruar kërkesa e përdorimit të gjuhës shqipe jo vetëm në shkollë, por edhe në kisha, për të lidhur popullin më afër me shërbimet fetare. Drejtori i «Akademisë së re» Protopapë Theodor Anastas Kavalioti (1710-1789), ka qenë hartuesi i fjalorit greqisht arumanisht-shqip, inisiatori i parë për t'i dhënë kishës ortodokse në Shqipëri librat fetare në gjuhën shqipe, duke përkthyer «Dhjatën e re» etj. Në Voskopojë kishte studiuar edhe Theodor Haxhi Filipi, i cili pat hartuar një alfabet original.

Zhvillimi i arësimit, i kulturës dhe marrëdhëniet tregëtare ndihmuan në forcimin e lidhjeve midis Vithkuqit dhe Voskopojës. Vithkuqarë që kanë mësuar dhe punuar në Voskopojë ka patur shumë, por për të shënuar janë dy nga nxënësit vithkuqarë që mësuan gjatë shekullit XVIII në shkollën e famëshme të Voskopojës dhe u muarrën me lëvrimin e shkrimit të shqipes, pikërisht në kohën kur Naum Veqilharxhi ishte i ri. Njëri prej tyre ishte Jani Evstrati, i njohur më tepër me emrin Evstrat Vithkuqari, mësues shkolle për mjaft kohë në Përmet, Voskopojë, Gjirokastër, Artë dhe Janinë. Në Gjirokastër ka shkruar kodikë (regjistra me shënime të ndryshme — M.I.), në Janinë i dha mësimin e gjuhës shqipe konsullit dhe shkencëtarit anglez Uiliam Lik, me të cilin bashkëpunoi në hartimin e një gramatike shqipe dhe në përpilimin e një fjalori shqip-anglisht-greqisht, pa zënë në gojë veprën historike të hollësisht mbi «Iliadën» e Homerit (20), ndoshta dhe librin me titullin «Rregullat logjike - etike të njeriut» botuar në Athinë pas vdekjes së tij në vitin 1847. Tjetri është Dhaskal Kostë Cepi nxënës i «Akademisë së re», mësues shkolle në Berat, Vithkuq e Korçë, autor i një manuali didaktik prej 174 faqesh, i cili përmban, midis

20) W. Lik, *Travels in Northern Greece*, London 1835. f. 250 Evstrat Vithkuqari ka vdekur pas vitit 1822.



Vithkuq — pamje e lagjes Dukas (foto 1935)

të tjerave, transkriptimin e shkrimeve shqipe të Ko-standin Beratit dhe një fjalor shqip-greqisht (21).

Legjenda e njohur me emrin «Varri i pagëzimit» na jep të kuptojmë se ndjenja e shqiptarësisë është e rrënjosur thellë edhe në prindërit e Naum Veqilharxhi. Legjenda flet për një vithkuçar, kushëri i Naumit, që banonte në lagjen Dukas dhe për shpëniën e djalit të tij në kishën e Shën Mëhillit të Vithkuqit për ta pagëzuar. Gjyshi i rilindasit tonë, Llazar Bredhi apo Haxhi Llazar Bredhi, kërkoi që prifti ta kryente ritin e pagëzimit në gjuhën shqipe, në gjuhën që i fliste e ëma dhe i ati. Prifti kundërshtoi dhe nguli këmbë për formulën greqishte. Pasi prindërit nuk hoqën dorë nga dëshira e tyre, prifti fanatik fanariot i zboi nga kisha. Duke e konsideruar mëkatë të madhe mospagëzimin e fëmijës, prindërit qëndruan me orë të tëra te porta e kishës, me shpresë se mund ta bindnin priftin kokëfortë. Qe dimër i egër dhe nga cikma e madhe, foshnja e vogël u vdiq prindërve në duar. Fëmija u varros në oborrin e kishës. Edhe sot mbi gurin e varrit që ndodhet në hijen e kishës së Shën Mëhillit ruhet mbishkrimi «Varri i pagëzimit». Mbi këtë gojëdhënë, shkrimtari rilindas Mihal Grameno ka trajtuar novelën me të njëjtin titull «Varri i pagëzimit», të cilën e botoi në Korçë më 1909.

Këto hollësira u dhanë për të treguar se Naum Veqilharxhi lindi dhe u rrit në një qendër të dëgjuar dhe në një familje me tradita në fushën e kulturës në përgjithësi dhe të shqiptarësisë në veçanti. Pikërisht në këtë ambient duhen kërkuar fijet e para të veprimtarisë së mëvonëshme patriotike iluministe të birit të shquar të Vithkuqit.

* * *

Sa kohë qëndroi Naum Veqilharxhi në vendin e lindjes? Përgjigja është shumë e vështirë, mbasi nuk kemi asnjë shenjë të dokumentuar. Kemi vetëm kujtime

21) P. Pepo Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit Tiranë 1967, dorëshkrim, f 645.

të transmetuara, të cilat ruhen edhe sot nga pleqtë e moçëm vithkuqarë, që kanë lindur disa dhjetra vjet pas vdekjes së bashkatdhetarit të tyre të shquar.

Veqilharxhët e kanë pasur shtëpinë e tyre në lagjen Bredhas, gërmadhat e së cilës ndodhen në veriperëndim të fshatit, në të dalë të rrugës që të shpie në katundin Shtyllë. Plaku më i moçëm Tush Koleci na përcaktoi edhe vendin e shtëpisë së Panajot Veqilharxhit, atit të Naumit. Duke iu referuar kujtimeve të dëgjuara nga prindërit të tij, ai na dha dy njoftime me interes: se gjyshi, Llazar, dhe i ati, Panajot, ishin marrë me tregëti në Vithkuq dhe Korçë dhe se Naumi mbaroi shkollën fillore në fshatin e lindjes, në Vithkuq. Këto njoftime i pohuan dhe pleq të tjerë vithkuqarë si Sotir Kurtiqi, Nuçi Tona, Nasi Vithkuqi etj. Sipas një njoftimi tjetër me rëndësi që dëgjuam në Vithkuq, Naumi u largua nga fshati dhe shkoi në mërgim në kohën e prishjes së Vithkuqit. Vetëkuptohet se këto njoftime kanë vlerë krejtësisht relative, por në mungesë të lajmeve të dokumentuara, jemi të detyruar të kapemi edhe pas indikacioneve relative.

Vithkuqi ka pësuar jo një, po tre prishje. Rrënimin e parë e pësoi më 1781, para se të lindëte Naumi, nga spahinjtë dhe bejlerët e Radovickës dhe Koprenckës (22). Prishjen e dytë e pësoi më 1819, siç kuptohet nga kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit (23). Rrënimi i tretë ndodhi më 1823 (24). Pas kësaj, në

22) P. Pepo — Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit Tiranë: 1967 dorëshkrim f. 334 Dokumenti 197 «Më 1781 pësoi shkatërrimin e tij të parë, nga shqiptarët myslimanë, kryesisht nga ata të Koprenckës e Radovickës»

23) P. Pepo — po këtu, f. 334 Dokumenti 197 «...kurse një të dytë të tillë, e pësoi më 1819 nga myslimanët fqinjë për t'u rrëmbyer pasuritë e tyre, me që ishin në gjendje të mirë. Qysh atëhere banorët e Vithkuqit u shpërndanë ndër vende dhe qytete të ndryshme, në të cilat dhe u vendosën dhe ku akoma janë ruajtur shumë familje me origjinë vithkuqare».

24) P. Pepo — po këtu f. 645 Dokumenti 197 «Në një shënim të ungjillit në kishën e Shën Mëhillit të Vithkuqit thuhet se ky qytet ishte shkatërruar më 25 tetor 1823». Thimi Mitko në një artikull të botuar në revistën «Pandhora» më 1860 shkruante «Një prishje e madhe është bërë më 1823, se vithkuqarët bashkë me korçarët erdhën në Greqi dhe ndihmuan në luftën



Vithkuqi pamje nga lagjet: Krekas, Borisht, Shore, Stratat e Janoj.
(shigjeta tregon vëndin ku ndodhej lagjia Bredhas)

shkrimet e mëvonëshme Vithkuqi përmendet nga shumë autorë jo më si qendër, por si fshat dhe si vendlindje e Naum Veqilharxhit.

Duke marrë parasysh se gjatë rrënimit të parë, Naumi nuk kishte ende lindur, kurse gjatë rrënimit të tretë, ai ndodhej prej disa kohësh i mërguar në Rumani, vetvetiu duhet pranuar se largimi i tij nga fshati i lindjes duhet të ketë ndodhur aty nga viti 1819. Ky konkluzion duhet pranuar gjithsesi me rezervë. Në fakt, në këtë kohë në disa krahina të Shqipërisë emigrimi ishte bërë një fenomen i zakonshëm, sepse anarkia, taksat dhe grabitjet e shumta i kishin varfëruar fshatarët, të cilët, kur s'gjenin rrugëdalje, niseshin për kurbet, që të shisnin forcën e punës për të jetuar. Rrugën e mërgimit merrnin dhe tregëtarët, dhe zejtarët, kur u kufizohej tregëtia. Qëndrat ku emigronin më shumë shqiptarë kanë qenë Selaniku, Korfuzi, Stambolli, Triesta, Vjena, Budapesti, provincat e Vllahisë dhe Moldavisë dhe qytetet e Italisë.

Fakti është se në 1821 Naumin e gjejmë në Rumani, në qytetin Brailë, si pjesëmarrës aktiv në një ngjarje të rëndësishme, në kryengritjen çlirimtare rumune kundër sundimit otoman të udhëhequr nga Tudor Vladimiresku. E gjejmë me mbiemrin «Veqilharxh». Shkrimtari rumun Viktor Papakostea dhe në përgjithësi literatura jonë historiografike dhe publicistike e pasçlirimit kanë pranuar mendimin se mbiemrin «Veqilharxh» Naumi e mori qysh nga koha e pjesëmarrjes në revolucionin anti-turk dhe anti-feodal të Vllahisë. Asnjë arësyetim i argumentuar nuk është dhënë deri më sot për këtë spjegim. Me sa duket janë nisur thjesht nga kuptimi i ofiqit të «Veqilharxhit», duke supozuar se do të ketë patur në revolucionin rumun detyrën e

për liri. Aristokracia turke bashkë me atë vendase për dënim e shkatërruan krejtësisht Vithkuqin, kurse Varoshin e Korçës e plaçkitën.» DH.S. Shuteriqi, Bibliografia e letërsisë së vjetër shqipe — Buletini i Shkencave Shoqërore — 3(1962) f. 117. «Në një shënim që Kostë Cepi ka bërë në murin e hatatit të kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq, lexohet: «Më 1828, gusht 18, unë Dhaskal Kostandin Cepi erdha nga Berati dhe e gjeta vendin të prishur, shtëpitë të shkreta dhe të prishura»

intendentit (veqilharxhit) të batalionit. Kështu shkruan Viktor Papakostea(25) kështu pohon Dhimitër Fullani (26), Petraç Pepo e Stojan Maslevi(27).

Kuptimi dhe origjina e mbiemrit Veqilharxh lidhur me funksionin e intendentit nuk mund të mohohet, por çështja që vemë në diskutim është në se këtë ofiq Naumi e mori në Rumani apo e trashëgoi nga prindërit. Shoku Dhimitër Fullani ka parë në muzeumin historik të Brailës 10-12 dokumenta gjyqësore të viteve 1830-1840 që flasin jo vetëm për Naum Veqilharxhin, por dhe për 3-4 persona të tjerë me mbiemrin Veqilharxh, banorë të Brailës, për të cilët do të kërkonim gjithashtu të kenë qenë intendentë të reparteve ushtarake. Gojëdhëna akoma e gjallë në Vithkuq e dëgjuar prej nesh nga vithkuqarët Nasi T. Prifti dhe Nuçi Tona thotë se i gjyshi, Llazari, dhe i ati, Panajoti, kanë punuar si furnitorë të garnizonit ushtarak turk të Korçës dhe për hir të këtij funksioni, turqit e garnizonit, bashkatdhetarët vithkuqarë dhe pastaj rrethi i të njohurve u thërrisnin «Veqilharxhë», ofiq që u mbeti si mbiemër.

Nuk dihet në se Naum Veqilharxhi kur shkoi në Rumani u vendos menjëherë në Brailë, apo në fillim në ndonjë qytet tjetër. Si bir tregëtari ai u muarr në Rumani me tregëti dhe vendosja e tij në Brailë nuk është e rastit. Braila, skelë e rëndësishme me pozitë të favorëshme në Danub, ishte port i lirë, ku tregëtarët mund të ngarkonin e shkarkonin mallra pa doganë. Përveç

25) V. Papacostea, Sur l'abecedaire albanais de Vechilhargi. Balcania, I, Bucarest, 1938 ff. 248-252.

26) DH. Fullani — Letersia e jonë, Naum Veqilharxhi autor i abetareve të para shqipe 12(1952) 46 «Naumi, me sa duket, ishte anëtar i Shtabit të Giorgaqi Alympiotit, me detyrë si veqilharxh, domethënë si furnizues i batalionit. Sigurisht që, duke u thirrë nga kryengritësit për një kohë të gjatë me emrin e funksionit të tij në kryengritje si veqilharxh, i mbeti ky ofiq dhe Naumi e pat për nder ta mbajë një ofiq të tillë gjithë jetën e tij».

27) P. Pepo — Dr. S. Maslev, Buletini i Universitetit Shterëror të Tiranës, seria shkencat shoqërore, Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgare shqiptare gjatë shekullit XIX 2(1961) 196-214. «...ka marrë pjesë në lëvizjen revolucionare të Rumanisë më 1821 kundër zgjedhës së bojarëve dhe zgjedhës turke, si veqilharxh, në një repart ushtarak rumun. domethënë si intendent, nga fitoi edhe emrin e përngjitur Veqilharxhi...»

shqipes, gjuhës amtare, greqishtes dhe pak turqisht. që kishte mësuar në shkollë, vetëkuptohet se në Rumanian ai përvetësoi edhe rumanishten. Në atë skelë të rëndësishme ku fliteshin shumë gjuhë të huaja, nuk përjashtohet të ketë mësuar për nevoja tregëtare edhe ndonjë gjuhë tjetër, sidomos frengjishten e anglishten. Nga letra dërguar të nipit më 1846, për të cilën do të flitet hollësisht më poshtë, mund të nxirret konkluzioni i supozuar se e njihnte ndopak italishten, posa le të kuptohet se dinte përmbajtjen e veprave të disa arbëreshëve të shkruara në gjuhën e Dantes.

Braila ishte gjithashtu një qendër emigracioni ballkanik. Kishte bullgarë, grekë, serbë, shqiptarë të emigruar për arsye ekonomike dhe politike. Si e tillë ishte dhe një qendër e ideve revolucionare e anti-turke, si dhe një vatrë e kulturës iluministe. Aty ishin të njohura idetë e revolucionit borgjez francez. Këto ide ishin të përhapura sidomos në koloninë greke. Organizata e fshehtë patriotike revolucionare greke «Filiqi Heteria» (Shoqëria e miqve) e themeluar në Odesë më 1814 me udhëheqës Aleksandër Ypsilantin, kishte krijuar një degë të rëndësishme në Brailë.

Heteria pati shtrirje të madhe në Ballkan dhe u përqafua jo vetëm nga patriotë grekë, por edhe nga revolucionarë demokratë të kombësive të tjera ballkanike. Ajo krijoi organizata në Vllahi, Moldavi, Rusi, Bullgari, Greqi, Vjenë, Serbi, Stamboll dhe Shqipëri. Kjo organizatë është një shembëll e mirë për të treguar marrëdhëniet vëllazërore midis popujve të Ballkanit në ato kohëra, pavarësisht nga elementë e organizata të ndryshme që kaluan në pozita nacionaliste e shoviniste më vonë. Me të drejtë, profesor Viktor Papakostea mendon se: «Naum Veqilharxhi i rilindjes së mëvonëshme të inteligjencës shqiptare, që ka marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1821, me siguri ka qenë anëtar i Heterisë» (28). Në fillim duket se Naum Veqilharxhi veçoi si anëtar i heshtur i «Heterisë», veçanërisht midis

28) V. Papacostea — La participation de l'écrivain albanais Vechilhardji à la Revolution de 1821, në revistën Balcania, VIII, Bucarest 1945 f. 190

emigrantëve e mercenarëve shqiptarë. Por, shpejt ngjarjet rrodhën në atë mënyrë që i dhanë rast Naum Veqilharxhit të luante një rol të rëndësishëm. Më 1821 në Vllahi shpërtheu revolucioni anti turk dhe antifeudal nën udhëheqjen e Tudor Vladimiresku, përfaqësuesi i shtresave më popullore të Rumanisë, në thirrjen e të cilit shkruhet: «Vëllezër, banorë të Vllahisë, kujtdo populli që i përkisni! Asnjë ligj nuk e ndalon t'i përgjigjesh së keqes me të keqe.... Kuçedrat që po na gëlltisnin të gjallë, sunduesit tanë thonë: të durojmë, që ata të pijnë gjakun tonë... të jemi skllevërit e tyre»(29). Tudor Vladimiresku vendosi lidhje sekrete me heteristet dhe arriti marrëveshje me Aleksandër Ypsilantin për koordinimin e veprimeve të lëvizjeve çlirimtare rumune e greke, qëllimi i përgjithshëm i të cilave ishte përmbysja e regjimit turk. Në këtë revolucion morën pjesë dhe pjesëtarë të kombësive të tjera ballkanike që ndodheshin në Rumani, duke përfshirë këtu edhe shqiptarë, të cilët në kronikat rumune quhen me emrin «*Arnaut*.» Pikërisht «natën e 18 janarit 1821 Tudor Vladimiresku me një grup arnautësh, siç shënon kronisti rumun J. Fotino, u nis të çojë më këmbë fshatarësinë e Oltenias»(30) me një fjalë dha sinjalin e fillimit të revolucionit çlirimtar rumun. «*Arnautët*» ishin ushtarë shqiptarë, që shërbenin në gardën e princave të Vllahisë dhe Moldavisë. Më vonë, në këto garda, hynë edhe mercenarë nga kombësitë e tjera të Ballkanit; me gjithë atë, emri i gardistëve mbeti arnaut, meqenëse në radhët e tyre mbizotëronte elementi shqiptar. «Përgjithësisht është abuzuar në kuptimin «*mercenarë*» që i është dhënë fjalës «*Arnaut*». Është e vërtetë që gardat e famshme shqiptare të oborreve të Bukureshtit dhe të Jashit, garda të cilat aderuan (u bashkuan M.I.) në lëvizjen që prej fillimit të revolucionit, kishin në radhët e tyre ngandonjëherë elemente të kombësive të tjera si p.sh. grekë, bullgarë, maqedhonas, arumunë dhe rumunë

29) M. Roller — Historia e Republikës Popullore të Rumanisë, viti 1950.

30) J. Fotino — Një histori e kryengritjes së vitit 1821, f. 125.

të principatave, të cilët, gjithashtu, thirrreshin «Arnaut». Por, nuk duhet tepëruar në asnjë mënyrë — shkruan historiani rumun Victor Papacostea — se numri i këtyre të fundit ishte praktikisht i papërfillshëm në raport me atë të shqiptarëve autentikë që përbënin pjesën më të madhe të armatave të principatave si të Moldavisë ashtu edhe të Vllahisë». (31).

Arnautët shquheshin për shpirtin e lartë të sakrificës, për aftësitë luftarake, për besnikërinë e tyre dhe për shefat me aftësi udhëheqëse. Për rolin e rëndësishëm që luajtën arnautët në ngjarjet e vitit 1821, flet fakti se si Tudor Vladimiresku ashtu edhe Aleksandër Ypsilanti veprimet e tyre kryengritëse i mbështetën shpesh herë në këto forca.

Njëri nga zëvendësit e parë të Aleksandër Ypsilantit ishte shqiptari Anastas Gjirokastroi. N. Jorga na thotë se Aleksandër Ypsilanti u kishte lënë në dorë arnautëve qytetin Coltina. Duke vlerësuar lart kontributin e shqiptarëve në këto ngjarje, Viktor Papacostea shkruan: «I vetmi popull që nuk ka asnjë kronikë për pjesëmarrjen në ngjarjet e 1821 është populli shqiptar... Ai dha një numër të madh luftëtarësh për lëvizjen e Heterisë... Këto guerile luftarake janë ato që dominuan në fushën e luftës me shumicën e tyre, me vigjilencën, me shpirtin e sakrificës dhe me shefat e tyre... Madhështia e këtij populli fisnik, gjakderdhja e tij ka kaluar pa u parë nga të tjerët ose është përvetësuar nga të tjerët, se në Shqipëri ka munguar historiografia...» (32). Për këtë shkruan edhe Nikollai Todorov «...më të konsiderueshëm në numër ishin repartet anaute, të cilat në përbërjen e ushtrive të Ypsilantit formonin dy korpuse prej rreth 2500 veta. Grupe arnautësh kishte edhe në ushtërinë e Tudor Vladimireskut» (33). Gjithashtu për këtë pjesëmarrje të shqiptarëve në këto ngjarje të më-

31) V. Papacostea — La participation de l'écrivain albanais Vechilhardji a la Révolution de 1821», Balcania VIII Bucarest 1945 f. 189.

32) V. Papacostea — La participation de l'écrivain albanais Vechilhardji a la Révolution de 1821, në revistën Balcania, VIII Bucarest 1945 f. 189.

33) Nikollai Todorov — Filikia Eteria dhe Bullgarët — Sofie, 1965, f. 87.

dha flasin edhe këto vargje që këndohen në Vuno të Himarës:

*«Tetëqind e njëzet viti,
Pushka e parë krisi,
Lëfton Ypsilant Politi,
I rri pranë Thanas Pipi
Në Tunë të gjithë i mbiti...»(34)*

I vetmi dokument që bën fjalë për pjesëmarrjen e Naum Veqilharxhit në këtë revolucion janë kronikat e vitit 1821 të Ilo Fotinos. Duke folur për një aksion të kryengritësve, kronika thotë: «...por I. Duka, duke avancuar nga pozitat që i ishin caktuar atij me pothuajse 400 shqiptarë, grekë, bullgarë, u takua me *ekatondrakosin* (komandantin e njëqind vetave) Dhimitër Hotoglu-n e shqiptarin Naum Veqilharxhin (35).

Profesori i Universitetit të Bukureshtit, Viktor Papakostea, në shkrimet e tij në revistën «Balcania» ngre me forcë e me ngrohtësi problemin e pjesëmarrjes së shqiptarëve në revolucionin e vitit 1821 në Vllahi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë Naum Veqilharxhit si prototip i pjesëmarrësit të ndërgjegjshëm dhe udhëheqës për elementin shqiptar. «...Duhet të njohim se një pjesë, si Veqilharxhi me shokë, që formonin grupin politik, të parët në shekullin e lëvizjeve nacionale... u angazhuan e luftuan për idenë shqiptare».

Më tej ai vazhdon: «Lëvizja e heteristëve e vuri për herë të parë Naum Veqilharxhin, shefin e lëvizjes rilindase të popullit shqiptar, në mes të popujve të tjerë ballkanikë të paraqitur në Heteri me shefat e tyre: grekërit me Aleksandër Ypsilantin, serbët me Karagjeorgjin, rumunët me Tudor Vladimireskun, bullgarët me car Aleksandrin dhe shqiptarët me Naum Veqilharxhin...»(36). Për këtë pjesëmarrje të Naum Veqil-

34) Revista «Ora» — Kënga e Thanas Pipit, 18 gusht 1929, f. 14.

35) V. Papacostea — La participation de l'écrivain albanais Vechilhardji à la Revolution de 1821, në revistën Balcania, VIII, Bucarest 1945, f. 190.

36) V. Papacostea, Po aty, f. 191.

harxhit në revolucionin antiturk dhe antifeuda të Rumanisë, në vitin 1821 shkruan edhe Nikollai Todorov: «Me ushtëritë turke që sulmuan u zhvilluan disa përpjekje nga reparte të veçanta të ushtërisë kryengritëse. E para që u ndesh me turqit që çeta pararoje nën komandën e Kollokotronis e Orfanos, me të cilën u bashkuan disa dhjetra vetë, të udhëhequr nga bullgarët Dimitër Hoxhogllu e Kondo me të cilin ishte dhe rilindasi i njohur shqiptar Naum Veqilharxhi»(37).

Gjatë diteve të përlëshjeve luftarake, Naum Veqilharxhi iu dha mundësia të njohë shpirtin luftarak të masave, taktikën e strategjinë e kryengritjes popullore, solidaritetin midis luftetarëve të kombësive të ndryshme. Atij iu dha mundësia të jetojë me urrejtjen e madhe, që shpërthente kundër turqve dhe bojarëve. Gjurma kanë lënë tek Naum Veqilharxhi forca e kushtrimit për liri e atdhedashuri. Ai, me këtë rast, kuptoi se midis gjëndjes së popullit rumun dhe të popullit shqiptar egzistonte një analogji e madhe.

Revolucioni i vitit 1821 në Vllahë deshtoi. Porta e Lartë dhe bojarët shtuan terrorin mbi pjesëmarrësit në kryengritje. Gjendja ekonomike u veshuresua shumë. Në këto situata të rënde u duk një rënie në veprimtarinë e organizatave dhe shoqërive të fshehta. Në mendim të se revolucionit, ndonëse dështoi, duhet të ketë qënë një mesim i madh për Naum Veqilharxhin. Ai ushqeu tek shqiptari i ri mendimin për çlirimin e kombit të vet. Idete e iluminizmit që vepronin si ide udhëheqëse të levizjes kulturele të kohës, e drejtuan atë në rrugën e një aksioni të gjatë sistematik, të cilit iu kushtua deri në ditët e fundit të jetës. Tek Naum Veqilharxhi, vitet pas dështimit të revolucionit, qënë vite në të cilat filluan të pihen idetë e reja, që e udhëhoqën atë në veprimtarinë e tij të metejshme. Mendoi se si orientim për rrugën që ndjek me vonë dhe për konkretizimin e mendimeve të tija kanë ndikuar edhe figurat e para të shquara të arësimit dhe të kulturës ru-

37) N. Todorov, Filiki Eteria dhe Bullgarët, Sofis, 1965, f. 87.

mune si George Lazer (38). Veqilharxhi arriti në përfundim se nëpërmjet lëvrimet të gjuhës dhe arësimit, mund të zgjonte dhe edukonte ndërgjegjen kombetare, pa të cilën nuk mund të arrihej fitorja përfundimtare. Por, rrethanat e renes së levizjes revolucionare nuk lejuan që Naum Veqilharxhi ta konkretizonte këtë mendim të tij. Per kete duhej të priste momente të reja. Gjatë periudhës që shkoj deri në fund të viteve 30 të shekullit XIX, Naum Veqilharxhi përgatitet për detyrën që i kishte caktuar vetes. Ai filloi të njihesh me literaturën e kohës, bëri udhëtime dhe zgjeroi kontaktet me rilindasit ballkanas dhe emigrantet shqiptarë. Ka mundësi që ai të kete qëndruar në Bukuresht, në qendrën më të madhe arsimore, politike dhe kulturele të Rumanisë, për një kohë të gjatë.

38) V. Bala — Lidhjet kulturore shqiptare-rumune. Buletini Shkencor i Institutit Pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës, viti 1964, f. 50-85. «Një nga figurat më të shqueme, në mos e para, në fushën e kulturës dhe arësimit rumun, asht George Lazer, i cili, më 1818, çeli në Stënu Sara shkollën e parë në gjuhën rumune të Vllahisë, më 1820 botoi një abetare «në gjuhën e atdheut», më 1821 mori pjesë pranë Tudor Vladimireskut në kryengritjen».

VEPRAT

*Sa vjet i madhi zot të më falnjë, i kam për t'i
tërtherur duke punuar për vëndin tim, për këtë
guhën tonë.*

Naum Veqilharxhi

Për Naum Veqilharxhin, ngjarjet rumune të vitit 1821 shërbyen si nje shkollë e madhe politike. Mbi të ndikoi jo vetëm heroizmi popullor kunder sundimit të huaj turk, por, njëkonesisht, edhe revolucionin demokratik kunder rendit feudal të bojarëve. Keto ngjarje koinciduan me lëvizjet e fuqishme në Shqipëri kunder Portes së Lartë si lufta shumëvjeçare që zhvilloi ajo për të mposhtur dy pashalleket e mëdha në Shqipëri dhe sidomos kryengritjet e viteve 1831-1839, që ndodhen në mbarë Shqipërinë. Lëvizjet antiturke në vitet 20-30 të shekullit XIX, megjithse karakterizoheshin nga një platformë politike jo e qartë dhe e papercaktuar, prapeseprapë patën rrjedhime pozitive, sepse duke qenë lëvizje masive dhe popullore, duke u ndeshur drejtpërdrejt me ekspeditat turke, e shtuan urrejtjen popullore ndaj pushtuesit shekullor dhe, nga ana tjetër, ndihmuan shumë në dështimin e synimeve asimiluese që ndiqte Porta e Lartë ndaj popullit shqiptar.

Oshëtimia e këtyre luftërave kundra shtypjes turke pa tjetër është ndjere deri në Rumanë midis patriotëve, të cilët, pa dyshim, i ndiqnin me interes dhe vemendje ngjarjet e stuhishme të këtyre viteve. Në menyre të veçantë këto manifestime kanë lënë gjurma të Naum

Veqilharxhi. Këtë e provon më së miri fakti se menjëherë pas dështimit të revolucionit rumun, Naum Veqilharxhi e drejtoi vëmendjen plotesisht nga atdheu dhe populli i tij, nga të cilët ai jetonte larg gjeografikisht, por afer, shumë afer shpirtërisht.

Periudhat që vijnë pas dështimit të revolucioneve, në përgjithësi i orientojnë revolucionarët për një ngritje të re të revolucionit, me punën e vështirë të përgatitjes ideologjike të masave popullore. Ky orientim ishte imperativ sidomos për Shqipërinë, e cila ndodhej në kushtet e rendit shoqëror feodal dhe të obskurantizmit teokratik. Fusha kryesore e luftës ideologjike ishte, pa dyshim, lufta për kulturën shqiptare. Lufta për kulturën shqiptare kerkonte nga ana e vet, si hap paraprak luftën për arsimin shqiptar. Kuptohet vetvetiu se nuk mund të flitet për zhvillimin e arsimit nacional po që se vendi nuk praktikonte shkërimin e gjuhës amtare me një alfabet unik. Siç dihet në vitet 20 të shekullit XIX, gjuha shqipe ishte jo vetëm shumë pak e levruar në fushën e shkërimit, por ç'ishte më e keqja edhe pendat e pakëta që merreshin me të, praktikonin alfabetë të ndryshme. Për çdo mendimtar dhe luftëtar të përparuar, që mendonte të hidhte faren për një nop të madh në fushën e kulturës, delte si detyrë e domosdoshme, si hap i parë fillestar, zgjidhja e problemit të alfabetit.

Nga ana tjetër, nevojën e përhapjes së arsimit e kishte nxjerrë në shesh vetë zhvillimi ekonomik i vendit, rritja e marrëdhënieve tregëtare, kontaktet me teknikën dhe shkencën. Arsimi që praktikonej në Shqipëri në gjysmën e parë të shekullit XIX nuk mund të plotësonte këto nevoje, sepse ishte shumë i kufizuar, qoftë nga forma, qoftë nga përmbajtja: nga forma, se praktikonej në gjuhë të huaja (turqisht për nxënësit e popullsisë myslimane, greqisht për nxënësit e popullsisë ortodokse); nga përmbajtja, se ishte ndertuar mbi një program jo laik. Veç kësaj, ky sistem arsimor jo vetëm nuk i afronte, por, përkundrazi, e thellonte edhe më tepër dallimin dhe përçarjen e shqiptarëve sipas

feve. Zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit kërkonte, përkundrazi, afrimin, bashkëpunimin dhe më tej, shkri-
rjen në një komunitet të vetëm kultural të mbarë popull-
sisë shqiptare. Këtë detyrë mund ta kryente vetëm arë-
simi në gjuhën amtare dhe zhvillimin faqebardhë të
këtij arësimi mund ta lehtësonte vetëm alfabeti unik.
Vetë Naum Veqilharxhi shkruante në letrën që i dër-
gonte të nipit më 1846: «... mirëpo kjo nuk fitohet
ndryshe, veçse me shkronja të posaçme kombëtare,
që ishte filluar para meje, por që për shkak të përzierjes
me të huaj dhe intrigave të ziliqarëve, të gjitha mbetën
pa fruit dhe gjer tani njihen tre sisteme alfabeti; njëri
me 32 shkronja greke... tjetri me 29 latine dhe i treti
me karakteret e veta...»(39). Këto duhet të jenë arësytet
që spiegojnë përse Naum Veqilharxhi e filloi veprim-
tarinë e tij të dobishme në shërbim të atdheut të vet
me caktimin e një alfabeti unik për gjuhën shqipe.
Ai shkruante më 1845, në parathënien e Ëvetarit të
dytë: «Unë tërthorë (sakrifikova M.I.) kaqë gjëmë (ko-
hë M.I.) aty e njëzet viet që t'u bëj vegla e ju tash e
tutje vini pëlhurën»(40). Kjo frazë kaq e shkurtër na
tregon se alfabetin për gjuhën amtare Naum Veqil-
harxhi e sajoi aty nga viti 1825. Ajo na tregon gjith-
ashtu se atij iu desh një kohë e gjatë për t'u dhënë
pamjen përfundimtare shkronjave të alfabetit. Por, mbi
të gjitha, në kuptojmë se patrioti revolucionar ishte i
ndërgjegjshëm për hapin që kryente. Ai e konsideronte
alfabetin si vegël, domethënë avlemend, me të cilën
djemtë e rinj shqiptarë, të cilëve ai u drejtohej, do të
thurrnin pëlhurën, domethënë kulturën shqiptare. Sa u
tha më sipër gjen me këtë frazë mbështetjen e duhur
logjike.

Naum Veqilharxhi nuk kishte një përgatitje të ve-
çantë linguistike. Por, ai duket se për hir të dashurisë

39) N. Veqilharxhi — Letër: Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti
në Vienë.

40) N. Veqilharxhi — E parathënme mbi djemt e rinj shqiptarë-
Ëvetari 1845.

që kishte për atdheun e vet, tregoi mjaft kujdes për ngritjen e «avlemendit». Kio, mbase, spiegoi arësytet përse ai u muarr për një kohë të gjatë me përgatitjen e alfabetit. Me rëndësi është gjithashtu fakti se për kompozimin e shkronjave, Naum Veqilharxhi synoi të jepte një alfabet krejt origjinal që të mos i ngjiste as alfabetit turk, as grek dhe as latin, nëpërmjet të cilëve mund të ushtrohej një farë ndikimi politik. Sipas N. Veqilharxhit, shqiptarët, një popull me gjuhë e zakone të veçanta, duhej të dalloheshin nga popujt e tjerë dhe në fushën e alfabetit.

Kuidesi i patriotit vithkuqar për një punë serioze duket edhe në përpjekjet e tij për të na dhënë një alfabet që të pasqyronte sa më mirë strukturën fonetike të shqipes. Nga 36 tingujt e gjuhës shqipe, 30 i ka dalluar qartë dhe i ka fiksuar me shkronja të veçanta, të huazuara pjesërisht nga alfabetet e popujve të tjerë si nga alfabeti sllav, ebraik e armen, duke u bërë ndryshime, përshtatje e modifikime dhe duke i plotësuar me disa krijime origjinale. Mendimi i albanologut austriak se «gërmat e Veqilharxhit nuk janë primitive dhe të vrazhda, por të punuara me estetikë, të një stili elegant» (41) është sigurisht i drejtë.

Alfabetin e përgatitur më 1825, Naum Veqilharxhi për shumë kohë nuk e vuri dot në zbatim. Arësytet nuk i dimë. Veç kësaj nuk dimë asgjë për veprimtarinë e tij politike, shoqërore, kulturele e private për njëzet vjet. Vetëm më 1844 ai del në skenë me botimin e *Ëvetarit* të parë të shkruar me alfabetin e përgatitur rreth vitit 1825. Ai ka katër fletë (tetë faqe). Është shumë i rrallë. Njihen vetëm tre egzemplarë (42).

41) Johann Georg Von Hahn «Albanesische studien» 1854 f. 292-293.

42) P. Pepo — Një letër e korçarëve e vitit 1845, dërguar N. Veqilharxhit në Rumani, në rev. *Studime filologjike* 1(1966)203 «Një egzemplar i tij gjendej në bibliotekën private të profesorit rumun Th. Kapidan, në Bukuresht; një tjetër ndodhet në bibliotekën Kombëtare të Tiranës më 1937 në Korçë u zbulua egzemplar i tretë». — Në transkriptim kemi ndjekur ortografinë e autorit.

Kapaku recto

NEON ALVANIKON ALFAVITARION Itoi TA NYN
PROTON

NEOFANI ALVANIKA STOIHEIA GRAMATON
skedhiathenta kai eis fos ekdhothenta para toy
efeyretoy avton NAYM P. VEKYLHARTZI eh
Vithkukion tis Kolionias 1844

Në kapak dhe në fillim të fletës së parë recto, që
janë me shtyp:

PROHEIRON ALVANIKON ALFAVITARION.

Fort i shkurtër e i përdorshim ëvetar shqip
Për çdo si cilë aëdo të mpsonjë të kënduarit e të
shkruarit bukur shqip
Dhënë tani përherë mbë dritë prej aiendësit e
bëntorit i këtvre të shkrumëve rea edhe këti ëvetarit.
Naum Panaiot Haxhi Lazar Bredhi që i thonë edhe
Naum Veqilharxh nga Bythkuqi i Kolonjës

Mot i parë 1844

(pa vëndin e botimit) Ëvetari është i pirografuar. Ti-
razhi i përgjithshën nuk dihet. Midis titullit në faqen
e parë dhe kapakut është një fletë e pa numëruar me
madhësinë e fletëve të tjera të këtij «**Ëvetari**», e cila
në recto është e bardhë dhe në verso ka portretin në
gravurë të autorit. Në fund të gravurës është shkruar
me alfabetin e tij data e lindies: «*Naum P. Veailharxhi
pjellë mbë 1797 mbë 6 të dheambrit*». Në fletën e
parë verso qiejmë strofën shqip me titullin «Epar e
tëmpsuarit frik'e perëndisë», ku autori u thotë të veqjël-
ve se çdo qië në fillim duket e rëndë, por aq e lehtë
bëhet ajo kur njeriu i vihet punës.

«Cdo e nisur q'është' e rëndë
Ska njeri që nuk' edj
Po kushdo kur do të vihet
Si shpëton gjëset ati».

Fletën e dytë recto autori e ka mbushur me alfabetin e vet të veçantë për gjuhën shqipe. Në fillim ka vënë geramat e vogla të dorës, që i spjegon me alfabetin grek. Pastaj ka vënë geramat e mëdha të dorës (33 germa).

Në fletën e dytë verso shkronjat e shtypit të alfabetit të tij të vogla e të mëdha. Midis dy palë shkronjave dhe pas tyre ka shkruar disa aforizma me vlerë edukative, kështu p.sh., ai u mëson fëmijëve se gjënë e bukur dhe të dobishme duhet ta çmojmë nga brendia dhe jo nga forma «*Mos shëko lëvozhgënë, po vështro palcën*», «*Mos lësho gjuhën të t'ecnjë përpara mëndjes*», «*Edhe mos hapësh gojën të përflaç atë që s'njeh*», «*Dora e shtërnguarë sbën gjësant të vyerë*». Në fund të faqes fillon spjegimet e alfabetit të tij me greqishten.

Në fletën e tretë recto vazhdojnë spjegimet e alfabetit të tij me greqishten. Në fletën e tretë verso gjysma e parë e faqes është me vazhdimin e spjegimeve të alfabetit. Pas titullit «*Gymnasis anagnoeos*» shkruar me alfabetin e tij — vazhdon me disa bekime fetare. Në fletën e katërt recto jep disa aforizma të tjera edukonjëse, për të cilat thotë: «*Për të shkruar bukur zgjodha disa porosi të mënçme*»: «*Ajo që stëpëlqen tëtë bëjnë ty mos ja bësh as ti tjetërit. Përtesi është rëndje dheut. Kush flet shumë s'flet të vërteta. Kush gënjen një herë sbesohet tjetër herë. Ndë i punçmi çdo gjë është elehët, ndë i papunçmi të gjitha janë të rënda. Ku starin dora mos u ngjat, çë sta ze këmba mos eshkëlç. I mari njihet nga të qeshurit eshumë. Bëj mirë të gjesh mirë. Kush duron trashëgon. Mos i apësh njeriut kuvëndin e ndermbës për gjë që smunt e sje i zoti ta bësh. Kujt si dhembet vendi, gjuha e far'eti ay as njeh as ka mbë vete perëndi. Mos kesh turp të mpsosh atë që sdi. Më mirë ivdekur se i turpëruar. Më mirë të bësh mirë etë flasën për ty keq, se sa të bësh keq etë flasën për ty mirë. As e mira as e liga mbeten pa çpërblyer.*»

Në fletën e katërt verso jep disa porosi për të vegjëlit. Këtu përfundon Ëvetari i 1844-ës.

Nënkuptohet se Ëvetari u botua për t'u shpërndarë në Shqipëri dhe për të shërbuer si tekst mësimi në radhë të parë nga nxënësit e shkollave të vendit. Ne nuk jemi në gjendje të sqarojmë se sa, si dhe ku u shpërndanë. Dimë vetëm se një sasi prej tyre, Naum Veqilharxhi i nisi në Korçë, me anë të Naum Haxhi Vasilit dhe me porosi që ato të shpërndaheshin jo vetëm në Korçë, por edhe në Përmet e Berat. Se me sa entuziazëm u prit Ëvetari në Korçë, Përmet e Berat, e marrim vesh nga një letër që para korçare i drejtoi Naum Veqilharxhit nga Korça. Letra mban datën 22 prill 1845, që duhet të jetë sipas kalendarit julian dhe që i takon sipas kalendarit të sotshëm datës 4 maj 1845(43). Është botuar për të parën herë nga profesori Viktor Papakostea në revistën «Balçania» 1, Bukuresht 1938, ff. 228-252 me titull «Sur l'abecedaire albanais de Vechilhardji». Ai e kishte gjetur në arshivat e Akademisë rumune, në sesionin e dorëshkrimeve, me nr. 878, f. 166. Sot ndodhet në seksionin e dorëshkrimeve të bibliotekës së Akademisë së Republikës Popullore të Rumanisë. Pavarësisht nga letra me shkronja cirilike rumune, të zbuluar nga profesor Viktor Papakostea, duke u nisur nga vetë pohimi i korçarëve «...u mësuam të lexojmë e të shkruajmë, duke lidhur dhe korispondencë me anë letrash, sikur të ishin (Ëvetarët M.I.) një burim mrekullie...» mendojmë se për këtë grup patriotësh përparimtarë të Korçës ka qenë një gëzim i madh dhe një nder që t'i shkruajnë autorit të parën letër pas marrjes së «Ëvetarit» në gjuhën amtare. Nga ana tjetër, duke shkruar me alfabetin e shpikur prej tij, argumentojnë vlerën e madhe të këtyre shkronjave të posaçme për lëvrimin e shqipes. Mundet, për arsye të ndryshme, letra të jetë përkthyer në Rumani. Letra është përkthyer dhe botuar për herë të parë nga Ilo Mitkë Qafëzezi në Shqipëri më 30 Janar 1940. Më së fundi e botoi bashkë me përkthimin P. Pepo(44). Ëvetarin e rrëmbyen në

43) Në historiografinë tonë data 22 prill është konsideruar pa të drejtë sipas kalendarit gregorian.

44) P. Pepo. — Një letër e korçarëve e vitit 1845, dërguar N. Veqilharxhit, Studime filologjike 1(1966) 201-208;

Korçë dhe me shpejtësi të madhe, u përhap në Kolonjë, Përmet dhe Berat, duke arritur deri thellë në malësitë e Vithkuqit (Treskë). Letra u redaktua nga sekretari i Mitropolisë Thanas Paskali, i cili e ka firmuar në emër të parisë së komunitetit ortodoks të Korçës. Ka shumë mundësi që në përpilimin e kësaj letre të ketë marrë pjesë drejt për drejt dhe Thimi Mitko, nënshkrimi i të cilit del disa herë në kodikun e Mitropolisë së Korçës dhe Selasforit. Letra e korçarëve vinte në dukje nevojën e madhe që përmbushte kjo abetare: «Ju lutemi, zotëri, që në rast se kini Ëvetares nga ato që na kini dërguar, të na dërgoni sa më shumë, sepse bashkëatdhetarët kërkojnë vazhdimisht akoma nga ato Ëvetarë... u mësuan të lexojnë e të shkruajnë...»(45).

Shpërndarja u bë nga paria korçare, sipas dëshirës së Veqilharxhit «...dhe me sa na është shkruar nga zotëria juaj kemi bërë shpërndarjen e tyre si këtu në Korçë, në tërë krahinën e saj, ashtu dhe në Përmet dhe Berat». Rreshtat e mëposhtëme të këtij dokumenti, dëshmojnë se Naum Veqilharxhi ka patur korespondencë të vazhdueshme me bashkëatdhetarët; ajo dëshmon se edhe shqiptarët e tjerë emigrantë në Rumani kanë qenë në kontakt me të dhe me veprimtarinë e tij; gjithashtu këto rreshta flasin për një krijimtari më të gjërë se sa njohim ne në fushën e arësimit dhe të mendimit. «Si nga letrat e zotërisë suaj, ashtu dhe nga bashkëatdhetarët që vijnë prej andej, mësojmë me gëzim të madh se kini përgatitur dhe dorëshkrime të tjera, libra fillestare dhe vazhdimisht përpiqeni për këtë vepër të shenjtë, duke futur libra të ndryshme në gjuhën tonë shqipe që të jenë gati kur të ngrihet tipografia dhe, për rrjedhim, të mund të hapen dhe shkolla për përparimin e mësimin kombëtar.»(46)

Nga letra del qartë se borgjezia shqiptare kishte filluar të vihej në lëvizje për çështjen kombëtare e se në Shqipëri po rritej dashuria për gjuhë dhe kulturën

45) Letra e nënshkruar nga Thanas Paskali dhe të tjerë nga qytet¹ Korça e Shqipërisë — rumanisht, 22 prill 1845, botuar në revistën «Balcania» Bukuresht nr. 1 viti 1938, f. 248-252.

46) Po këtu ff. 248-252.

kombëtare. «...me gëzim të madh dhe me kënaqësi, duke lavderuar dhe lartësuar të plotfuqishmen Perëndi, që ju ka ndriçuar për të paraqitur në gjuhën tonë shkronja me të cilat prej aq shekujsh kombi ynë ka hyrë në histori»(47).

Letra tregon se një pjesë e parisë së komunitetit ortodoks ishte përkrahëse e idesë së Naum Veqilharxhit dhe e gatëshme për shpërndarjen e abetareve, ishte inisiatore e përpilimit të listave për të grumbulluar ndihma, për të ngritur një tipografi në Korçë për të shtypur dhe shumefishuar veprat e Veqilharxhit, ashtu dhe për shkrime të tjera. Entuziazmi që ngjalli botimi i abetares tregon se Naum Veqilharxhi ishte në dijeni të plotë mbi gjendjen në Shqipëri, dhe diti t'i përgjigjet situatës dhe kerkesave, në kohën e duhur dhe me veprën e duhur. Ky entuziazëm që një nxitje për të. Për këtë arsye në vend të një ribotimi të thjeshtë, ai përpiloi një tekst të ri, gjashtë herë më të madh se Evetari i parë, i cili sado që quhet botimi i dytë, është një vepër më vete. Ky Evetar i dytë u botua me 1845. Titulli i plotë është «Fare i ri Evetar shqip për djelm nismetarë nxjerrë e dhënë mbë dritë tan heren e parë per djem të vegjël me një të zgjidhur nga disa gjë të mirash e të fitimeshme prej Naum P. Veqilharxhit Bredhi nga Bythkuqi i Kolonjës moti i dytë 1845»(48). Për fat të keq deri sot nuk kemi shtëne në dorë asnjë egzemplar të ketij Evetari. Ne njohim vetëm kopertinen, parathënien me titull «E parathënime mbi djelmt e rinj shqiptarë» dhe tekstin e faqes 33 të riprodnuar në klishe nga bibliografi francez Emil Legrand, sipas egzemplarit që ka patur Sami Frashëri(49).

Hyrja «e parathënime mbi djelmt e rinj shqiptarë» është shumë interesante; këtu çfaqen idetë e tij të shëndosha lidhur me zhvillimin e aresimit në gjuhën

47) Letra e nënshkruar nga Thanas Paskali dhe të tjerë nga qyteti Korça e Shqipërisë — rumanisht, 22 prill 1845, botuar në revistën «Balcania» Bukuresht nr. 1 viti 1938, f. 248-252.

48) D.H.S. Shuteriqi «Bibliografia e letërsisë së vjetër shqipe» — Buletini i Shkencave shoqërore, nr. 1,2,3 i vitit 1962 dhe nr. 1 i vitit 1963.

49) E. Legrand Bibliographie albanaise 1912-200 f. 73-79-80.

shqipe. Autori këtu për herë të parë hedh mendimet e tij, me një gjuhë shqipe të bukur, të pastër dhe popullore, ku mbi të gjitha mbizoteron toni patriotik. A është perpjekur për pasurimin e gjuhës shqipe me termat, fjalet dhe shprehjet, pa i munguar kujdesi për ta qeruar nga fjalet turke e greke, që nuk tingeltonin ëmbël. Kjo rrugë, që më vonë vazhdohet edhe nga rilindasit e tjerë, nis me Naum Veqilharxhin. Më poshtë po citojmë nga faqja 33 e *Ëvetarit të vitit 1845* një pasazh interesant: «Këtë kuvend gerbie, që do të thotë kullë si e t'nemi sot, e kam gjetur mbe një vend të shkruar prandaj e vura që të ickenj nga e t'nëna pirk e kullë që janë të dyja kuvise të huaja, po ju o djem, miri atë që të njini për me të mire...»(50).

Aftësia e Naum Veqilharxhit në krijimin e neologjizmave duket edhe në titullin që i ve të parit liber për «*Djemt e rinj shqiptarë*». Kjo menyrë e goditur u ndoq me vonë nga rilindasit e tjerë, të cilët sipas snembellit «*Ëvetar*» krijuan fjalën «*Abetare*», duke ndjekur kriterin e bashkimit të shkronjave të para të alfabetit tone.

Interes paraqet çështja se në ç'vend janë shtypur abetaret. Për këtë s'ka asnjë të dhënë të sakte, prandaj mund të mbeshtetemi vetëm në punimet e autoreve të ndryshëm. Nikolla Naçi në librin «*Korça dhe fshatrat perqark*(51)» më 1901 dhe Th. Kapedan në vepren «*Grajul rumens*» (52) më 1928, caktojnë Stambollin si qendër, ku u botuan abetaret, pa treguar asnjë argument. Revista «*Dituria*»(53) më 1927 jep listen e librave shqip të botuara në Rumani pa përmendur ato të Veqilharxhit, sepse nuk ka mundur të caktojë se ku janë botuar. Në literaturën e pasqirimit si në tekstin e historisë së Shqipërisë, ashtu dhe në artikuj të ndryshëm që janë botuar, caktohet Rumania(54), pa përmendur qytetin. Në jemi gjithashtu të mendimit se Rumania, qendra më e rëndësishme e emigracionit shqip-


50) E. Legrand *Bibliographie albanaise* — 1912 f. 73-80.

51) N. Naçi — *Korça dhe fshatrat perqark*, Sofje, 1901 f. 101-103.

52) I.Th. Capidan «*Grajul rumens* — Bucarest 1928.

53) Revista «*Dituria*» viti 1927 Nr. 89 faqe 3.

54) *Historia e Shqipërisë (1839-1900)* Tiranë, 1962, f. 8.



Kapaku i veprës së Naum Veqilharxhit :

Fare i ri Ëvetar Shqip për djelm nismëtarë nxjerrë e dhënë mbi dritë tani herën e parë për djelm të vegjël me një të zgjidhur nga disa gjë të mirash e të fitimëshme. Moti i dytë 1845.

Sei dardh n be je tabeaba. Otrr sille siefe
n stana yuicaz n bobbe. n sie sinteb vden
yud qonu n dvedreco te nlon deano sebnzta
qre eobite sabre. eie ata sn eole strvye linje
pian vprav.

Šarostin n vjasa

Zibsv i yajivoyt.

Sn eole tindr n qonu v vjraz acni va
grar drizijq te boju, ste ne yey. Ošrbn tv
šibi qre dextre eie te ketje ne sie. eie n
lon zimb vol nknj n tirant dabrvoja n šrbn
vabr. n naadny dsn. vorye te qrebotje ne
šrbjdn (eolia) eie te šnje ndebal n šrbn te
za dabraba, nlon te ketje ne sebtie. 1) acn
je tabefeb. eie te drizijq te vdrjetje za škid
šia, qre v qšiaqre qto ne šnbe šnjebr nlon

1) Cete arzey sebtie. eie to je lofe. zibs nlon
arve vi nloni vol. n ead šintvb ste ne yey
je vabrab za aitar nyrba eie feicay za nle
ca zibs n arve ac raze eie te tva arjyon. je
švara. do tv o tindr, šibi ate eie te nqeyi arve
be te šibe

Faqe 33 e veprës së N. Veqilharxhit

«Fare i ri Ëvetar Shqip (1845)

tar, vendi ku mund të mblihdeshin ndihma për inisiativën e Naum Veqilharxhit, duhet të ketë qenë vendi i botimit të Ëvetareve. Përsa i përket qytetit, Ëvetaret duhet të jenë botuar jo në Brailë, e cila në atë kohë nuk ishte qender shtypi, por në Bukuresht, qytet me një industri tipografike relativisht të zhvilluar në atë kohë, duke u basnkuar kështu me pohimin e albanologut freng August Dozon, i cili në veprën e tij «Manuel de la langue chkipe ou albanaise» të shkruar në vitin 1878, thote: «Naum Veqilharxhi botoi në Bukuresht një lloj të tillë (e ka fjalen për abetaren M.I.) dhe e perdori...»(55). Mirëprirja që pati në radhën e shqiptareve botimi i dy evetareve, mund të mendohet se inkurajoi të Naum Veqilharxhi idenë e formimit të një shoqërie patriotike shqiptare, ku të grumbulloheshin bashkatdhetaret e tij që ndodheshin në emigracion, sipas shembëllës së shoqërisë kulturele kombetare të vendeve të tjera ballkanike. Në qoftë se është akoma shpejt të flitet për një shoqëri, të paktën mund të thuhet se në vitet 1845-1846 u krye hapi i pari, domethënë krijimi i një bërthame patriotësh me mision botimitin e librave në gjuhën amtare, dergimin e tyre në Shqipëri dhe propagandimin ndermjet bashkatdhetareve të ideve kombetare. Dhimitër Marini, Naum Haxhi Vasili mund të mendohet se janë anetarë të këtij grupi fillestar. Gjithashtu ka arsye të mendohet se për të formuar një bazë financiare dhe më vonë për të ngritur shtypshkronjen, Naum Veqilharxhi do t'u jetë drejtuar jo vetëm miqve, por edhe njerezve me pozitë dhe me kamje të madhe. Fakt për këtë është vete «Letërqarkorja», që i drejton popullit shqiptar e në veçanti elementit përparimtar e të mësuar.

Përpjekjet e Naum Veqilharxhit për t'u lidhur me personalitete shqiptare, ose që mund të ishin të dobishëm për çështjen kombetare, nuk u kufizuan vetëm me lidhjet që krijoi me Shqipërinë ose me personalitete me origjinë shqiptare në humani. Ai krijoi lidhje edhe me kolonitë arbereshe të Italisë. I nxitur nga dëshira

55) A. Dozon «Manuel de la langue chkipe ou albanaise (1878) f. 169.

për t'u njohur me gjithçka që shkruhej në atë kohë për Shqipërinë, ai u vu në lidhje në radhë të parë me shkrimtarin arbëresh Jeronim De Radën.

I frymëzuar nga e kaluara plot lavdi e popullit tonë, De Rada kishte krijuar një sërë veprash, që janë nga më të bukurat për letërsinë arbëreshe dhe shqiptare. Në vitin 1843 ai botoi shkrimin e tij me titull «Mbi hyjnitë e pellazgëve», në të cilën ngre problemin se shqiptarët ishin pasardhës të pellazgëve. Artikulli u ribotua në vitin 1844-45 dhe tërhoqi vëmendjen e publikut evropian. Jehonë pati punimi i Jeronim De Radës në shtypin e Athinës dhe në shqiptarët e Rumanisë. Naum Veqilharxhi i entuziazmuar, bashkë me miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij shpejton ta përgëzojë me anën e një letre (56) autorin arbëresh në vitin 1845. Mendimet e De Radës dhe të albanologëve të tjerë në lidhje me prejardhjen e shqiptarëve u përqaftuan me entuziazëm nga Naum Veqilharxhi dhe nga patriotët e tjerë shqiptarë dhe u përdorën prej tyre në luftën që bënin ata kundër orvatjeve shoviniste të rretheve të borgjezisë e qeverisë greke, që donin të asimilonin kombësinë shqiptare. Për marrëdhëniet midis shqipëtarëve të Rumanisë dhe arbëreshëve vlen të përmendet fakti që botimi i «Ëvetarit» u muar vesh nga arbëreshët e Italisë shumë shpejt. V. Dorsa në punimin e tij «Përmbi shqiptarët» (57) botuar në Napoli më 1847, dy-tre vjet pas daljes së abetares në dritë, flet për alfabetin e Naum Veqilharxhit.

Naum Veqilharxhi duket se e ndiqte literaturën e kohës. Nga parathënia dhe abetarja del se e ka njohur librin e shtypur më 1797 në Vienë nga Kostandin Ukuta, me origjinë nga Voskopoja, me titull «Pedagogjia e re» (abetare e lehtë për t'u mësuar nga të rinjtë arumunë), nga e cila mund të jetë ndikuar. Që Veqilharxhi ka ndjekur me interes botimet për Shqipërinë nga shqiptarë ose të huaj e tregojnë këto radhë, me të cilat i drejtohet të nipit, Jani Calit: «Unë, ndonse nuk mendoj

56) Historia e Shqipërisë — vol II — Tiranë 1965 f. 56

57) V. Dorsa Sugli albanesi, Napoli 1947, f. 31.

të jem një filolog aq i thellë, megjithë këtë po të përmend se për shqiptarët kanë shkruar anglezi Masi, italiani Josif Krispi, gjermani Ksilandër, siçeljani Bidera, kalabrezi De Rada...»(58)

Në Ballkan, në vitet 1845-46 fillon një lëvizje e gjërë kundër politikës së forcës dhe kundër privilegjeve që i kishte dhënë Porta e Lartë klerit të Fanarit. Për të qetësuar gjendjen, në pranverë të 1845-ës Sulltan Mexhiti, i shoqëruar nga veziri i madh Reshit Pashai, ndërmoi një udhëtim në provincat e Ballkanit...» (59).

Në këto rrethana Naum Veqilharxhi lëshon një «enciklikë» (letërqarkore) greqisht, «për gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoxë shqiptarë.» «Enciklika» është një manifest, në të cilën, me një ton luftarak, Veqilharxhi ka shtruar kërkesat kulturele për lëvizjen tonë kombëtare për të shpëtuar popullin nga padia dhe gjendja e mjerueshme. Në «Enciklikë» është përdorur një gjuhë ezopike (e fshehtë) kundrejt Turqisë, që të drejtonte vëmendjen më shumë nga planet djallëzore të Greqisë, duke demaskuar plot urrejtje synimet shoviniste të qarqeve greke. «Enciklika» përbën manifestin e parë të ideologjisë së re kombëtare. Kjo enciklikë dhe letra drejtuar të nipit (prej motre), për të cilën do të flasim më poshtë, janë gjetur në arkivin e doktor Ivan Seliminskit, kurse sot ruhen në arshivën historike bullgare pranë Bibliotekës Kombëtare «Vasil Kolarov» në Sofje. «Enciklika» nuk e ka datën e botimit, kurse historiografia shqiptare e paraçlirimit dhe ajo bullgare, kur e botuan, i kanë shtuar vitin 1836 pa treguar ndonjë arsye. Çështja e datës së «Enciklika» është rrahur në kohën e fundit në mënyrë të gjerë, por prapë në literaturën tonë nuk është caktuar një datë fikse, prandaj po e shtroj, duke patur për bazë artikullin e Petraq Pepos dhe doktor Stojan Maslevit, botuar në buletinin e Shkencave shoqërore, nr. 2, 1961, ff. 196-214.

58) N. Veqilharxhi: Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti në Vienë.

59) Ivan Kristanov, Ivan Pankov, S. Maslev «Dr. Ivan Seliminski» Akademia e Shkencave Bullgare — Sofje 1962.

Siç na thonë dy autorët, «Enciklika» dhe «Letra e të nipit» janë gjetur nga P. Çiljev në radhorin e dorë-shkrimeve, letrave dhe dokumentave të tjera të doktor Seliminskit. (60). Në këtë radhor, P. Çiljevi i ka vënë datën 1846 «Letrës enciklike për të gjithë të pasurit dhe të mësuarit orthodoxë shqiptarë». Shtojmë këtu se P. Çiljevi, është i pari që zbuloi dhe botoi dy dokumentat e Naum Veqilharxhit, domethënë «Enciklikën» dhe «Letrën për të nipin Jani Calin».

Perikli Çiljevi ka qenë profesor i greqishtes në një shkollë të Sofjes dhe ishte bashkëfshatar i Naum Pannajot Veqilharxhit, pasi edhe ai ridhte nga një familje prej Vithkuqi, që u vendos në qytet të Manastirit në kohën e turbullimeve dhe zullumeve që bëheshin nga bejlerët, aqallarët dhe derebejtë në zonën e Korçës dhe në krejt Shqipërinë.

Për rëndësinë e madhe që kishte ky dokument për popullin shqiptar u botua në gazetën «Drita» të Shahin Kolonjës, Sofje — V. III Nr. 46 — 14.6.1904 dhe u rishtyp në «Kalendarin kombiar» Sofje, 1906 f. 47-50. Në këtë botim Enciklika mban datën 1836, që u fut në historiografinë shqiptare. Në kohën e riprodhimeve të shënimeve të Dr. Seliminskit në «Kalendarin kombiar», botuesi shqiptar ka bërë disa ndryshime dhe duket se ka shtuar vetë vitin 1836. Në vitin 1928 dokumenti botohet bullqarisht me titullin «Letërqarkore» dhe me vitin 1836 të vënë nga përkthyesja El Pazheva. Si P. Çiljevi që ka vënë datën 1846, ashtu edhe botimet në gazetën «Drita» dhe rishtypja në «Kalendarin kombiar» apo nga El Pazheva, që na japin datën 1836, nuk kanë as spjegimin më të vogël se ku

60) P. Pepo — S. Maslev — Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullqaro-shqiptare gjatë shekullit XIX në Buletinin e U.S.H.T. Seria Shkencat Shoqërore 2(1961)196-214. «Këto dokumente janë ruajtur në dy kopje në fondin e arshivave të Dr. Iv. Seliminskit, arshivë ed. 3.1.58-61 dhe 1.191-193, këto janë përmendur nga P. Çiljev në radhorin e dorë-shkrimeve, letrave, librave dhe dokumentave të tjera të Dr. Seliminskit, që ndodhen në Ministrinë e Arësimit (shih Biblioteka Dr. Iv. Seliminski libri I, Sofje, 1904, f. 25 e 27).

bazohen për këto data (duke qenë se kopja e Dr. Seliminskit nuk mban datë).

Dr. Stojan Maslevi dhe Petraq Pepo në artikullin e tyre japin spiegime, që duket se janë bindëse, për këtë gabim të pandërgjegjshëm të bullgares El Pazheva «Ne mendojmë, tani për tani, se tek El Pazheva kjo është ose një gabim shtypi — 1836 në vend të 1846 ose një datë e ndikuar nga botimet shqiptare»(61).

Bindës del nga ky artikull dhe mendimi mbi mundësinë që «Enciklika» të jetë shkruar më 1846. E para, të gjithë dokumentat, në të dy kopjet, vijnë njëra mbas tjetrës në fletoret me kopje të letrave të Dr. Seliminskit dhe atje letrat përgjithësisht janë sistemuar në radhë kronologjike (Autorët flasin për dy dokumenta, që kanë parasysh, përveç letërqarkores dhe letrën që dërgon Naum Veqilharxhi të nipit Jani Calit, që, siç dihet, mban datën 1846. Një arsye e dytë, plotësuese, është se të dy dokumentat pajtohen mirë me veprimtarinë shoqërore të Dr. Seliminskit në Bukuresht gjatë viteve 1846-1847, kurse në vitin 1836 dhe 1837 ky ishte i zënë me punë për rregullimin e një gjyqi në Sliven.

Argumentave të mësipërme, rreth datës 1846, dua t'u shtoj edhe këtë arsyetim, i cili del ngavetë «Enciklika» dhe flet për përpilim më 1846. Reshtat e para të «Letërsqarkores», megjithëse nuk përmendin as veprën, as autorin, aludojnë për një studim, që ne mendojmë se do të jetë studimi i De Radës «Mbi hyjnitë e pellazgëve», për të cilin folëm më lart, hartuar më 1843 dhe që u ribotua më 1844-1845 «Po i këshilloj bashkëatdhetarët tanë që e duan mëmëdhenë, që të vështrojnë me kujdes një studim të ri filologjik, i cili u botua nga gazetatat greke, si një vepër që meriton vëmendje shumë të madhe, aq më tepër pasi kjo ka lidhje me shqiptarët»(62)

61) P. Pepo — S. Maslev — Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgare-shqiptare gjatë shekullit XIX në Buletinin U.S.H.T. seria Shkencat shoqërore 2(1961)196-214.

62) N. Veqilharxhi «Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoksë shqiptarë.» 1846.

Dokument i datuar, që dimë deri më sot mbi veprimtarinë e jetën e Naum Veqilharxhit, përveç dy abetareve që mbajnë vitet 1844 dhe 1845, është dhe letra që i drejton të nipit, Jani Calit, në Vienë, më 7 prill 1846. Letra është gjetur gjithashtu në arshivën e Dr. Ivan Seliminskit dhe është botuar për herë të parë shqip nga gazeta «Shqipëria e Re» Kostancë, 29 korrik 1923. Veqilharxhi në këtë letër u përgjigjet sulmeve, qortimeve dhe qesëndisjeve të të nipit grekoman, me ton të qetë, të qartë, të argumentuar, me qëllim që të fuste tek i nipi dashurinë për mëmëdhenë. Për mendimet, dëshirat, optimizmin që ruan letra, është një nga dokumentat më të bukura të patriotizmit shqiptar. Me të drejtë në «Historinë e letërsisë shqipe» Dhimitër Shuteriqi e ka vlerësuar: «Letra e tij me të nipin mbetet si një nga dokumentat më të shkëlqyera të patriotizmit shqiptar në shek. XIX.»(63)

Është me rëndësi të njihet miqësia dhe marrëdhëniet që ka patur rilindasi ynë me rilindasin bullgar Dr. Ivan Seliminski; nga ana tjetër të sqarohet mendimi që egziston në literaturën bullgare në lidhje me çështjen se kush është autori i dy dokumentave, i «Enciklikës» dhe i «Letrës për Jani Calin.»

Naum Veqilharxhi në Bukuresht njihet dhe lidh miqësi me personalitetin e rilindjes bullgare Dr. Ivan Seliminski, i cili, siç dihet, nga gushti i 1845-ës e gjer më 1849 ka jetuar në Bukuresht. Dr. Ivan Seliminski ka lindur në dhjetor të 1799 në qytetin Sliven. Emri i tij i vërtetë është Jordan Jorgjev Hristov. Dr. Ivan Seliminski ka kontribuar shumë në historinë e rilindjes bullgare dhe në mendimin filozofik bullgar. Miqësia midis rilindasit shqiptar dhe atij bullgar nuk është një takim i rastit në emigracion, por sintezë e qëllimeve dhe idealeve të njëjta, është miqësi mendimi dhe armësh.

Në librin me titull «Dr. Ivan Seliminski» me autor Prof. Dr. Cvetan Kristanov, Dr. Stojan Maslev dhe Dr.

63) Dh.S. Shuteriqi, Historia e letërsisë shqipe, vëll. II, bot. U.S.H.T. — 1960 ff. 220.

Ivan Pankov (botuar në Sofje në vitin 1962) në analizën e mendimeve filozofike të Dr. Ivan Seliminskit nga letra e Naum Veqilharxhit, që ia drejton të nipit, marrin shembëll për pikëpamjen e tij mbi evolucionarizmin. Në faqen 391 kanë shkruar tekstualisht kështu: «Në natyrën e njeriut nuk ka hope, por kalime graduale, shkruan Dr. Ivan Seliminski, në emër të iluministit shqiptar Naum Veqilharxhi, në letrën drejtuar të nipit...» (64). Por, duket, literatura bullgare bashkëpunimin Seliminski-Veqilharxhi e ka trajtuar dhe vlerësuar në mënyrë të njëanëshme, duke ia dedikuar krejtësisht Dr. Ivan Seliminskit hartimin e «Letrës enciklike» drejtuar gjith shqiptarëve orthodoxë të pasur dhe të mësuar» më 1846 dhe «Letrën drejtuar të nipit Jani Calit në Vienë» më 7 prill të vitit 1846. Një mendim i tillë shihet edhe në faqe të tjera të librit të mësipërm. «Seliminski ka qenë bullgari i parë i kulturuar, i cili shumë herë ka hyrë në lidhje drejt për drejt me një nga udhëheqësit më të hershëm të Rilindjes shqiptare Naum Veqilharxhi, duke i shkrojtur qarkore speciale (e kanë fjalën për «Enciklikën» drejtuar popullit shqiptar M.I.) me frymën dhe mendimet e tija personale dhe «Letrën drejtuar të nipit».

Kurse në faqen 170 shkruajnë: «Me durim dhe me mirësjellje janë hedhur poshtë në përgjigjen e pohimeve të Calit nga Veqilharxhi, domethënë nga Seliminski. (65)

Për këtë vlerësim autorët e librit «Dr. Ivan Seliminski» janë nisur nga një shënim i gjetur në fund të dokumentave të Naum Veqilharxhit, që ndodhen në arkivën e Dr. Ivan Seliminskit ku shkruhet: «Letra e mëposhtme për J. Calin dhe kjo enciklikë u redaktuan prej meje, — Iv. Seliminski — me kërkesën e mikut tim

64) Iv. Kristanov, Iv. Pankov, S. Maslev «Dr. Ivan Seliminski», Akademia e Shkencave bullgare — Sofje, 1962 f. 391.

65) Iv. Kristanov, Iv. Pankov, S. Maslev «Dr. Ivan Seliminski», Akademia e Shkencave Bullgare — Sofje, 1962 f. 170 dhe 441.

Naum Veqilharxhit nga Bythkuqi i Shqipërisë, çpikësit të shkronjave të reja shqipe»(66).

Bashkëpunimi për shkrimin e këtyre dy dokumentave mund të ketë qenë i nevojshëm për Naum Veqilharxhin vetëm për faktin se këto shkrime duheshin hartuar greqisht, gjuhë të cilën Dr. Ivan Seliminski e zotronte shumë mirë, sepse gjimnazin dhe studimet e larta i kishte kryer në Greqi, kurse për Naum Veqilharxhin nuk kemi ndonjë të dhënë që të dinte mirë gjuhën letrare greke. Por, nuk përjashtohet mundësia që Dr. Ivan Seliminski të ketë çfaqur ndonjë mendim të vetin gjatë redaktimit të dokumentave. Me gjithë atë, nuk duhet dyshuar për asnjë çast që këto shkrime janë të rilindasit tonë të shquar Naum Veqilharxhit për këto arsye:

Në «Enciklikë» dhe në «Letrën drejtuar të nipit, Jani Calit» bëhet aluzion për çështjen e Shqipërisë me një frymë të tillë, që rilindasi ynë i madh i ka çfaqur edhe në «Eparathënme mbi djelm e rinj shqiptarë» të «Ëvetarit» të vitit 1845. Për hartimin dhe botimin e «Ëvetarit» të vitit 1844 dhe 1845 s'ka ndonjë të dhënë për njohje dhe bashkëpunim me Dr. Ivan Seliminskin.

Midis gjykimeve dhe këshillave të çfaqura nga Naum Veqilharxhi në «Eparathënme mbi djelm e rinj shqiptarë» dhe ideve të tija të hedhura në «Enciklikë» dhe në «Letrën drejtuar të nipit, Jani Calit», nuk ka ndryshime esenciale, sepse janë shtjellime të të njëjtit mendim. Ndryshimet midis veprave që përmendëm më lart qendrojnë vetëm në formë, se idetë themelore janë identike. «Ëvetarin» së bashku me «Eparathënme mbi djelm e rinj shqiptarë» Naum Veqilharxhi e kish përgatitur për fëmijët dhe me pjekuri e aftësi mendimet i kish shtjelluar me një gjuhë të kuptueshme për këtë moshë, kurse «Enciklikën» e kish përgatitur për t'i bërë thirrje gjithë elementit përparimtar dhe më të ndërgjegjshëm të klasës së tij dhe për të nipin që ish njeri me arësim

66) P. Pepo — S. Maslev — Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgaro-shqiptare gjatë shek. XIX, në buletin e U.S.H.T. seria shkencat shoqërore 2(1961) 196-214.

E gjithë kjo tregon se Naum Veqilharxhi nuk ka qënë fillestar, por një patriot i madh me mendim shoqëror të pjekur.

Është krejt pa vend të mendohet se një njeri me ideale kaq të mëdha, që merr përsipër një ndërmarrje sa të rëndësishme e të domosdoshme aq dhe të vështirë, siç ishte krijimi i alfabetit për gjuhën shqipe, të jetë fillestar dhe i paaftë që t'i kthejë përgjigjen e duhur nipit të tij. Gjithashtu nuk mund të jenë dy dokumentat prodhim i Seliminskit, se në «Letrën drejtuar të nipit, Jani Calit» dhe në «Enciklikë» janë ngritur shumë çështje nga historia e kaluar dhe aktuale e Shqipërisë, për të cilën Naum Veqilharxhi interesohej në mënyrë të posaçme si edhe të dhëna nga jeta private e autorit (Veqilharxhit).

Që Naum Veqilharxhi ishte njeri me ideale të mëdha ne e kuptojmë edhe nga fjalët që i drejtonte i nipi me letrën e 6 marsit, një pjesë të së cilës e njofim nga vetë Naum Veqilharxhi, i cili në letrën e tij të përgjigjes për të nipin, më 7 prill 1846, shkruan disa paragrafë nga letra e Jani Calit dhe i analizon thellë dhe bukur. Nga ana tjetër, pjesëmarrja e Naum Veqilharxhit me vetëdijë në organizatën «Filiqi Heteria» dhe në revolucionin antiturk dhe antifeudal në Vllahi në vitin 1821, flet për një njeri të përgatitur dhe me pikpamje politike përparimtare prej të paktën 20 vjet më parë. Veprimtaria patriotike e Naum Veqilharxhit gjatë viteve 1825-1845 (hartimi i alfabetit dhe botimi i abetareve) dëshmon për një vazhdimësi dhe thellim të mëtejshëm në rrugën e forcimit të përpjekjeve të tij për lëvizjen kombëtare, ajo logjikisht është një hallkë që lidhet me hartimin origjinal të «Enciklikës» dhe të «Letrës drejtuar të nipit, Jani Calit» dhe në mënyrë të padiskutueshme provon se vetë Naumi ka qënë autori i tyre. Është e natyrshme se në këto kushte gjithë elementi përparimtar dhe patriot me botëkuptim të caktuar, qofshin këta shqiptarë, rumunë, bullgarë, grekë etj kishin synime të njëjta, ndihmonin dhe ndikonin mbi njëri tjetrin për të gjetur rrugën më të përshtatëshme në luftë kundër të njëjtit armik dhe të njëjtave shkaqe.

Së fundi, vetë Dr. Ivan Seliminski me dorën e tij shkruan në fund të dy dokumentave se kjo enciklikë dhe letër «*u redaktua*» prej tij. Pra, vetëm u redaktua, s'ka nevojë të spiegojmë se të redaktosh një dokument nuk do të thotë ta hartosh atë.

Nga këto arësytetime mund të arrijmë në përfundimin se njohja me Dr. Ivan Seliminskin nuk ishte vendimtare për formimin e botëkuptimit të Naum Veqilharxhit, sepse dhe vetë pikëpamjet e Dr. Ivan Seliminskit janë pjesë e atyre pikpamjeve mendore që ishin përhapur gjërësisht në këtë kohë në Ballkan dhe kishin ndikuar mbi Veqilharxhin ashtu si edhe mbi Seliminskin vetë.

• • •

Megjithëse nga veprimtaria e Naum Veqilharxhit njihen vetëm katër vepra, «*Ëvetari*» i vitit 1844, «*Ëvetari*» i vitit 1845, «*Enciklika*» dhe «*Letra për të nipin Jani Calin*», ne mendojmë që prodhimi i autorit tonë nuk kufizohet vetëm me kaq, por do të ketë shkruar edhe më. Këtu na shpie edhe ky pasazh, që kemi nxjerrë nga «*E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë*». «*...nukë vetëm edhe këtë Ëvetar të ri t'ap mbë dritë, po edhe gjithato që kam bërë gati; edhe që sa vjet i madhi zot të më falnjë, i kam për të tërthertur, duke punuar për vendin tim e tuajnë, edhe për këtë gjuhën tonë*». (67)

Këtë mendim na i përforcojnë gjithashtu edhe informatat e autorëve të ndryshëm, sipas të cilave Naum Veqilharxhi ka dhe materiale të shumëllojëshme në dobi të arësimit shqiptar dhe të çështjes kombëtare. Në vitin 1918 në revistën «*Ylli i Mëngjezit*» Kristo A. Dako shkruante: «*Naum Veqilharxhi u përpoq të përhapë shkrimin dhe këndimin e gjuhës shqipe, dhe shtypi një abetare dhe disa librëza të vogla. Naum Veqilharxhi na la trashëgim dhe një numër veprash në dorëshkrim, të cilat sot gjenden në dorë të nipit të tij.*

67) N. Veqilharxhi: «*E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë*» • «*Ëvetari*» të 1845.

mikut dhe bashkënxënësit tonë zotit Gjergj Orleanua, që është avukat dhe rron në Buzeu të Rumanisë... Për fat të mirë veprat e tija shpëtuam dhe shpresojnë se një herë do t'i shohim në dritë.

Më 1914, kur isha në Korçë, — shkruan Kristo A. Dako — hyra në letërkëmbim me Z. e tij për të ardhur në marrëveshje për të shtypurit të veprave të Naum Veqilharxhit. Fatkeqësisht trubullimet që ardhë, nuku na lanë të vinim në veprim dëshirën dhe planin tonë».

Informacionit të rëndësishëm që na jep Kristo A. Dako mund t'i besohet, meqenëse, si shkruan dhe vetë, ka qenë mik dhe bashkënxënës i nipit të Naum Veqilharxhit. Më vonë u bënë përpjekje për të shtënë në dorë këto dorëshkrime, por nuk dhanë rezultat. Shpresat për të shtënë në dorë një ditë këto materiale të vjera ende s'janë shuar.

MENDIMET ARËSIMORE-KULTURALE DHE POLITIKE

«Meritat historike nuk çmohen në bazë të asaj që nuk dhanë njerëzit e shquar, në krahasim me kërkesat e sotme, por në bazë të asaj që ata dhanë të re në krahasim me paraardhësit e tyre».

V. I. Lenini

Revoltat e kryengritjet që u zhvilluan në Shqipëri në vitet 30-40 të shekullit XIX nuk kanë patur një program politik të përcaktuar, goftë dhe në vijat më kryesore. Masa e fshatarëve ishte hedhur në kryengritje gjithmonë me kërkesa për të kundërshtuar sistemin fiskal, shërbimin e detyrueshëm ushtarak, kundër zbatimit të Tanzimatit. Ato i ka karakterizuar mungesa e perspektivës, paqartësia dhe spontaniteti.

Revoltat dhe kryengritjet deri në këto vite nuk kapeshin pas rrënjëve të sëmundjes, por vetëm pas disa fenomeneve të kësaj sëmundjeje. Në thelb kërkesat e tyre ishin të kufizuara nga pikëpamja politike.

Megjithëse këto lëvizje deri në vitet e 40-të të shekullit XIX ishin akoma të dobëta, të paqarta, me karakter lokal, prap se prap ruanin në vetvete forcën e madhe progresive, e cila qëndron në masivitetin dhe drejtimin kundër aparatit burokratik turk dhe shfrytëzimit të eger feudal. Konfliktet e ndeshjet e vazhdueshme luftarake mbanin gjallë patriotizmin popullor dhe nga ana tjetër thellonin akoma më shumë hendekun midis popullit e pushtuesit të huaj.

Kryengritjet popullore, sado që ishin spontane, i dhanë fuqi lëvizjes kombëtare, u bënë përkrahëse të pandërgjegjshme për forcën e re shoqërore që po

rritej dhe po shtonte kërkesat jo vetëm në fushën ekonomike, po dhe në atë politike. Terreni shqiptar ishte përgatitur objektivisht; borgjezia jonë, qofte edhe në gjendjen e saj embrionale, ishte shtresa me e përparuar në këtë periudhë, ishte shprehëse edhe e interesave të popullit për luftën kundër forcave të huaja grabitqare. Ajo shtronte si një kërkesë urgjente, si një domosdosmëri historike nevojën e shkrimit, të gjuhës amtare, të shkollës dhe të kulturës brenda kuadrit kombëtar.

Elementet e ndërgjegjes kombëtare, duke u mbrytur në mënyrë të ngadaleshme për disa dhjetëvjeçarë, dolën në fushë të hapur vetëm aty nga vitet 30 të shekullit XIX. Shprehësi i parë i kërkesave të reja kombëtare u bë Naum Veqilharxhi, me pikepamjet e të cilit filloi ajo periudhë e re, që njihet me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare. Naum Veqilharxhi, me kërkesat që shtron për botëkuptim të ri dhe me rrugën e re që ndjek, do të ndihmojë për të shkeputur prangat akoma të fuqishme të ideologjise së prapambetur të sistemit feudo-usntarak të osmanilinjve.

«Këto nevojë historike në fillim e kuptoi vetëm një rreth i ngushtë shqiptarësh. Zedhënësi i tyre u bë Naum Veqilharxhi, i cili në «Letrën Enciklike» që u drejttoi shqiptarëve orthodhokse në vitet e 40 të shekullit XIX e shprehur snume qarte këto domosdosmëri historike nëpërmjet këtyre fjaleve magjistrale: «Ka ardhur koha që t'i t'akim gjithë paragjykimet e vjeteruara, ka ardhur koha të çonemi e të mundonemi me me pjekuri dhe me me guxim, të këmbëjme udhë, duke marrë këtej e tutje si s'ndebell kombet e përparuara mbi tokë dhe kështu një ditë edhe ne, me deshiën e zotit, shpresojme të rreshtonemi në serën e kombeve të qyteteruara. Dhe duke synuar këtë lë të ecim pa u lekundur, me guxim dhe me këmbëngulje...» (68).

Këto fraza të shkeputura nga «Letër-Enciklikja» përmbajnë esencën e ideve të autorit. Thirrja «për të

68) K. Frashëri: Kumbësë në Konferencën albanologjike, «Mbi fillimet e lëvizjes kombëtare shqiptare», 1963 ff. 583-590.

flakur gjithë paragjykimet e vjetëruara» kumbon si një qortim që Naum Veqilharxhi u bën tendencave për të qëndruar ose për t'u kthyer te e kaluara. Porosia për të «marrë shembëll kombet e përparuara mbi tokë, domethënë vendet ku në atë kohë ishte zhvilluar demokracia borgjeze, zbulon karakterin borgjez-demokratik të pikëpamjeve të autorit dhe synimin ku ai aspiron të arrijë atdheu i tij(69).

Me veprimtarinë e tij Veqilharxhi shënon cakun e një periudhe të re me ndryshimin cilësor ngre në një shkallë më të lartë krejt lëvizjen shqiptare. Kryesorja, që lidhet me emrin e Naum Veqilharxhit, është se ai na dha i pari programin e ri politik në shkallë kombëtare, në kushtet e reja, kur po lindnin dhe zhvilloheshin merrëdhëniet kapitaliste. Me anën e këtij programi aspiratat e trubullta dhe të pandërgjegjshme u sqaruan dhe u bënë më të gjëra dhe më të thella; u shndërruan në kërkesa esenciale dhe konkrete.

Dy veçori të formimit ideologjik dhe të veprimtarisë të rilindasit tonë të shquar janë:

Së pari, si burim për formimin ideologjik të tij, për idetë dhe konceptet e reja i ka shërbyer vetë realiteti shqiptar, lëvizjet e përgjithëshme nacionale çlirimtare në Ballkan dhe fryma që mbizotëronte në këtë kohë.

Së dyti, këto mendime dhe konkluzione ai kërkon që të shkrihen e të bëhen pronë e lëvizjes, të asimilohen gradualisht nga gjithë populli shqiptar.

Botëkuptimi i Naum Veqilharxhit është aq pozitiv, sa ne edhe sot mund të nxjerrim ide dhe mësim të vlefshme, si për shembëll, besimi tek populli, besimi në forcën e punës etj. Naum Veqilharxhi është mbartës dhe propagandist i iluminizmit; këtë e shohim në rrugën e përgjithëshme që ndjek për realizimin e idealit, e shikojmë në aksionin e tij kultural, që mundohet ta realizojë me anën e alfabetit të gjuhës amtare të letërsisë dhe shkollës shqipe të pavarur nga të huajt. Idetë e

69) N. Veqilharxhi «Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë», 1846.

iluminizmit, të cilat lojtën një rol të rëndësishëm në shekujt e kaluar në ato vende, ku u zhvilluan më herët marrëdhëniet kapitaliste, ndikuan, ndonëse me vonë, siç është e kuptueshme për ambientin e prapambetur ballkanik edhe në popujt e këtij gadishulli në vitet 20-30 të shekullit XIX. Duke vënë theksin mbi arësyt si parimin dallues që karakterizon njeriun, ata demaskonin me guxim obskurantizmin mesjetar, godisnin me vendosmëri absolutizmin dhe bujkrobërine. Duke u nisur nga këto parime, Naum Veqilharxhi përpiqet së pari të gjejë shkaqet e prapambetjes. Nga «Enciklika» ne mund të kuptojmë se Naum Veqilharxhi është mundur të konstatojë shumë shkaqe të prapambetjes së popullit dhe të gjëndjes aq të mjeruar të Atdheut. «Invadime shumë të shpeshta, përmbysje të tëranëshme, ndryshime politike, hyrje dogmash të reja fetare — ja shkaqet e transformimit tonë moral të tanishëm dhe sidomos lënia pas dore e lërmimit të gjuhës sonë kombëtare dhe zëvendësimi i saj me një gjuhë të huaj, na suall në gjendjen më të ulët të turpër» (70).

Në keto shkaqe, ai ka vënë theksin në mungesën e gjuhës së shkruar, duke mos mundur të depertojë në arësytet e thella ekonomike. Përgjithësisht duket se botëkuptimin e Naum Veqilharxhit e karakterizojnë pikëpamje idealiste siç shihet në rolin që lot në botëkuptimin e tij «arësyeja». Naum Veqilharxhi në teorinë e njohjes i ve rëndësi arësyes, duke e marrë si një mjet vendimtar, që e lartëson njeriun, që e ka ndarë nga bota e kafshëve dhe që e ben zotin e të fshehtave të gjithësisë. Keto elemente të botëkuptimit të tij filozofik janë racionaliste dhe kanë rëndësi, se mesjeta e kishte braktisur arësytet dhe e kishte zëvendësuar me dogmat e biblës dhe kuranin, duke i mbajtur njerezit në erresirë të plotë. Duke e ngritur kaq shumë rolin e arësyes në njohjen e botës, Naum Veqilharxhi është në rrugën e racionalistëve francezë, të cilët e çmonin shumë forcën e arësyes njerëzore. Me vendin që i jep arësyes, na

70) N. Veqilharxhi «Letër enciklike për gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë», 1846

le të kuptojmë se kemi të bëjmë me një nga racionalistët e parë të Rilindjes sonë Kombëtare.

Pranë rolit vendimtar që i jep arësyes, Naum Veqilharxhi ka vlerësuar në mënyrë pozitive punën e njerëzve. Duke folur me respekt për punën, ai përmend në «Letër enciklikë» edhe koncepte të reja në fushën ekonomike-shoqërore, si për shembëll termat «industrial», «mekanikë», «shkencë», «arte të bukura» dhe «politikë», të cilat bëjnë pjesë në thesarin e grumbulluar nga përparimi njerëzor. Duke çmuar shumë lart këto fitore, ai jep porosinë që të ruhen me kujdes dhe të zhvillohen më tej nga brezat e ardhshëm. «Bujqësia, ndërtimi, tërë industria, politika, feja, mekanika, gjithfarë artesh të bukura dhe shkencash, të gjitha këto në fillim me shumë të meta dhe pastaj duke u përmirësuar dalngadalë iu dorëzuan brezit tonë, në gjendjen e sotme. Prandaj, edhe secili duhet të veprojë duke i imituar ata»(71).

Një tjetër koncept filozofik që sundon në trajtimin e shumë problemeve nga Naum Veqilharxhi në letërn «Enciklike», në «E parthënme mbi djemt e rinj shqiptarë» dhe sidomos në letër-përgjigjen, që i drejton të nipit, është evolucionarizmi. Ai e sheh gjithçka në zhvillim gradual, në kalimin nga më e ulta në më të lartën, nga ajo që s'ka formë, nga e pazhvilluara në të zhvilluarën, nga e vjetra në të renë, duke e kuptuar dhe vlerësuar karakterin progresiv të këtij evolucion. «Kështu pra njerëzit, që në kohët më të lashta filluan lërimin e gjuhës së tyre duke u zhvilluar dora dorës, duke u nisur nga gjërat më të vogla dhe dalëngadalë ato që s'lidhen, u dhanë forme atyre që nuk kishin forme»(72).

Në botëkuptimin e tij ne shohim edhe elemente të dialektikës spontane. Me gjithë atë, ai nuk kupton siç duhet ndryshimet cilësore dhe të menjëherëshme. «Dhe çdo veçori e fituar më vonë është dhe e ndry-

71) N. Veqilharxhi. «Letra enciklike për gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë». 1846.

72) N. Veqilharxhi Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti në Vienë.

shueshme. Pra, kush mund të na sigurojë se këto do të mbeten vazhdimisht në jetë të jetëve të pandrequra? Asnjeri!... Në natyrën njerëzore nuk shohim kërcime, por rregull gradual. Kështu pra njerëzit duke marrë për ditë ato më të mirat dhe duke hequr mënjatë ato që s'vlejnë, ecin përpara duke u përmirësuar». (73)

Në mendimet dhe këshillat që i dërgon të nipit, Naum Veqilharxhi i ka kushtuar vëmendje të madhe përcaktimit të figurës së njeriut patriot. Ai krijon me mënjurinë e tij portretin e patriotit shqiptar, për të cilën përdor fjalët më të bukura dhe më të goditura, që rrallë i gjen në letërsinë shqipe. Rilindasi i madh ju jep shqiptarëve një model patriotizmi. Veqilharxhi moralin e ka çmuar si një nga format e ndërgjegjes shoqërore. Demokratike është ideja e tij mbi nënshtrimin e interesit personal ndaj atij shoqëror. Kjo ide i ka kaluar kufitë e klasës që e lindi dhe që përfaqësonte. Ai me përbuzje flet për njerëzit të cilët gjithë vëmendjen e përqëndrojnë tek interesi i tyre personal, për realizimin e të cilit nuk ndalen, por përdorin çdo lloj mjeti të lejueshëm e të palejueshëm, që nga gënjeshttrat, batak-tillëqet e deri tek vjedhja. Njerëzit me një moral të tillë çë kalbur, i karakterizon individualizmi, egoizmi, pesimizmi dhe dëshpërimi. «...dëmtim moral pësojnë në përgjithësi njerëzit që i sjellin dëm shoqërisë dhe të tillë janë ata që dëmtojnë familjen dhe shoqërinë, si gënjeshtarët, batakçinjtë, çprishësit, trubulluesit, vjedhëtarët, hajdutët... dhe të tillë a do të mësohet o nipi im cilët janë? Ata që kanë përqëndruar të gjithë vëmendjen në veten e tyre, duke mos treguar asnjë interes për të tjerët. Këta, duke e kuptuar keq fjalën interes përdorin çdo mjet të lejuar e të palejuar vetëm për të grumbulluar argjend dhe ar...»(74).

Naum Veqilharxhi e ngriti më lart mendimin pedagogjik shqiptar të gjysmës së parë të shek. XIX, duke bërë kështu një hap të madh përpara në krahasim me mendimin pedagogjik të shek. XVIII. Lulëzimi i peda-

73) N. Veqilharxhi, Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Buku-reshti në Vienë.

74) N. Veqilharxhi, po aty.

gogjisë sonë të Rilindjes kombëtare dhe karakteri i saj demokratik është i lidhur ngushtë me përpjekjet e popullit tonë për liri, pavarësi dhe përparim shoqëror, frymë kjo e snprehur për herë të parë nga rilindasi ynë i snquar, Naum Veqilharxhit. Ai, me bindjet e veta si demokrat-borgjez, me dashurine e vet për popullin e thjeshtë dëshiron një arsim për masat e gjera të popullit. Përmes abetares, që është një nga veprat më popullore të tij, si dhe përmes «Enciklikes» ai u bë një propagandist i zjarrte i përhapjes së dritës së arsimit. Veçanërisht i rëndësishëm në mendimin pedagogjik të Veqilharxhit është përcaktimi i sistemit të shkollës shqipe. Ai ishte përkrahës i shkollës laike dhe vendin kryesor në teresinë e njohurive ta zinin lëndët shkencore. Një mendim i tillë del akoma më i guximshëm kur mendojmë për karakterin mesjetar të arsimit të atëhershëm. Për Veqilharxhin kërkesa për shkollë e arsim nuk që qellim në vetvete, por një bindje e diktuar nga rrethanat objektive, një domosdosmëri, një mjet i dorës së parë për zgjimin e ndergjegjes kombëtare, për emancipimin e masave, për propagandimin e ideve patriotike.

Sistemi pedagogjik i Veqilharxhit, i ndertuar mbi bazat demokratike, përbën themelin nga u nis mendimi i mevonshëm pedagogjik i Rilindasve.

Naum Veqilharxhi, burim për të gjithë të këqijat e popullit quante paditurinë, të cilën e shihte si një plagë të madhe shoqërore. Vetëm arsimi dhe kultura në gjuhën amtare, mund të ishin mjeti më i sigurtë e më i shpejtë për t'u çliruar dhe për t'u zhvilluar. «Sa kombe kanë mbetur në padije, u ngjasin gjithnjë robeve, duke punuar çdo ditë për begatinë e kombeve me të qyteteruara dhe më të fuqishëm; keto vetëm atëhere do të mund të dalin nga gjendja e turpeshme e mjerimit të tyre, kur do të fillojnë të lërojnë gjuhën e tyre kombëtare...»(75).

Gjuhën amtare Naum Veqilharxhi në «Eparthënme për djemt e rij shqiptarë» e çmon si bazë të arsimit

75) N. Veqilharxhi «Letra enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoksë shqiptarë», 1845.

dhe kulturës kombëtare, duke e parë në prizmin psikologjik. Gjuha amtare është faktor i rëndësishëm në zhvillimin mendor të fëmijës dhe në përvetësimin e shpejtë të njohurive të dhëna në shkollë. «...mund të them me zë të lartë para botës e të rrëfenj mundimin e kotë që kanë hequr dhe heqin me të dhënit e t'mësuarit gjuhëve t'huaj. Se gjer të mësojnë vetëm të këndojnë e të shkruajnë mirë duhen dy-tre vjet, e sa të mësojnë ca gjuhën, atë të huajënë, shkonin edhe aqë, e mbë në fund, me të hequr gjatë të mësuarit s'dinin fare gjë...» (76).

Njohja sa më e mirë e gjuhës amtare lehtëson edhe studimin e gjuhëve të huaja. Këtë koncept në «E parthënme mbi djemt e rij shqiptarë» Naum Veqilharxhi e shtron mbi baza shkencore. «...Edhe kur t'arrinjë mbi mësimet të lartëra, përsëri mbë gjuhë të tij çpejt merr përpara: prandaj, po të niohë gjuhën e tij mirë e lehtë, mësoj çdo të huaj...»(77)

Naum Veqilharxhi e ka çmuar dhe i ka dhënë rëndësi të madhe edukatës si një nga faktorët kryesorë të zhvillimit të njeriut. Këtë mendim e ka formuluar në mënyrë figurative në letrën që i dërgon të nipit, ku thotë: «Mesimet janë si farërat nga të cilat ato që bien në rrugë shkelen dhe ato që bien ndërmjet gjëmbave mbyten nga barërat e tjera, kurse ato që bien në tokë të mirë e pjellore japin njëqind për një dhe dhjetë mijë për njëqind dhe kështu çdo gjë, duke u përmirësuar dora-dorës bëhet e plotë(78).

Ose kur thotë: «...të gjitha janë bërë prej duarve të njerëzve t'arrirë...»(79).

Edukatën e çmon si fenomen shoqëror që nuk ka analogji me botën e kafshëve. Ai e përcakton qartë rrugën që ndjek njeriu në zhvillimin e perfeksionimin

76) N. Veqilharxhi: «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» e «Evetarit» të 1845.

77) N. Veqilharxhi: «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» «Evetarit» të 1845.

78) N. Veqilharxhi Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti në Vienë.

79) N. Veqilharxhi, Po aty.

e tij, shikon perspektivën, vlerëson shumë drejt nevojën e zhvillimit të personalitetit. Këto pikëpamje të shëndosha filozofike e pedagogjike duken qartë në këshillat që i drejton të nipit. Në «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» Naum Veqilharxhi hedh idenë se është e nevojshme që të gjithë të kenë të drejtë të marrin edukatë e mësim. Veqilharxhi është i pari që kërkon kështu demokratizimin e arësimit për ta bërë atë popullor. Pikëpamja e tij demokratike mbi arësimin e përgjithshëm lindi tek ai jo spontanisht, por si rezultat i njohjes konkrete të gjendjes arësimore të popullit shqiptar, të cilën e pershkruan, në «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» ...e vetëm të vini re, që, gjer sot s'patëm pasur, shohëmë, që ndë pesëqind shtëpi, ja gjenden jo s'gjenden pesëdhjetë veta mbarë-prapë (mirë-keq) diç dinë të shënojnë edhe ata ndë gjuhë të huaj... (80)

Naum Veqilharxhi kërkonte të merreshin masa konkrete për të luftuar këtë gjendje, masa për përparimin e arësimit të përgjithshëm, sepse pa dije, populli nuk mund të fitojë lirinë politike dhe, nga ana tjetër, një popull të mësuar dhe të kulturuar është vështirë ta mbash në shtypje dhe robëri. Nga polemika me të nipin në letrën e 7 prillit të 1846-ës kuptohet se ç'e shtynte Naum Veqilharxhin që të dilte me mendimin për arësim të përgjithshëm, kjo sepse ai kishte formuar një koncept të drejtë mbi njeriun, të cilin e çmonte jo nga pasuria, por nga puna dhe virtytet. Pikërisht ky vlerësim dhe kjo njohje objektive e bënë të drejtonte vëmendjen nga populli, duke kërkuar arësim për «djemt e skamësve» (të varfërve M.I.), sepse «vetëm kamësit (të pasurit M.I.) mësojnë jashtë...» vetëm fort pak kishin e kanë pak, e shumica tjetër dergjet nd'errësirë të padijes» (81).

Ne «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» ai proteston kundër pikëpamjeve reaksionare, sipas të cilave vetëm fëmijët e klasave të pasura kishin aftësi e të drejtë për arësim; nga ana tjetër, ai ka theksuar do-

80) «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» e «Ëvetariti të 1845-ës.

81) Po aty.

mosdoshmërinë e të mësuarit për të gjithë, pavarësisht nga klasat dhe pasuria.

Shumë i rëndësishëm është mendimi i shprehur nga Naum Veqilharxhi, se arësimi dhe shkolla duhet t'j shërbejnë shoqërisë, pra edhe çështies kombëtare. «...S'ka gjë më të bukur kur çdo vend ka gjuhën, ka të shkruemen e vet...»(82).

Me «Ëvetarin» e 1844-ës dhe sidomos me «Ëvetarin» e 1845-ës, Veqilharxhi bëri një përpjekje serioze për ta vënë mësimin e gjuhës shqipe mbi baza shkencore; ai bëri përcapjen e parë për të pasuruar gjuhën me terma dhe fjalë të reja dhe për ta pastruar nga fjalët e huaja. Nga letra e parisë korcare e nga mendimi që çfaq në letrën që i dërgon të nipit, mendojmë se Naum Veqilharxhi ka cmuar dhe rëndësinë e shtypit. Nuk është e rastit që rilindasi ka dëshëruar të ngrejë një shtypshkronjë, duke u nisur nga mendimi se «...pa cpikien e shkronjave dhe të tipografisë, të gjitha do të ishin ende në gjendjen e tyre foshnjore...»(83).

Naum Veqilharxhi dënonte shkollat e huaja brenda vendit, duke i cilësuar ato si përcarëse të popullit. Ai, sidomos, ka protestuar në letrën «Enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoksë shqiptarë» kundra dërgimit të fëmijëve për të bërë shkollën jashtë vendit «para se të përgatiten në gjuhën e kombit të vet». Në këtë mendim Veqilharxhi duhet të ketë dalë duke u nisur nga këto arësye:

Së pari, shkollat në vendet e huaja që ka hapur Greqia janë ngritur, siç thotë Veqilharxhi në polemikën me të nipin, për të «ndricuar rininë greke dhe jo për ndricimin e kombit shqiptar». Me këtë rast ai çfaq mosbesimin tek mësuesit e shkollave të huaja, të cilët nuk duan dhe nuk mund të japin njohuri të sakta mbi kombin shqiptar. «Por u besove trashë e trashë mësuesve të tu se gjer tani ky komb (shqiptar) paska qenë një gurë anorganik...»(84).

82) «E parathënme mbi dielmt e rii shqiptarë» e «Ëvetarit të 1845-ës.

83) N. Veqilharxhi «Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoksë shqiptarë» 1846.

84) Letër Jani Calit më 7 prill 1846 nga Bukureshti në Vienë.

Së dyti, duke njohur situatën dhe propagandën shoviniste të qarqeve borgjeze greke, të cilave u jepej mundësia të helmonin më kollaj ndërgjegjen e të rinjve shqiptarë që ishin «larg prindërve, far' e fisit dhe miqve» dhe t'u shkaktinin humbjen e ndjenjës kombëtare, në këtë mënyrë këta elementë «aftësitë e të rinjve» i vinin në shërbim të interesave të tyre shoviniste për t'i shfrytëzuar në dobi të qarqeve sunduese të kombit të tyre. Efekti i kësaj propagande i shpuri disa persona të dobët në atë gradë, sa të mohonin karakterin e tyre shqiptar dhe të preferonin të quheshin «grekë», «helinë», «vlllehë». Dhe raste të tilla nuk ishin të rralla; si shembëll të kësaj natyre, Naum Veqilharxhi merr dhe të nipin. «Disa nga tanët patën fatin që gjatë epokave të ndryshme të marrin arësim, detyroheshin pa dashje të mërgonin në vende të tjera, të bëhen të pavlefshëm për kombin tonë nga që nuk njihej gjuha e jonë kombëtare; larg prindërve, far' e fisit dhe miqve, për të gjetur mundësinë e jetës, duke u fërkuar me disa kombe të tjera dhe duke u afruar me ta, duke bashkëpunuar dhe duke ndihmuar, me aftësitë e tyre për lumturinë e këtyre kombeve; e kështu kënaqeshin të quhen grekë, helinë» (85).

Kjo propagandë kundër kombit shqiptar nuk bëhej vetëm nga shkollat e huaja dhe nuk dëmtonte vetëm ata persona që emigronin ose shkonin për të mësuar jashtë vendit, por ishte një politikë e tërë e qarqeve turke dhe greke e studiuar dhe e vënë me kujdes në jetë.

Porta e Lartë, për të realizuar sa më lehtë synimet e veta, vazhdonte të identifikonte kombësinë me fenë. Okupatori turk dhe qarqet e vendeve fqinje e përdorin këtë për të dobësuar dhe përçarë popullin e krahinave shqiptare. Ata ndiqnin parimin e vjetër romak «përça e sundo»; nëpërmjet klerit, shkollave, administratës dhe me çdo mjet ata vazhdonin të mbanin të gjallë

85) N. Veqilharxhi «Letër enciklike» për të gjithë të pasurit e të mësuarit ortodoksë shqiptarë» 1846.

armiqësinë ndërmjet myslimanëve dhe orthodoxëve, ndërmjet myslimanëve dhe katolikëve.

Karl Marksi dhe Frederik Engelsi në artikullin «Shpallja e luftës myslimane dhe të krishtere» shkruanin për këtë politikë fetare turke në vitin 1854: «Kurani dhe legjislacioni mysliman, i bazuar në të, e reduktojnë gjeografinë dhe historinë e popujve të të gjithë botës në formulën e thjeshtë dhe të vulltëshme të ndarjes në dy pjesë: besimtarë e të pabesë. I pabesi është «kaur», është armik. Islami e mallkon kombin e të pabesëve dhe krijon një gjëndje armiqësie të pandërprerë midis myslimanëve dhe të pabesëve»(86). Turqia, duke ushqyer këtë armiqësi, kishte si qëllim të dobësonte rezistencën luftarake të popullit dhe, nga ana tjetër, të zhdukte hendekun që ndante myslimanin shqiptar nga myslimani turk. Po nga kjo politikë përfitonte edhe kisha greke e më vonë borqjezia shoviniste greke, që, duke i futur të gjithë ortodoksët e kombësive të ndryshme të perandorisë nën vartësinë e kishës ortodokse, i dha politikës shoviniste greke mundësitë të shfrytëzojë këtë për t'i konsideruar të gjithë ortodoksët shqiptarë, bullgarë e të tjerë si «grekë». Në perandorinë Osmane si kombësi më vete konsideroheshin edhe katolikët ose «latinë».

Naum Veqilharxhi doli kundër misticizmit dhe besimit të verbër fetar që ushqenin të huajt për qëllime të caktuara, por ai nuk që ateist. Nga botëkuptimi në mund ta fusim atë në rrymën e atyre, që nuk shpëputen plotësisht nga feja, ndonëse pranojnë zhvillimin e ligjshëm të shoqërisë, sendeve dhe fenomeneve. Kjo është rryma e Deizmit, e cila, në ndryshim me teologjinë që e konsideron zotin të mbinatyrshëm dhe çdo gjë, çdo zhvillim dhe ndryshim ja dedikon kësaj fuqie, e merr zotin si forcën e parë lëvizëse, krijuese e mandej sendet e fenomenet ndryshojnë në bazë të ligjeve të natyrës. Në veprimtarinë e Naum Veqilharxhit në shoqim ndikimin fetar në faktin që në «Evetarin» e 1844-ës ka përfshirë dhjetë porositë të biblës.

86) K. Marks - F. Engels, veprat, Botimi gjermanisht vëll. II, f. 170.

Fakti që Naum Veqilharxhi nuk mundi të shkëputet plotësisht nga ideologjia fetare është e spjegueshme, duke marrë parasysh rrethanat e kohës.

Jeta dhe mendimet e pjekura shoqërore që ka çfaqur Naum Veqilharxhi, na lejojnë të arrijmë në konkluzionin se, padyshim, e preokuponin problemet politike të kohës.

Nga Naum Veqilharxhi nuk njohim ndonjë traktat me pikpamjet politike të tija, me gjithë atë, në nga materialet e njohura mund të zbulojmë brendinë e pikpamjeve të tija politike. Ai kish bindje politike që ishin mjaft të avancuara për kohën e tij. Edhe tek ai ndeshemi me po ato pikpamje që i gjejmë tek rilindasit e mëvonshëm. Pra, edhe në këtë fushë ai u paraprin rilindasve.

Pikëpamjet politike të Veqilharxhit burojnë prej pozitës së tij klasore, prej ndikimit të lëvizjeve masive popullore në Shqipëri, prej simpatisë që pati për këto lëvizje si dhe prej kontaktit direkt të ideve të revolucionit antiturk dhe antifudal në Vllahi, në vitin 1821.

Pikëpamjet e Naum Veqilharxhit qëndrojnë në kuadrin e demokracisë borgjeze, sipas shembëllës së vendeve të zhvilluara perëndimore. Se sa i përparuar që ky ideal për kohën, dëshmon jo vetëm fakti se në atë kohë sundimi despotik anadollak i kundërvihet demokracia borgjeze, por edhe se ky ideal për më se gjysmë shekulli pas «Enciklikës» së Veqilharxhit vazhdon të mbetet në programin e rilindasve si një kërkesë e dorës së parë. Duke shprehur pikëpamjet e klasës së vet, Veqilharxhi e lidh të ardhmen e lëvizjes jo me qëndrimin pasiv të borgjezisë, por ai kërkon ta hedhë atë në aksion, ta vejë në lëvizje.

Pozita klasore, dashuria për popullin që vuan nga zgjedha e huaj, e bëjnë Veqilharxhin të mbrujë veprën e tij me një urrejtje të papërmbajtur për feodalët dhe pushtuesit turq dhe sidomos ndaj synimeve të qarqeve shoviniste të borgjezisë së madhe greke. Aspiratat demokratike të Veqilharxhit gjetën shprehjen e tyre edhe në mendimet që kishte ai për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Shqipërisë.

Naum Veqilharxhin e karakterizonte një optimizëm i zjarrtë e besim i patundur në të ardhmen e atdheut. Këtë besim ja frymëzonte shpirti patriotik i popullit tonë, bindjet e vet gjer në vetmohim për të mirën e Shqipërisë.

Veqilharxhi është treguar një politikan largpamës në dallimin e vlerësimin e rrezikut, të cilin e shikonte jo vetëm te pushtuesit turq, por edhe në planet shoviniste të qarqeve sunduese të mbretërisë greke, kundër të cilave ngrihet me forcë, duke u grisur maskën dhe duke nxjerrë në shesh synimet e tyre djallëzore. Ja se si u drejtohet me anën e letrës «Enciklike» gjithë të pasurve dhe të mësuarve orthodoxë shqiptarë: «Erdhi koha pra t'i mbyllim veshët tanë për të gjithë ata që me pretextin e miqësisë dhe të maskave të tjera të panumërta paraqiten dhe na këshillojnë të kundërtën kinëse për të mirën tonë, kurse qëllimi i tyre kryesor është t'na mbajnë për gjithënjë në mjerim që kështu të na përdorin si të duan, si gjer tani... (87).

Kundër veprimtarisë politike të Naum Veqilharxhit, u ngritën qarqet shoviniste greke, klerët e klerit orthodox dhe disa elementë shqiptarë, të cilët ishin edukuar në shkollat greke, e injoronin çdo gjë kombëtare dhe e quanin të padrejtë çdo përpjekje në dobi të Shqipërisë. Një nga këta ishte dhe i nipi i Naum Veqilharxhit, i cili punën patriotike të xhaxhait të vet e quante si «himerë» ose thjesht «marrëzi.»

Naum Veqilharxhi, në polemikën që bën me të nipin, ve në dukje se veprimtaria e tij, idea e tij për zgjimin e popullit nuk është dëshirë subjektive, por e mbështetur mbi të dhëna objektive, siç është egzist nca e një kombi shqiptar, tashmë të formuar. Ai na jep dhe karakteristikat dalluese të kombit si: gjuhën, territorin, historinë e përbashkët dhe psikologjinë e popullit, pa marrë parasysh faktin se populli shqiptar ishte i ndarë në krahina dhe fe të ndryshme.

87) N. Veqilharxhi: «Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoxë shqiptarë», 1846.

Pava rësisht se përcaktimi nuk është i plotë për shkak se nuk njih faktorin ekonomik, përcaktimi që jep Naum Veqilharxhi ka rëndësi, sepse vë në dukje që kombi ishte një kategori historike e formuar historikisht, ndonëse në periudhën që rronte ai nuk ishin përgatitur ende kushtet për formimin e tiparit vendimtar. Me këto fjalë Naum Veqilharxhi i drejtohet të nipit në letrën që i dërgon: «...Por ti, si një burrë me arësim, si nuk e kape idenë nga krahasimi i të gjithë kombeve të tjera, që një komb si ai shqiptar, i krijuar në të njëjtën kohë me kombet e tjera që, zë një vend të caktuar në tokë, nga tipare të veçanta të gjuhës, dokeve, zakoneve...» (88).

Naum Veqilharxhi e mendonte bashkimin e popullit shqiptar, pa marrë parasysh dallimin fetar; ai është i pari që e shtroi problemin e prioritetit të kombësive mbi fenë. Në letrën e prillit 1846, pasi shënon fjalët e rënda të Jani Calit, i cili i quante marrëzi përpjekjet që bënte i ungji «...për të lidhur ato që s'lidhen, të sjellë në formë ato që nuk kanë formë, të bashkojë në një tufë myslimanët fanatikë, të krishterët orthodoksë supersticiozë, papistët që urrejnë fetë e tjera, të krijojnë një trup homogjen nga kombi shqiptar...» (89) Naum Veqilharxhi përgjigjet me një ton të qetë, me një arësyetim bindës, të mbështetur në zhvillimin e natyrshëm të shoqërisë dhe duke e argumentuar me përsëritje që i bën rrugës që kanë ndjekur kombet e tjera deri në formimin e tyre të plotë, ai shkruan: «Këta (njerëzit M.I.) vetëm me anën e mendimeve të përbashkëta mundën të lidhen e të bashkohen e të formojnë mbi tokë shoqëritë njerëzore të vogla e të mëdha, d.m.th. racat, fiset dhe kombet...» (90) Nga rruga që ndoqën këto kombe ai formon bindjen se edhe populli shqiptar do t'i arrijë ato. «...Qysh këta (kombi grek, romak, englez, rus, amerikan) dhe të tjerë si këta u zhvilluan menjëherë që në fillim, apo edhe ata si ne filluan një ditë e duke ecur

88) N. Veqilharxhi, — Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti në Vienë.

89) N. Veqilharxhi — po aty.

90) N. Veqilharxhi, — po aty.

përpara dora dorës dhe me siguri, kanë arritur atje ku ne i shohim sot... (91).

Të gjitha shkrimet e Naum Veqilharxhit dallohen për patriotizmin e tyre të shëndoshë, për optimizmin dhe besimin që në një të ardhme të afërt, kombi shqiptar do të vihet «në radhën e kombeve të qytetëruar»; kjo nuk ishte një dëshirë e thjeshtë patriotike, por një optimizëm i justifikueshëm, që i kishte rrënjët tek virtytet, aftësitë dhe forcat e popullit shqiptar. «...se është e ditur — shkruante rilindasi — që frymet e shqiptarëve, veç që mendjen e kanë të hollë e të mprehtë nga të lerturit e tyre, që mund pa frikë të them se, nukë vetëm arrijnë, po edhe shkojnë shumë farë njerëzve të tjerë, po edhe më tepër janë gjithë sedër edhe dondermjës (që do të mbahet për nder M.I.) Pa andaj ushqen shpresa të mëdha e të ndriçme... (92).

Naum Veqilharxhi e përbuzte elementin që e mohonte kombin, i dënonte ata që mbanin qëndrim pasiv, kurse punën për të ndihmuar këtë vend, që të fitonte ndërgjegjen e zhvillimin e tij, e cilësonte si një borxh ndaj vendlindjes. «...pa kujtuar fare mundim a të lodhur, se e dinja e e njihnja që s'e bënj për ndonjë të mburme që të rrefenj ndë sy të njerëzve, po vetëm që të bënj e të rrefenj detyrën që kesh (borxh M.I.) e kam për vëndlermin tem e për gjuhën time të mëmës (93).

Më poshtë po japim disa nga rreshtat më të bukura që pasqyrojnë patriotizmin e tij me të cilat i drejtohet të nipit, për t'i treguar çdo të thotë të mohosh kombin tënd. «...nuk ka keshillë më të keqe nga ajo që e shtyn njeriun të mohojë kombin vet, domethenë prindërit e tij, far' e fisin e tij, bashkëkombësit e tij, miqt' e tij, vetë vatrën e tij atërore, varret e stërgjyshërve të tij, gjërat e shënjta të vetë familjes së tij dhe të shkojë për t'i kërkuar të gjitha këto gjëtkë, ku kurrë nuk do të ketë mundësi për t'i gjetur, duke vuajtur gjatë jetës: pra,

[91] N. Veqilharxhi, Letër Jani Calit më 7 prill 1846, nga Buku-reshti në Vienë.

[92] N. Veqilharxhi: «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» e «Ëveta-rit» të 1845-ës.

[93] N. Veqilharxhi «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» e «Ëveta-rit» të 1845-ës.

atë që këshillon gjëra të tilla nuk di në ç'kategori ta vendos(94).

Siç del nga zbërthimi i mendimeve të Veqilharxhit që kemi bërë më lart, në «E parthënme mbi djelmt e rij shqiptarë» gjenden elementet themelore të botekuptimit të tij. Aty shohim se ai rrezikun kryesor për vendin e shikonte në prapambetjen dhe në padijen, moralin e shikon formë të ndërgjegjes shoqërore, ka koncept demokratik popullor mbi nenshttrimin e interesit personal ndaj atij shoqëror, si dhe pikëpamje demokratike mbi arësimin e përgjithshëm. Ai shpreh pikëpamjen e tij mbi vendin që zë arësyeja, mbi evolucionarizimin dhe çfaq optimizmin e tij. Keto aspekte të botekuptimit të tij perputhen me ato që janë çfaqur në «Enciklike» dhe në «Letër për të nipin Jani Calin» dhe tregojnë që janë frut i mendimit të tij.

Keto ide të Veqilharxhit janë lidhur ngushtë me eksperiencën historike të popullit shqiptar e nuk mund të shkëputeshin prej saj. Fakti që për Naum Veqilharxhin populli shqiptar përbën një unitet me vete, pavarësisht nga përçarja fetare, një unitet të dalluar qartë mbi baza objektive si teritori, gjuha, historia, që e dallojnë atë nga kombet e tjera, takti që ky komb ka interesat e veta të dalluara prej atyre të kombeve të tjera, që kërkojnë zhvillimin e gjuhës, kultures se tij në një rrugë të pavarur nga ajo e kombeve të tjera, të gjitha këto deshmojnë se në bazën e mendimit kultural-politik të Naum Veqilharxhit qëndron koncepti i zhvillimit politik e kultural të pavarur të popullit shqiptar. Në krijimin e këtij koncepti Naum Veqilharxhi dha bazat e mendimit politik shoqëror të Rilindjes shqiptare. Rrugen që e hapu ai e vazhduan, rilindasit e tjerë të shquar shqiptare.

94) N. Veqilharxhi, — Letër Jani Calit më 7 prill 1846 nga Bukureshti në Vienë.

FUNDI TRAGJIK NAUM VEQILHARXHIT

Sikurse u tha, shkrimi i fundit që njohim nga Naum Veqilharxhi është letra drejtuar të nipit, Jani Calit, në Vjenë më 7 prill 1846. Mbi jetën dhe veprimtarinë e mëvonëshme të rilindasit të shquar nuk kemi asnjë të dhënë direkte. Për më tepër nuk dimë ku jetoi, çfarë bëri dhe kur vdiq. Ka vetëm pak lajme të tërthorta, të cilat, nga ana e tyre, kanë lënë shteg për supozime e deduksione të paargumentuara.

Në tërë shkrimet që merren me jetën dhe veprimtarinë e Naum Veqilharxhit sundon, pa përjashtim, mendimi se ai vdiq i helmuar apo i vrarë nga Patrikana e Stambollit. Kur? Dy janë përgjigjet. Një palë shkrimtarësh dhe studionjës pretendojnë se vdekja e rilindasit ndodhi menjëherë pas botimit të ëvetarëve. Eftim Brandi në librin e tij greqisht «Ankimet shqiptare» të botuar më 1880 shkruan: «Po këto ngjajtën edhe me një prej shqiptarëve të quajtur Naum Veqilharxhi *posa zuri të botonjë shkronjat e gjuhës disa vjetësh, atij i suallën ndalime dhe i mjeri me të padrejtë ra viktimë në Stamboll*» (95). Dy shkrimtarë të huaj na japin edhe datën. Sipas Th. Kapedan «Veqilharxhi botoi abetaren e tij në Stamboll dhe e vranë pas një viti (1846-M.I.) (96) kurse sipas E. Legrand «...ishte helmuar nga grekërit më 1847» (97). Disa të tjerë pohojnë se Naum Veqilharxhi është helmuar në vitet 60 të shekullit XIX. Sipas kujtimeve të Sevasti Qiriazi «...më 1866 ky patriot i madh i paraqiti memorandum Ali Pashës Sedrazemit të sulltan Azizit, që t'u japë leje shqiptarëve që

95) E. Brandi, *Alvanika Parapona*, Athinë, 1880, fq. 29.

96) Th. Kapedan, revista «Graul Rumensk», 1928.

97) E. Legrand, *bibliographie albanaise*, 1912, fq. 73-80.

të shtypin libra dhe t'i përhapin në Shqipëri»(98). Nga ana tjetër, Feim Zavalani shkruan: «...Për këtë qëllim (N. Veqilharxhi — M.I.) i paraqiti të famshmit Ali Pashajt, i cili qe kryeministër nën sulltan Azizin, një lutje me të cilën lypje privilegjin e arësimit të gjuhës sonë me letra (shkronja — M.I.) latine»(99). Për këtë flet dhe informacioni i mëposhtëm i autorit bashkëkohës me Naum Veqilharxhin Thimi Krei në «traktatet» e tij në vitin 1879 thotë «*E helmatosi patriarku në Stamboll*» (100). Një ide të tillë na jep edhe August Dozon në veprën «Manuali i gjuhës shqipe» me 1879, i cili, duke vënë vdekjen e Naum Veqilharxhit përpara 1870-ës, thotë: «Naum Veqilharxhi u farmakos nga Patrikana në Stamboll. Më 1870 këtu u formua një komision për shkrimin e shqipes, por grekërit bënë çmos dhe e ndaluan»(101). Sotir Ollani i cili, siç na thotë Kristo Luarasi në «Kalendarin kombjar» më 1900, deklaronte: «*Armiqtë grekë* nga që u zbuloi gënjeshttrat dhe dhel-përitë e tyre ç'nuk i lanë pa bërë për të ndaluar këtë burrë, më në fund e *helmuan*»(102). «*E helmuan grekët*»(103) thotë N. Naçi në librin «Korça dhe fshatrat përçark» më 1901 dhe Milo Duçi në revistën «Albania» më 1904 (104). Gazeta «Dielli» më 1912, që dilte në Boston, shkruante: «Naum Veqilharxhi, një nga më të nxehtit e më të dëgjuarit shqiptarë e ka përkrahur *mijra herë* kombin shqiptar kundra armiqve e *ma fort grekërve*» me artikuj të zjarrtë. Ky patriot i madh goditi që u sëmur kur ish *Stamboll* dhe hyri në një sëmurtore greke, atje patriku Ikumenik i Fanarit i asaj kohe, i cili e kishte mallkuar disa herë Naum Veqilharxhin «dhia tas Alvanikas antikristianikas idheas..., thonë që ja gjeti volinë... u farmakos nga shërbëtorët e spitalit...

98) S.P. Luarasi, Fletë nga historia e shkollave të para shqipe, revista «Nëndori», Tiranë 3 (1957) 155.

99) F. Zavalani, Naum Veqilharxhi dhe Naim Frashëri, revista «Përpjekia Shqiptare», 1936, fq. 101.

100) Th. Krei, traktatet, 1879.

101) A. Dozon, Manuali i gjuhës shqipe, 1879, fq. 169.

102) K. Luarasi, Kalendarin kombjar, 1900,....

103) N. Naço Korça dhe fshatrat përçark, 1901

104) M. Duçi, revista Albania, 1904,....

Shqipëria kështu humbi një nga shtyllat e saja më të mëdha... (105). Në kujtimet e veta Sevasti Qiriaz Dako për biografinë e Naum Veqilharxhit është shprehur kështu: «...Pas këtij vjeti (1866-M.I.) ne s' dëgjojmë gjë për këtë rilindas të shquar. Thonë se më parë se të nisëj për Shqipëri më 1867, që të çelte shkolla shqipe, *Patrikana* kuçedra që rron për shekuj me gjakun e bijve më të ndritur të Ballkanit, i dha fund jetës së vlefshme të plakut 69 vjeçar, duke e farmakosur në selinë e saj» (106). Edhe bashkëfshatari i Naum Veqilharxhit, folkloristi i njohur Spiro Risto Dine në «Valët e Detit» ka shkruar një vjershë në vitin 1868, vargjet e së cilës ja kushton shqiptarëve të farmakosur nga Patrikana. Në vargjet nuk zë emër me gojë, por aludon për Naum Veqilharxhin:

*«Kam fjalë me grekërinë
ç'kanë ata me Shqipërinë
Na farmakosën njerëzinë
Duallë shumë shqipëtarë
Të përmëndin Shqipërinë
I farmakosën nuk i lanë
Shqip të mësojmë nuk u vjen mirë»(107)*

Paqartësia për veprimtarinë e tij të mëvonëshme, e shkaktuar nga mungesa e dokumentacionit, na imponon t'ju referohemi këtyre mendimeve dhe informacioneve që cituam më lart dhe që do të citojmë më poshtë nga autorë të ndryshëm, shqiptarë ose të huaj. Ne do të marrim për bazë më të informuarit, më të vjetrit dhe më të interesuarit për veprimtarinë dhe jetën e këtij rilindasi të paepur për çështjen shqiptare. Mendojmë

105) Gazeta «Dielli», Boston, mass-april 4-1912

106) S.P. Luarasi, Fletë nga historia e shkollave të para shqipe revista «Nëndori», Tiranë, 3(1957)155.

107) S.R. Dine, Shqipëtarët e farmakosur prej kishës greke, në «Valët e Detit», Sofje 1908 fq. 13.

se Naum Veqilharxhi vazhdon të punojë edhe mbas vitit 1847. Në vitet 50 të shekullit XIX synimet e qarqeve të borgjezisë së madhe shoviniste greke dalin në shesh. Këto qarqe predikonin ideologjinë «paneleniste» (108), e cila po gjente mbështetje në disa elementë të borgjezisë ortodokse të Shqipërisë së Jugut. Në këtë kohë përfaqësuesi më i parë i levizjes kombëtare shqiptare, Naum Veqilharxhi filloi të riaktivizohet me me forcë dhe të bëjë një luftë të ashpër dhe plot guxim kundër propagandës armiqësore të «idese së Madhe» (Megali Idea). Për të shtypur e shumetishuar materiale dhe libra shkollore në gjuhën amtare, të përgatitura vetë dhe për të hapur sa më shumë shkolla në Shqipëri, qëllim ky i gjere dhe i veshtirë për realizimin e të cilit dëshurin shumta të mëdha financiare. Naum Veqilharxhi mendojmë t'u jetë drejtuar shqiptarëve që ndodheshin të emigruar në Hungari, Turqi dhe shtetet e tjera ballkanike e, në veçanti, pasanikeve Vangjel Zhapës dhe Apostol Arsaqit (109), ky i fundit llojë një rol më të rëndësishëm edhe në jetën politike të Hungarisë dhe të dy ishujve të njohur për shumtësi që kishin dhënë për qejllime mirëbesuese në Greqi. Për këtë supozim jemi nisur nga materiali që është botuar në gazetën e vjetër «Shqiptari», që doli në Bukuresht në vitin 1888 «...Vangjel Zhapës daroviti 25000 florina për gjuhën shqipe. Për këtë njëzet dhe Arsaqit që daroviti 10.000 florina dhe këta të dy bashkë me të pavdekurin Naum Veqilharxhin punuan për të shkruar të gjuhës shqipe, shtypen shumë kartera, të cilat, tole e shejtanit, Patrikana, i ndoqi dhe i vrau me të pabesë» (110) (e ka tjalën për Naum Veqilharxhin — M.I.). Vetëm nga ky shkrim i gazetës nuk mund të nxjerrim se në ç'vit u dhane këto

108) «paneleniste» — Borgjezia e madhe shoviniste greke dhe kleri i lartë i Patrikanës së Stambollit e propagandonin këtë ide duke u nisur nga parimi se ortodoksia ishte baza e unitetit të të gjithë botes helenishte. A. Buda, St. historike 2(1965) 55-63.

109) Enciklopedia greke — shkruan jetën e Vangjel Zhapës nga Labova e Gjrokastres dhe Apostol Arsaqit nga Hotova e Permetit.

110) Gazeta «Shqiptari», Bukuresht 23 vjeshtë e dytë, viti 1888.

shuma dhe u dhanë me të vërtetë apo jo. Ky dyshim lind në radhë të parë se shuma e premtuar është e madhe dhe, së dyti, nga që Veqilharxhi, nuk dimë deri më sot, të ketë botuar materiale të tjera. Këtë mendim na e përforcon më tepër vetë pikëpamjet që kishte ndaj arësimit Vangjel Zhapa, i cili vetëm do t'i ketë premtuar me paramendim Naum Veqilharxhit. Kur pa se Veqilharxhi nuk po hiqte dorë, por, përkundrazi, po e shtonte veprimtarinë e tij drejt zhvillimit të arësimit shqiptar në mënyrë të pavarur, jo vetëm që shumën e premtuar nuk ja kanë dhënë, por, përkundrazi, Vangjel Zhapa ka vepruar si kundërshtar i qëllimeve dhe ideve të Naum Veqilharxhit.

Po këtë taktikë ndoqi pas disa vjetësh Vangjel Zhapa edhe ndaj veprimtarisë së A. Bykut(111), i cili mendonte të hapte gjërisht shkolla fillore dhe të merrte në gjuhën shqipe, pavarësisht nga orientimet e tija drejt «helenizmit», për ato vite do t'i shërbenin çështjes shqiptare. «Në një letër të tij, të botuar në numrin e fundit të «Pellazgut»(112) milioneri Zhapa distancohej nga projektet e A. Bykut dhe bënte disa rezerva të rëndësishme në lidhje me to... Kemi arësye të besojmë se ky qëndrim armiqësor i qarqeve heleniste në përgjithësi dhe i V. Zhapës në veçanti, u bë shkak që planet e A. Bykut të shëmben dhe gazeta e tij të pushojë botimin e saj(113).

Madhështia e figurës së Naum Veqilharxhit spikat akoma më qartë në fund të viteve 50 të shek. XIX, kur midis inteligjencës shqiptare të brendëshme dhe të emigruar fillon polemika për orientimin dhe qëllimin e sistemit arësor në Shqipëri. Propagandës armiqësore

111) A. Buda, Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861, revista «Studime historike — bot. U.S.H.T. 2(1965)56-63. «Anastas I. Piqueu, ose, me emërin e vërtetë shqiptar, Anastas Byku nga Lekli i Gjirokastrës mbaroi gjimnazin e Janinës dhe shërbeu si mësues i greqishtes për disa vjet. Botoi gazetën «Ftiotis» dhe «Pellazgos». Anastas Byku në Lamia, më 1 janar 1861 nxorri broshurën «Gramë për shqiptarët».

112) A. Buda, po — këtu, më 1 janar 1860 gazeta «Pellazgos» e filloi jetën si e përjavëshme, më vonë mori emron e përngjitur «Pellazgojotis» dhe mbante nëntitullin «Shqiptari dhe Greku».

113) A. Buda, po këtu 2(1965) 60-61.

dhe kërcënimeve të përkrahësve të idesë së «hele-
nizmit», që kishin si synim përfundimtar futjen dhe
shkrirjen e popullit shqiptar në kombin grek. Veqil-
harxhi u përgjigjet me idetë e tija të shëndosha që arë-
simi shqiptar me alfabetin dhe shkollën e pavarur shqi-
pe do të pregatisë veçimin politik të popullit shqiptar
si komb më vete.

Nga polemika që shkruan «Prometeu»(114) në vi-
tin 1878, në faqen 3 rëndësi të veçantë ka se idetë dhe
veprimtaria e Naum Veqilharxhit kishte gjetur perkranje
nga shqiptarët myslimanë e ortodoksë dhe se levizja
shqiptare po krijonte një qender organizative me një
platformë deri diku të përcaktuar. «Duke polemizuar
me «Filabanistët»(115), A. Byku dhe perkrahesit e tij,
si A. Aramodni, P. Petridhi, V. Zhapa, na vene në dukje
se ky konflikt nuk është i ri. Qysh më 1857 u bë një
takim midis A. Bykut dhe një tregëtari korçar që nuk
ishte tjetër kush veçse Th. Mitkoja,... i cili nuk fliste
thjeshtesisht në emer personal si individ, por i para-
qitej A. Bykut në këtë takim të parë më 1857 «me
mburje» si «anëtar i një shoqërie filabaniste» në Stam-
boll, e cila po mblidhte të holla për libra e shkolla në
gjuhën shqipe. Për të arritur qëllimet, për të cilat për-
pëqet shoqëria...»(116). Fatkeqesisht heperhë nuk dihet
se kush ben pjesë në këtë shoqëri, por nga A. Byku

114) A. Buda, Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet
1859-1861, revista Studime Historike bot. U.S.H.T. 2(1965)56-63. «A.
Byku botoi në Athinë më 6 gusht 1878 një numër tetëfaqësh të një gazete
greqisht me titull «Pellazgu Promethe» drejtuar, siç thuhet në nëntitull,
«krerëve të politikës panheleniste». Pikëpamjet e A. Bykut kanë qënë shumë
kontradiktore. Me gjithë atë, A. Byku dhe rryma që përfaqësonte ai, ka qënë
një rrymë divergjente dhe në kundërshtim me lëvizjen e madhe të Rilindjes
sonë Kombëtare.

115) A. Buda, po këtu: me emërin «Filabanisë», «propaganduesit e
filabanizmit» A. Byku cilësonte disa përfaqësues të lëvizjes patriotike
shqiptare, ndonjë këta kishin miratuar dhe përshëndetur përpjekjet e A.
Bykut... por siç dëshmon gazeta «Pellazgos» në një varg pikash idetë e
Bykut me ato të këtyre intelektualëve shqiptarë ishin në konflikt. (Hyrye e
Gramës, «Pellazgu» 1/III/1861. Përjashtim bën A. Byku vetëm kur polemizo n
në këtë pikë «me të ndjerin» Naum Veqilharxhin («Pellazgos» 1/I/1860.
Gramë.)

116) A. Buda, po këtu, 2(1965) 62.

del Naum Veqilharxhi, si figura e inisiatorit të madh «Naum Veqilharxhit A. Byku i ngarkon fajin që e nisi i pari atë rrugën e tij «të shtrembër» («Pellazgos», 1/1/ 1860, hyrje e Gramës...(117). Për ne idetë e tija programatike hedhin dritë të qartë në rrugën historike të popullit tonë që u vazhduan dhe e ndriçuan më von rilindasit e tjerë të shquar.

Në shkrimin e A. Bykut dhe V. Zhapës në gazetën «Pellazgos»: «Më 25/11/1859 A. Byku dhe diçka më vonë edhe të tjerë, Veqilharxhin e quajnë «i ndjeri». Më 1 tetor 1860 V. Zhapa thotë se «jo para shumë kohësh diskutuam me javë të tëra me N. Veqilharxhin në lidhje me çështjen e alfabetit të shqipes (118). Ne kuptojmë se rilindasi ynë i madh në moshën 62 vjeç, në momente kritike për popullin shqiptar dhe në valën e një veprimtarie intensive për çështjen shqiptare, u bë i padurueshëm dhe i rrezikshëm për planet e qarqeve shoviniste greke, të cilat i dhanë fund jetës së tij.

Nga të gjitha këto njoftime (pohime) dhe mendime, na jepet mundësia të dalim në përfundimin se Naum Veqilharxhi i helmuar rreth vitit 1859 është dëshmor i parë i Rilindjes sonë Kombëtare.

117) A. Buda, po këtu, 2(1965) 62.

118) A. Buda, të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861, revista Studime Historike bot. U.S.H.T. 2(1965)62-63.

RËNDËSIA HISTORIKE E VEPRËS SË NAUM VEQILHARXHIT

Naum Veqilharxhi me idetë e me veprën e tij u bë ideologu i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Me emrin e tij lidhet fillimi i një lëvizje të re nacionale, e cila kishte për qëllim zgjimin e popullit nga prapambetja, zgjim që do të çonte në formimin e ndërgjegjes kombëtare për shpëtimin nga zgjedha turke. Kjo është arësyeja që më vonë idetë e tij demokratike u përqafuan nga një sërë patriotësh, të cilët lidhën fatin e tyre me atë të popullit, duke e çuar më tej punën e Veqilharxhit. Ata shihnin tek ai njeriun që kish hapur një rrugë të re për çështjen kombëtare e për këtë arësye e nderonin dhe e ruanin të gjallë kujtimin e tij.

Nuk është e rastit që rilindasit shqiptarë në Stamboll, kur bënë alfabetaren e gjuhës shqipe në vitin 1879, duke e ndjerë veten si dishepuj të këtij patrioti, në ballë të kapakut vunë si moto një strofë të Naum Veqilharxhit. Se sa e nderonin dhe e çmonin Veqilharxhin vazhduesit e rrugës së tij është kuptimplotë edhe fakti që disa prej tyre si Spiro Risto Dine, Kristo Luarasi e të tjerë çfaqnin hidhërimin e protestën e tyre për helmimin e tij nga Patrikana greke. Kështu, p.sh. Kristo Luarasi shkruan në vjershën e tij:

*«U përpoqe si dragua
Për të qitur gjuhën e vet...
Ti armiqve u zbulove
Rrënjët që kishin hedhur...»*

*Armiktë të helmuan
E gjeçin nga Perëndia
Ç'punë të keqe punuan
I përmbystë drejtësia...»*

Po kështu Sami Frashëri ruante me kujdes të madh të vetmin ekzemplar të «Evetarit» të 1843-s, kurse Spiro Risto Dine dëshmon se vepra e Veqilharxhit ishte për-

hapur deri në Trebickë, fshat i vogël në zonë të largët e të vështirë, e u shërbente të vegjëlve për mësimin e gjuhës amtare edhe pas dhjetë vjeteve të botimit.

Po ajo që tregon qartë se sa e vlerësonin Veqilharxhin rilindasit tanë, që vetë puna e tyre e mëtejshme në rrugën e nisur nga ky dëshmor i parë i zgjimit kombëtar. Naum Veqilharxhin e çmuan jo vetëm rilindasit tanë, por edhe një sërë studionjës dhe albanologë të huaj, të cilëve shumë shpejt u ra në sy alfabeti i tij i ndërtuar mbi kritere origjinale. Vetëm dy-tre vjet pas botimit të këtyre abetareve, e shohim alfabetin e Naum Veqilharxhit të figurojë midis 104 alfabetëve në botimin e A. Auerit «Die schriftzeichendes gesallten Erdcreises in 104 Alphabeten» në vitin 1847. Po atë vit V. Dorssa, në veprën e tij «Sugli albanesi» njoftonte se në Villahi është krijuar një alfabet i ri për gjuhën shqipe. Dr. Johan Georg von Hahn gjithashtu më 1854 në veprën e tij të njohur «Albanesi he studien» merret edhe me alfabetin e vithkuqarit. Një tjetër autor, Faulman, e përmend gjithashtu alfabetin e Naum Veqilharxhit në veprën e tij «Das Buch der Schrift» në 1880, f. 181-182. Në vitin 1883 paleografi i njohur L. Geitler, në veprën e tij «Die albanesischen und slawischen schriften» Vjenë, 1883, i kushton një studim të tërë rreth 30 faqesh alfabetit të Naum Veqilharxhit dhe bëri përpjekje serioze për të përcaktuar origjinën e këtij alfabeti, punë kjo me mjaft rëndësi dhe që duhet marrë në konsideratë. G. Majeri gjithashtu tregoi një interesim të veçantë për alfabetin e Naum Veqilharxhit. Në botimet e tij të viteve 1882 dhe 1891, ai përmend botimin e Naum Veqilharxhit e jep ndonjë informatë me interes për jetën e Veqilharxhit. Emile Legrand në «Bibliographie albanaise» më 1912, faqe 73-80, veç alfabetit, boton edhe dy faksimile nga botimi i dytë i abetares së Naum Veqilharxhit, të cilën, siç shënon vetë, ja kish marrë për disa muaj Sami Frashërit. Këto janë dy faqet e vetme, që njohim deri më sot nga botimi i «Evetarit» të 1845-ës.

Studiuesit e huaj nuk u interesuan vetëm për alfabetin dhe abetaret e Naum Veqilharxhit, por edhe për veprimtarinë e tij të mëvonëshme. Kështu Th. Kapedan,

A. Dozon e të tjerë dhe në veçanti profesor Viktor Papa-kostea, i cili e ka vlerësuar drejt rëndësinë e Naum Ve-qilharxhit për lëvizjen shqiptare.


Para çlirimit figurën e Veqilharxhit historiografia e shihte të shkëputur nga masat e popullit, nga luftat e përpjekjet e tyre dhe e konsideronte si njeri të madh që qëndronte mbi to. Kështu p.sh. në gazetën «Drita» të vitit 1937, në artikullin «Burri më i madh i Shqipërisë» ose në botimin kushtuar «Shkrimtarëve shqiptarë», në vitin 1941, nuk i bëhet figurës së tij një vlerësim i drejtë.

Historiografia e re e studion duke e shikuar në lidhje me gjithë zhvillimin e popullit dhe si shprehës të aspiratave të tij, sepse ai nxorri mësimin nga vuajtjet e masave, e përpunoi eksperiencën e popullit dhe formuloi idetë që i shërbenin çështjes shqiptare. Populli dhe partia e nderojnë veprën e kujtimin e tij me anën e shtypit dhe radios në raste përvjetorësh, me emision të posaçëm pullash me portretin e tij. Emrin e këtij rilindasi të shquar e mban sot një shkollë e mesme në qytetin e Korçës dhe shkolla 8-vjeçare në vendlindjen-Vithkuq.

Duke folur për kontributin e shquar të rilindasve, shoku Enver Hoxha, në mbledhjen e gjërë me shkrimtarët dhe artistët më 11 korrik 1961, ka thënë: «Ne kemi trashëguar nga e kaluara tradita fisnike, prandaj dhe partia jonë u mbrujt dhe trashëgon tradita fisnike... Patriotizmi është vija e kuqe që përshkon gjithë aspiratat, përpjekjet dhe krijimtarinë e popullit tonë dhe të njerëzve të dalluar të tij në çdo lëmë. Shpirti i flakët i patriotizmit ka udhëhequr rilindasit shqiptarë që kanë bërë vepra aq të bukura dhe aq të frymëzuara. Rilindasit, në krijimtarinë e tyre, janë udhëhequr nga patriotizmi i zjartë, nga dashuria e madhe për atdheun dhe për popullin.»

Sot Naum Veqilharxhi po studiohet në mënyrë të plotë e të gjithanëshme nga ana historike, duke i dhënë vendin e merituar në «Historinë e letërsisë shqipe» dhe në «Historinë e Shqipërisë.» Veqilharxhi konsiderohet si një figurë e shquar e historisë së popullit tonë dhe emrin e tij e kanë radhitur në krye të periudhës, që njihet me emrin Rilindja Kombëtare Shqiptare.

NAUM VEQILHARXHI
SHKRIME



E PARTHËNME MBI DJELMT E RINJ SHQIPËTARË

Më të mirën gjë që njohu e që kuptojti njeriu, ishte të mësuarit.

E po që pat kujdese e gjet, iu pushtua në gjithë shtrënguarë. E veç që me kohë duallë kaqë burra të ditur e të tërëndriçim(1); pa edhe njerëzia zunë të dalin nga t'egërit e tyre, që patnë pasur që herje, e të hapën e të thellojnë mëndjen, sindëkur duket se mbë ç'qëndrim të qytetçmë(2) arriti.

Se të mirën e çdo njeriut, q'e sjell drita e të mësuarit, s'është asnjë endëdyshme(3); Se njohëm që gjithë farët e çdo njerëzve mundohen pa reshtur si të mundënjënë të ndërtojnë e të shtojnë gjuhën e tyre edhe të mësuarit.

Po fort për të çuditur është që si ne Shqipëtarët, jemi kaqë të ndarë e të pangjajmë(4) farëvet të tjera, pa pasur fare të shkruar e të kënduar mbë gjuhë tënë. Si ka duruar kjo dora e Shqipëtarit(6) të jetë mbetur ndënë të qeshurit e botësë huaj?

Më e madheja është që si s'ka njohur shtrëngimnë që ka pasur: le që s'kanë mundur të punohen(7), duke shkruar njëri-tjetrit, mbë gjuhë të vet, po as të mundnjën t'i falenë Zotit Perëndisë mb'atë gjuhë që sicili msojti duke pirë sisën e qumështit të s'emës, si gjithë bota tjetër.(8)

1) Tërë ndriçim, shumë të ditur.

2) Të qyteçëm, të qytetëruar.

3) Ndëdyshme, dyshim.

4) Te pangjajmë: të ndryshëm nga të tjerët, që s'u ngjasin.

6) Dora, fara, raca.

7) Punohen, japin e marrin, korespondojnë.

8) Ky ishte një argument i kotë për kohën.

Fjala ime, o djem, s'është sepse s'patmë të shkruame (9) mbë gjuhën tënë, mbetmë pa shkruarë gjuhë të tjera. Dihet, se nxinim edhe punoheshim jo më mirë. Po ç'fitim, që vetëm fort pakë kishin e kanë fat e shumica tjetër dergjet nd'errësirë të padijes, e vetë dinin e njihnin se ç'hiqnin. Fare lehtë mund sicili të njohë lehsimnë(10) që ka çdo farë e njerëzve të mësonjë të mësuarit mbë gjuhë të vet. Djali sado i vogël të jetë, gjithë mundimnë e të rëndit do e ketë sa të nxërë shënimet (11) e të folmit, d.m.th. ëvet (12); pasdaj, gjuhën s'duhet ta msonjë, se e ka të lertë(13) nga mëm'e ti, e çdo fletore(14) që të marë ndë dorë, e këndon edhe e kupëton; edhe kur t'arrinjë mbë msimet të lartëra, përsëri mbë gjuhë të ti çpejt mer përpara; pasdaj po të njohë gjuhën e ti mirë, çpejt e lehtë mson çdo të huaj, po që t'u apë dorë prindërve të ti. Mbë gjith'anët e dheut diet që gjuh' e vëndit parnderjet(15) edhe është më e duhëshme, e të huajat janë vetëm për fort të pakë që kanë të bëjnë me të jashtmit, si edhe të jashtmit me tënën, po të kenë shtërngim do e msojnë. Është e tepër që të ngjatem mbë këtë, se i math i vogël e njeh; ashtu, le sicinë që ta gjykonj e ta përgjykonj nd'është kështu! Me gjithë këtë, gjat' e gjërë mund ta thërres(16) e ta rrëfenj mundimn' e mkotë(17) që kanë hequr e heqin (duke folur për gjithimjen(18) me të dhënit e të msuarit gjuhëve t'huaj. Se gjer të msojnë vetëm të këndojnë e të shkruajnë mirë, duhen dy-tri vjet; e sa të msojnë ca gjuhën, atë të huajnë, shkonin edhe aqë; e mbë ndë funt, me të hequr, nga të msuarit s'dinë fare gjë:

-
- 9) Të shkruame, gjëra të shkruara, libra.
 10) Lehsimnë, lehtësinë
 11) Shënime, shënjat
 12) Ëvet, neol. i N.V., Shkronjat Fj. e krijuar me shkronjat ë dhe v. të alfabetit.
 13) Të lertë, të lindur. Më poshtë, të lerturit për: të lindurit.
 14) Fletore, libër, Neol, krijuar prej tij e që mbet në gjuhët me kuptim radhua gazetë.
 15) Parnderjet, neol. i N.V. preferohet.
 16) Thërres, shpall, lëçis, them me zë të lartë para botës
 17) Mkotë, mëkotë, kotë.
 18) Gjithimjë, neol. i N.V., shumica.

e kjo s'është gënjeshtër, se duket. Po përsëri nukë them, për ata djem që prindrit e tyre, me të ndanjtmuarë(19), i lirin a i dërgonin djemtë jashtë vendit, me të prishmë të madhe vetëm të që msojnë. Për ata s'them se nukë msuanë. Po kush e bënte atë? Vetë kamësit(20). E djemt e skamësve mbeteshin e mbeten sikundër thamë sipër.

Gjithatë e t'atilla, o djem, duke vurë përpara syvet mi, më nxehné e më shtërnguanë që t'i hynj kësaj ndërduarçmje(21) e kësaj së nisurë(22), pa kujtuar fare mundin e të lodhur, se e dinja e e njihnja, që s'e bënj për ndonjë të mburme që të rrëfenj ndësy të njerëzve, po vetëm që të bënj e të rrëfenj detyrën që kesh e kam për vëntlermin(24) tem e për gjuhën time të mëmës

Gjuha jonë, shqipeja sindëkur e dini se, nga shumë të sjellat e të kthyerat e kohës, edhe më fort që s'ka pasur dritat e të msuarit, ka marrë shumë fjalë e kuvise(25) të huaja. Posa solla mbë shëmbull(26) ëvet sa e si duheshin për këtë gjuhënë tënë, pasdaj menjëherë, u vushë të bënj edhe gjithato fletore që duhen për djem nismëtorë(27), duke tërësjelltur(28) nga gjuhë të tjera mbë tënë. E para e punës ish që si të mund të nxjerr fjal' e kuviset e huaj, e mbë vent të tyre të dërthtonj(29) të tjera nga vetime (30) e gjuhësë. Edhe me gjithë që, he për he, munt të mos tringëllojnë ëmbël mbë të dëgjuarit e veshëve, po kam shpresë se koha do t'i ëmbëlsonjë. E ashtu, sa që munda, nxora e ndërtova të tjera mbë vënt të tyre. Save(31) që s'ua gjeta sesinë

19) Ndanjtmuarë, vendim. neol. i N.V.

20) Kamësit, pasanikët. Të varfërit i quan skamës.

21) Nderduarçmje, neol. i N.V., ndërmarrje.

22) E nisurë, inisiativa

24) Vëntlermi, neol. i N.V. vendlindja, atdheu.

25) Kuvise, shprehje

26) Shëmbëll, «Solla mbë shëmbull» parafytyrova

27) Nismëtorë, neol. i N.V., fillestarë

28) Tërësjelltur, neol. N.V., përkthyer

29) Dërthtonj, derdh, krijonj, hartonj. Neol. i N.V.

30) Vetime, vetija, natyra

31) Save, sa prej tyre

(32), i lashë ashtu, me shpresë që ju, o djem, do të mundni ta shtoni. Unë prandaj tërëtherta kaqë gjëmë kohë(33) aty e njëzet vjet, që t'u bënj veglën e ju tashti e tutje vini pëlhurën.

Mos kujtoni, o djem se këto të shkruame, që sho-hëmë që kanë kjo njerëza, janë rarë qellit. Dihet që jo. Se të gjitha janë bërë prej duarsh njerëzve me mëndje t'arrire. Edhe ndë dashi të dini përpara hem të paka edhe aqë të pambaruara (35) ishinë, sa njerëzia ahëre mezi mundnin të punoheshin me to e me kohë, pak e nga pakë, i ndreqnë e i suallë mbë këtë të mbaruar që gjëndenë.

Fletorja që dhashë vjet me këto ëve të rea për gjuhën tënë, që panë dritën e parë mbë shtambë(36), si pashë që pat të priturë të mrë nga an' e vendit tënë, edhe që gjithë Shqipërija rrëfen gas të math edhe me-njëherë nxunë të këndojnë e të shkruajnë e të punohen me to, një që më nxori nga gjithë të tremburat që me të drejtë, mundnja të keshë, e e dyta më bëri zemrë nukë vetëm edhe këtë ëvetar të ri t'ap mbë dritë, po edhe gjithatë që kam bërë gati; edhe që sa vjet i madhi Zot të më falnjë, i kam për të tërthertur duke punuar për vëndin tem e tuajnë, edhe për këtë gjuhënë tonë.

Mijë, mijë herë lëvdata pastë Zoti Perndia jonë e qiejve që mundimet e mia s'vanë më kot! S'trëmbem, o djem! Se ndo ju, ndo prindit tuaj, do e prisni më me gaz se të parën këtë ëvetar të ri, bërë vetëm për ju djalërinë. Mos i vështroni të vogëlmit të ti: Koha do t'i rrëfenjë të mathtë e të rëndit(37) të ti.

Shtërngohi të mësoni e të shtoni (38) se është e ditur që frymët e Shqipëtarëvet, veç që mëndjen e kanë të hollë e të mprehtë nga te lerturit e tyre, që munt pa frikë të them se, nukë vetëm arrijnë, po edhe shkoj-

32) Sesinë, mënyrën, marifetin.

33) Gjëmë, «kaqë gjëmë kohë», kaqë shumë kohë, Tertherta, neol. i N.V. zakrifikova.

35) Të pambaruara, të papërkryera. Më poshtë të mbaruar, përkryerë.

36) Shtambë, shtypshkronjë

37) Të rëndit, rëndësia

38) Shtoni dijen

në shumë farë njerëzve të tjerë, po edhe më tepër janë gjithë sedrë edhe dondermjës(39)

Pa andaj ushqenj shpresa të mëdha e të ndriçme, që jo vetëm të hedhëm nga vetija(40) jonë të për-qeshurit që kishim pasur nga të huajtë, që s'patnë pasur as të shkruame as ëve tona të veçme (41), po më pak kohë të hyjmë mbë radhë të botësë msuar e të qytetëruar, që hem të rrëfejmë se dora e jonë s'është e fjeçme, edhe të nderojmë veten tënë; se vetëm të msuarit e gjuhës ti nderon njerinë.

S'bëhet më e bukur gjë, kur çdo vënt e çdo gjuhë ka të shkruamet e vet. Se vetëm këtë të vini re, që, gjer sot, që, s'patmë pasur, shohëmë që, ndë pesë qint shtëpi, ja gjenden ja s'gjenden pesëdhjetë veta mbarë-prapë(42) që diç dinë të shënojnë, edhe ata mbë gjuhë të huaj. E shpërenj(43) që, me të shkuar pak vëjet, mbë pesë mijë shtëpi, s'them të gjenden një qint njerës mbë gjuhë të tyre që të mos dinë mësim, edhe ata kush e di nga ç'te lënë(44).

39) Dondermjës, neol, i N.V., që do të mbahet për nder.

40) Vetija, vetja

41) Të veçme, të veçanta

42) Mbarë-prapë, mirë-keq

43) Shpërenj, shpresonj

44) Të lënë, pakujdesi


Korçë, 22 prill 1845

ME PËRULJE VLLAZËRORE,

Me anë të zotit Naum Haxhi Vasilit, vëlla me Jorgjin, kam marrë të nderuarën letër të Zotrisë suaj dhe pashë për sa shkruanit. Gjithashtu kam marrë me anë të Zotrisë tij edhe Ëvetaret shqipe të dërguara, dhe me sa na është shkruar nga Zotria juaj, kemi bërë 1) shpërndarjen e tyre si këtu në Korçë, në tërë krahinën e saj, ashtu edhe në Përmet dhe Berat. Të gjithë i pranuan me gëzim të madh dhe me kënaqësi, duke lavdëruar dhe lartësuar të Plotfuqishmin Perëndi, që ju ka ndriçuar për t'i paraqitur në gjuhën tonë shkronja me të cilat prej aq shekujsh kombi ynë ka hyrë në histori. Tani me këtë zotësi të Zotrisë suaj të denjë për t'u lavdëruar, kombi ynë do të numërohet me këtë fillim, me kombet e ndriçuara të Europës. Mjaft më, kaq vjet, në erësirën e paditurisë, shpresojmë që brënda një kohe të shkurtër të përhapet dituria në tërë shtrirjen e atdheut tonë dhe në gjithë kombin dhe emëri i Zotrisë suaj do të mbetet i pavdekshëm deri në fund të shekujve.

Si nga letrat e Zotrisë suaj, ashtu dhe nga bashkëatdhetarët që vijnë prej andej, mësojmë me gëzim të madh se kini përgatitur dhe dorëshkrime të tjera, libra fillestare dhe vazhdimisht përpiqeni për këtë vepër të shënjtë, duke futur libra të ndryshme në gjuhën tonë shqipe që të jenë gati kur të ngrihet tipografia dhe për

1) Korçarët bëjnë fjalë në këtë letër për «Ëvetaren» e parë, të cilën Naum Panajot Bredhi — Veqilharxhi e pat shkruar në vitin 1844. ■■■■



Handwritten text in a cursive script, likely a historical document or letter. The text is written on a rectangular piece of paper pasted onto a larger page. The script is dense and difficult to decipher due to its cursive nature and some fading. The text appears to be a formal communication, possibly a petition or a report, given the use of words like "venerabilis" and "humiliter". The document is signed at the bottom right with a name and a date, though the details are obscured by the cursive and some ink bleed-through.

rrjedhim të mund të hapen edhe shkolla për përparimin e mësimit kombëtar. Për këtë qëllim kemi çelur këtu abonime (fushatë M.I.), megjithëse kombin tonë e ka pushtuar varfëria, por sipas dëshirës që kanë bashkë-atdhetarët, shpresojmë, që të mbledhen diçka pare, sepse kanë treguar të njëjtin zell dhe dritë-dashës të tjerë. Si hirësia e tij Mitropolit(2) i Krye-vendit(3) tonë, ashtu dhe të gjithë elementët haliduitori(4) më kryesor në atdheun tonë nga kombësitë e tjera(5) kanë për-qafuar me entuziazëm të madh këtë fillim të Zotrisë suaj dhe ngulmojn në të bëjnë çështje e mundur për sa i përket lehtësimit të veprës së Zotrisë suaj për ndriçimin e Kombit.

Ju lutemi zotëri, që në rast se kini Ëvetare nga ato që kini dërguar, të na dërgoni sa më shumë, sepse bashkëatdhetarët kërkojnë vazhdimisht të gjejnë akoma nga ato Ëvetare, pasi ato që dërguar u shpërndanë menjëherë. Shumë bashkëatdhetarë u paisën me këto Ëvetare, u mësuan të lexojnë e të shkruajnë, duke lidhur me korispondencë me anë letrash, sikur të ishin (Ëvetaret M.I.) një burim mrekullije, I plotfuqishmi Perëndi ju dhëntë jetë të gjatë, që të roni dhe të jeni i fortë në vazhdimin e veprës së shënjtë që kini filluar. Është për t'u çuditur zotëri, shpirti që ju ka frymëzuar Qielli i lartë, që të zgjoni dhe të ndriçoni një komb vetëm me një Ëvetare prej katër(6) fletësh, për ndihmën e mësonjesve dhe të shkollave të rregullta, (kanë mësuar të shkruajnë gjuhën amtare, M.I.) me kaq shpejtësi dhe

2) P. Pepo për këtë shkruan në revistën studime filologjike — ff/201-208 Nr. 1 viti 1966: «Këtu bëhet fjalë për mitropolitin Qirili, me origjinë nga qyteti Veria e Maqedonisë, Mitropolit i Korçës e Përmetit, prej muajit shkurt 1835 gjer në dhjetor 1845.

3) Qyteti i Korçës në këtë kohë si mitropoli, ka qenë kryeqendër fetare për gjithë krahinën e saj, duke përfshirë dhe Përmetin.

4) Haliduitori, fjalë me origjinë hungareze e futur në gjuhën rumune që do të thotë elementët përparimtarë

5) Elementë përparimtarë nga kombësitë e Ballkanit të instaluar në Shqipëri.

6) Viktor Papakostea shënon se ky duhet të jetë ndoshta një gabim i përkthyesit.

lehtësi, sa që edhe një komb tjetër mëson të lexojë dhe të shkruajë me atë lehtësi gjuhën e vet.

I respektueshëm zoti bashkëatdhetar dhe i denjë për lavdërimet më të mëdhaja, zelli i veprës së krijimit rishtaz të shkronjës shqipe nga Zotria juaj u përhap si vetëtima në gjithë atdheun tonë, dhe shpresojmë që të pastrohet sa më shpejt nga papastertia e egërsisë në të cilën lëngonte deri tashti për shkak se i mungonte literatura me anën e së cilës ndriçohen të gjithë kombet dhe arrijnë në rrugën e vërtetë të moralit.

*Nënshkruar Athanas Paskali
dhe të tjerë nga qyteti Korçë e Shqipërisë*

Bashkë me shkrimet origjinale të Naum Vegilharxhit po japim dhe letrën e Korçarëve drejtuar Naum Vegilharxhit më 22 prill 1845.

Letra është shkruar rumanisht me alfabet grek. Ndodhet në bibliotekën e Akademisë së Republikës Popullore të Rumanisë në seksionin e dorëshkrimeve. Është botuar për të parën herë nga profesori Viktor Papakostea në revistën «Balcania» Nr. 1, Bukuresht 1938, ff. 228-252 me titull «Sur l'abecedaire albanais de Vegilhardji». (Mbi abetaren shqiptare të Vegilharxhit). Përkthimi shqip është bërë nga shoku Theodor Papapavlo sipas transkriptimit që i ka bërë historiani rumun V. Papakostea. Letra është nënshkruar nga Athanas Paskali nga fshati Koblarë i rrethit të Përmetit, në atë kohë sekretar i mitropolisë së Korçës, në emrin e vet dhe të qytetarëve korçarë.

më 7 prill 1846, nga Bukureshti
në Vienë

JANI CALIT

Mora letrën tënde të 6 marsit nga Vjena dhe menjëherë pas përshëndetjes sate, shoh se ke filluar të më qash hallë keq, sepse punët me të cilat merrem dhe që ti i di, më sjellin dëm edhe material edhe moral. Më poshtë më ke bërë fajtor pse kam njohje dhe miqësi me Dhimitër Marinin, të cilin ti e neverit si të çkishëruar, duke u shprehur me habi të madhe dhe me tri pikëçuditëse!!! — Ti pastaj çuditësh, duke thënë cila vallë nga Mirat(1) deshi që të mos dalë ndonjë tjetër, por xhaxhai im shumë i shtrenjtë, për të lidhur ato që s'lidhen, të sjellë në formë ata që nuk kanë formë, të bashkojë në një tufë myslimanët fanatikë, të krishterët orthodoxë supersticiozë, papistët që urrejnë fetë e tjera, të krijojë një trup homogjen nga kombi shqiptar. «Mallkoj atë orë, xhaxhai im i nderuar, kur ju u dhatë pas një ideje të tillë himerike. Me gjithë këtë le të ndjekim fjalën e urtë italiane.

Meglio tardi Che mai (më mirë vonë se kurrë). Ç'u bë, u bë, mori fund, po dhe në t'ardhmen hiqni dorë nga planet që nuk mund të realizohen, duke përbuzur lajkat e të huajve, besoni në fjalët e nipit tuaj, i cili ka informata...»

Duke i shkruar fjalë për fjalë vërejtjet dhe këshillat e tua, po përgjigjem me të njëjtën radhë, siç janë pa-


1) Në mitologjinë greke *Mirat* janë tri perëndeshat që e përcaktojnë fatin e njerëzve.


rashtruar dhe në letrën tënde. Dhe, së pari, kujtoj se dëmtim material pëson ai që sheh dëm sidomos në trup të tij, por një dëm të tillë e pësojnë pa përjashtim të gjitha krijesat organike të krijesit në tokë. Pra, as edhe ti vetë, me gjithë përpjekjet e tua, nuk ke për të shpëtuar nga një dëm i tillë. Po në qoftë se ti me këtë kupton, pa i përdorur mirë fjalët, dëmin e pasurisë së tundëshme dhe të patundëshme, akoma ca më keq; sepse këto të gjitha nuk bëhen kurrë pronë e përherëshme e askujt dhe, në qoftë se nuk do të rronjë në një shoqëri njerëzore, do të mund të rrjeshtonje shëmbëlla të panumurta të vjetra e të tanishme njerzish të panumërt, të cilët, duke e quajtur veten të sigurtë nga të gjitha prapësitë e fatit, u bënë menjëherë fare të varfër, dhe të tillë ke jo vetëm tregtarë të mëdhej, por edhe mbretër; edhe ti e konsideron veten në siguri — sheh ëndra o nipi im(2). Nuk dini çdo të pjellë dita e nesërme. Kjo është një e vërtetë e përjetëshme.

Së dyti, dëmtim moral pësojnë në përgjithësi njerëzit që i sjellin dëm shoqërisë dhe të tillë janë ata që dëmtojnë familjet dhe shoqërinë, si gënjeshtarët, batakçinjtë, çprishësit, turbulluesit, vjedharakët, hajdutët... dhe të tillë a do të mësohesh, o nipi im, cilët janë? Ata që e kanë përqëndruar të gjithë vëmendjen në veten e tyre, duke mos treguar asnjë interes për të tjerët. Këta, duke e kuptuar keq fjalën interes, përdorin çdo mjet të lejuar dhe të palejuar vetëm për të shtuar dhe për të grumbulluar ergjënd dhe ar, që t'i kenë gati mjetet e çprishjes. Unë pra, me punën time kujtoj se nuk mund të vihem në radhën e të tillëve, ndryshe të gjithë ata që para meje pak a shumë kanë qenë çpikës shkronjash, do t'u kenë sjellë dëm kombeve të tyre: si shembëll Thefshi i Finikasve, Kadmi i Tebanëve, Pallamidi i Peloponezëve, Qirili i Sllavëve...

Së treti, më bëre fajtor se kam lidhje me Dhimitër Marinin si njeri i lik, po në botë krejt të liq janë ata që u përmendën më lart, kurse ata që rastësisht, për shkak të ndonjë rrethane të pashmangëshme, kanë humbur

2) Këtu fjala *nip*, do të thotë nip motër





gjëmbave mbyten nga barërat e tjera, kurse ato që bien në tokë të mirë dhe pjellore japin 100 për një dhe dhjetë mijë për njëqind, dhe kështu çdo gjë, duke u përmirësuar doradorës, bëhet e plotë.

Fjala kur dëgjohet nga krerët e nga truzbrazëtit përbuzet dhe shkelet, si fara e rënë në rrugë nga udhëtarët, kurse (kur dëgjohet) nga ata që janë mpleksur me punët e jetës dhe me kotësitë e botës, nuk rritet si dhe fara e rënë midis barnave dhe gjëmbave, duke u lënë mënjanë nga shkaku i zhurmës së madhe dhe të shumtë të atyre që kujdesen për gjëratë pavlefëshme e të kota; mirëpo (kur dëgjohet) nga ata që kërkojnë mirëqenien e përbashkët të atdheut të tyre, e pranojnë, e analizojnë, e zbatojnë në veprimet e jetës së tyre duke arritur me kalimin e kohës dhe me durim, në kulmin e lavdisë dhe të fuqisë.

Kështu kanë filluar para nesh të gjithë udhëheqësit e kombeve, punët e të cilëve ishin shumë më të vështira për t'u realizuar se sa e imja. Ata morën përsipër riformimin rishtaz të një kombi të ri, kurse unë përpiqem vetëm të bëj të shkruhet gjuha e Kombit, jo siç e përshekruan ti, keq. Duket se nuk e kënduar kurrë historinë e fisit njerëzor që të shohësh se kurrë kombet nuk kanë filluar menjëherë, por njëri ka filluar pardje, tjetri dje, tjetri sot dhe tjetri nesër; fundi i fundit një ditë do të fillojë edhe ky. Kur shikon përparimin e kombeve të tjera dhe gjëndjen e kombit tonë shqiptar sot, mos vallë dëshpërohesh? Dhe përse? Cili komb mbiu menjëherë i madh, i fortë, i ditur, i lavdishëm?

Ti më qan hallë se jam i frymëzuar nga një *Mirë* e xvetësuar, duke shtuar dhe në çdo pjesë shqipe dhe një epitete: *çpërfolesë*; por, unë të përgjigjem me epitetet «fanatikë, supersticiozë, urrejtës i dogmave të tjera», sigurisht që shprehin esencën, por veçorinë e fituar më vonë të esencës. Dhe çdo veçori e fituar me vonë është dhe e ndryshueshme. Pra, kush mund të na sigurojë se këto do të mbeten vazhdimisht në jetë të jetëve të pandrequra? Asnjëri! Unë pra prisja nga ti të marrësh për këtë udhëzime të shëndosha dhe jo marrëzira. O nip! vetëm kafshët, që nuk gjykojnë, e kanë të

përcaktuar nga vetë natyra edhe fatin, edhe jetën e tyre; kurse njeriu ka një destinacion, të cilin mund ta arrij veçse duke filluar të ecë gradualisht nga gjërat më të vogla. Në natyrën njerëzore nuk shihen kërcime, por rregull gradual. Kështu pra njerëzit, duke marrë për ditë ato më të mirat dhe duke hequr mënjane ato që s'vlejnë, ecin përpara duke u përmirësuar. Prandaj, në rast se sipas idesë tënde, kombet do të kuptoheshin me këtë mënyrë, kurrë gjatë shekujve nuk kishin për të dalë nga gjëndja e tyre e egër dhe për këtë ke siguri matematike, siç e provon fjalën time dhe historia e të gjitha kombeve. Pra «Meglio tardi che mai» kështu zbatohet dhe spjegohet.

Ti, siç më thua, ke lexuar shumë historianë dhe për shqiptarët nuk ke gjetur as gjënë më të vogël. Ti, të gjitha studimet e tua i bërë në shkollat greke, të cilat janë organizuar për të ndriçuar rininë greke dhe jo për ndriçimin e kombit shqiptar; por ti, si një burrë me arësim, si nuk e kape idenë nga krahasimi i të gjitha kombeve të tjera, që një komb si ai shqiptari, i krijuar në të njejtën kohë me kombet e tjera, që zë një vend të caktuar në tokë, që ka tipare të veçanta të gjuhës, të dogave dhe zakoneve, si ishte e mundur të mos kish dhe dy shekujt e tij mitologjikë, heroikë, politikë dhe fetarë, të shpërnguljeve dhe të rivendosjeve të tij? Por u besove trashë e trashë mësuesve të tu, se që nga të gatuarit e njeriut dhe gjer tani ky komb paska qenë një gur anorganik, i mbetur në paveprimtari të plotë ose si një larvë insektesh, e cila nuk ka pësuar ende metamorfozën e saj natyrore si flutur. O nip, të gjitha këto pa tjetër duhet ta kishin prekur fantazinë tënde, të kishin vënë në lëvizje kërshtërinë tënde, kjo do të ishte e mjaftë që të arrije në zbulimin e një thesari të madh kombëtar. Po të tillë janë pothuaj të gjithë ata që kanë bërë studimet e tyre me shkronja të kombeve të tjera, para se të përgatiten në gjuhën e kombit të vet.

Nejse ashtu qoftë! Për shqiptarët ti nuk ke gjetur as gjënë më të voglën te asnjë historian, por kjo nuk do të thotë që nuk bëhet ndonjë fjalë për shqiptarët si të parëndësishëm; kjo vjen nga se ti nuk di, dhe

për pasojë mosdija për një gjë nuk do të thotë se kjo nuk ekziston.

Unë, ndonëse nuk mendoj të jem një filolog aq i thellë, me gjithë këtë po të përmend se për shqiptarët kanë shkruar anglezi Masi, italiani Josif Krispi, gjermani Ksilander, siciliani Videra, kalabrezi De Rada. Dhe gjer tani njihen tri sisteme alfabeti: njeri me 33 shkronja greke, tjetri me 29 latine dhe i treti me karaktere të veta. Në qoftë se bëhesh më kërkimor, këto mund t'i gjesh në një bibliotekë të atjeshme për t'u informuar se mosdija jote nuk do të thotë që këto nuk ekzistojnë.

Pastaj më këshillon që të ruhem nga këshillat e të huajve dhe nuk ka këshillë më të keqe nga ajo që e shtyn njeriun të mohojë kombin e vet, d.m.th. prindërit e tij, farefisnin e tij, miqtë e tij, bashkëkombasit e tij, vetë vatrën e tij atërore, varret e stërgjyshërve të tij, gjërat e shënjta të vetë familjes së tij dhe të shkojë për t'i kërkuar këto te gjitha gjetkë, ku kurrë nuk do të ketë mundësi për t'i gjetur, duke vuajtur gjatë jetës: Pra, atë që këshillon gjëra të tilla, nuk di në ç'kategori ta vendos.

Unë, i dashur nipi im, mund të zgjatesha më shumë akoma dhe të të bënja më shumë sqarime, por kujtoj se edhe këto janë të mjafta, nga të cilat kuptohet edhe pikëpamja ime edhe sistemi im, a është një ëndërrim i thjeshtë, apo ka edhe ky bazat e tij duke pasur për të ardhmen të mirat e tij që shpresojmë.

Të uroj shëndet, mos pusho të duash xhaxhanë tënd, i cili është i gatshëm të dëgjojë këshillat e tua, dhe nga këto do të zgjedhë gjithnjë, vetëm të dobishmet.

Tekstin e letrës për të nipin Jani Calin, që po japim, e kemi marrë nga botimi i P. Pepos dhe S. Maslev. «Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgare-shqiptare gjatë shekullit XIX në Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës Seria «Shkencat shoqërore», Nr. 2, fq. 196-214, — Tiranë, 1961

LETËR ENCIKLIKE PËR TË GJITHË TË PASURIT E TË MËSUARIT ORTHODOKSË SHQIPTARË

Patriotë!

Po i këshilloj bashkatdhetarët tanë, që e duan mëmëdhenë, që ta vështrojnë me kujdes një studim të ri filologjik, i cili u shkrua dhe u botua nga gazetatat greke, si një vepër që meriton vëmendje shumë të madhe, aq më tepër pasi kjo ka lidhje me shqiptarët.

Ne, nga shkak i dyndjeve të ndryshme që kanë ndodhur njëra pas tjetrës rreth 2000 vjetëve me atdheun tonë, arritëm në një gjëndje aq të mjeruar sa që u shëm-tua krejt qenia jonë morale dhe politike, e cila, e krahasuar me atë të kohës së vjetër, nuk ka asnjë ngjasim të natyrshëm. Invadime shumë të shpeshta, përmbysje të tëranëshme, ndryshime politike, hyrje dogmash të reja fetare — ja shkaqet e transformimit tonë moral të tanishëm dhe sidomos lënia pasdore e lërimit të gjuhës sonë kombëtare dhe zëvendësimi i saj me një gjuhë të huaj, na suallë në gjëndje më të ultë të turp-it, sepse kështu u ngul për gjithmonë padituria e kombit, u përhap me të shpejtë barbarizma dhe, pa e kuptuar, vargojt e robërisë sonë u bënë të çelnikët. Dhe sa nga tanët patën fatin që gjatë epokave të ndryshme të marrin arësim, detyroheshin pa dashje të mërgohen në vende të tjera, të bëhen të pavlefshëm për kombin tonë, nga që nuk njihej gjuha jonë kombëtare, larg prindërve, farefisit dhe miqve, për të gjetur mundësinë e jetesës, duke u fërkuar me disa kombe të tjera dhe duke u afruar me ta, duke bashkëpunuar dhe duke ndihmuar, me aftësitë e tyre, për lumturinë e këtyre kombeve; e kështu kënaqeshin të quhen grekë, helinë, vllahë.....

dhe jo mirëbërës, etër e mësues të atdheut dhe të kombit tonë.

Duke parë përparimin e disa kombeve të sotme dhe gjendjen tonë të tanishme, jo vetëm që nuk duhet të humbasin shpresën, por bile duhet të mbushemi me hov dhe guxim. Le të hedhim farën e mirë dhe me siguri vetë natyra e shenjtë e ngjarjeve do të ndihmojë për gjallërimin, mbirjen dhe rritjen e saj, pemët e bukura dhe shumë të ëmbla të së cilës do t'i korrë padyshim brezi i ardhmë, që do të bekojë ata bujq dhe ata mbjellës të mirë; kjo është detyrë e domosdoshme, që duhet të bëjë çdo njeri mbi tokë për brezin e ardhmë, siç punuan për të dhe gjithë shekujt e kaluar. Në qoftë se ata që kanë qënë para nesh nuk do të kishin kujdes për gjendjen tonë të lumtur, edhe sot do të jetonim si egërsirat. Të gjitha të mirat e gjendjes sonë të tanishme i kemi nga paraardhësit tanë. Bujqësia, ndërtimi, tërë industria, politike, feja, mekanika, gjithëfarë artesh të bukura dhe shkencash, të gjitha këto në fillim me shumë të meta dhe pastaj duke u përmirësuar dalëngadalë iu dorëzuan brezit tonë, në gjendjen e sotme. Prandaj, edhe secili duhet të veprojë duke i imituar ata.

Mbi këto, pa çpikjen e shkrojave dhe të tipografisë, të gjitha do të ishin ende në gjendjen e tyre foshnjore. Me anën e shkrimit ne mirremi vesh me të gjithë banorët e botës, kumtojnë mendimet tona, lidhim marrëdhënie sipas rasteve, pa të cilat jeta do të ishte e pamundur. Por, çdo komb, siç është shumë e natyrëshme, me anën e shkrimit dhe të gjuhës së tij, ruan edhe lavdinë e pronësisë së zbulimeve, të perfeksionimeve dhe të kontributeve të tij në shoqërinë njerëzore; kurse ato kombe që mbetën në padije, u shëmbëllejnë thjesht skllëvërve, duke punuar çdo ditë për begatinë e kombeve më të qytetëruara dhe më të fuqishme; këto vetëm atëhere do të mund të dalin nga gjendja e turpëshme e mjerimit të tyre, kur do të fillojnë të lërojnë gjuhën e tyre kombëtare; mirëpo kjo nuk fitohet ndryshe veçse me shkronja të posaçme kombëtare, gjë që është filluar para meje, por që për shkak të përzjerjes me të huaj dhe të intrigave të ziliqarëve, të gjitha mbetën pa fryt.

Erdhi koha pra t'i mbyllim veshët tonë për të gjithë ata që me pretekstin e miqësisë dhe të maskave të tjera të panumërta paraqiten dhe na këshillojnë të kundërtën, kinse për të mirën tonë, kurse qëllimi i tyre kryesor është të na mbajnë për gjithnjë në mjerim, që kështu të na përdorin si të duan, si gjer tani. Është koha të hedhim poshtë të gjitha paragjykimet e vjetruara, është koha të mbledhim veten dhe të gjykojmë më me pjekuri dhe më me burrëri, të ndërrojmë taktikë, duke marrë që tani e tutje si shembëll kombet e përparuara të botës. Dhe kështu një ditë edhe ne, me vullnetin e Perëndisë, shpresojmë të vihem në radhën e kombeve të qytetëruara. Duke pasur parasysh këtë gjë në radhë të parë, le të shkojmë përpara me ballë hapur, me guxim, me durim dhe me këmbëngulje.

— Letra u shkrua greqisht. Një riprodhim i saj ndodhet në Arkivin Qendror Historik të Tiranës (Nr. 601040). Tekstin që po japim e kemi marrë nga botimi i P. Pepos dhe S. Maslev «Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgare-shqiptare gjatë shek. XIX» (në Buletinin e Universitetit Shtetëror të Tiranës — Seria «Shkencat shoqërore», Tiranë, 2(1961)196-210

BIBLIOGRAFIA

I. Veprat origjinale të Naum Veqilharxhit.

- Veqilharxhi N.** — *Fort i shkurtër e i përdorshim Ëvëtar shqip. Për çdo sivilë që do të mponjë të kënduarit e të shkruarit bukur shqip.* Mot i parë 1844.
- » » — *Fare i ri Ëvëtar shqip për djelm nismëtarë nxjerrë edhe mbë dritë herën e parë për djelm të vegjël me një të zgjidhur nga disa gjë të mirash e të fitimëshme.* Moti i dytë 1845.
- » » — *E parthënme mbi djelmt e rinj shqiptarë në Ëvetarin e vitit 1845.*
- » » — *Letër enciklike për të gjithë të pasurit e të mësuarit orthodoksë shqiptarë.*
- » » — *Letër drejtuar Jani Calit më 7 prill 1846, nga Bukureshti në Vienë.* (Të dy dokumentat si Enciklika dhe letra për të nipin janë ruajtur në dy kopje në fondin e arshivave të Dr. Ivan Seliminskit, arshivë ed. 3.I.58-61 dhe 1.191-193, këto janë përmendur nga P. Çiljevi në radhorin e dorëshkrimeve letrare, librave dhe dokumentave të tjera të Dr. Ivan Seliminskit, që ndodhen në Ministrinë e Arësimit në bibliotekën e Dr. Ivan Seliminskit libri I, Sofje, 1904, f. 25 e 27)

II. Literaturë e përgjithëshme për Naum P. Veqilharxhin.

- Marks K.** — — Veprat, botimi i parë rus. vëllimi X
- Engelsi F.** — —
- Hoxha E.** — — Gazeta «Drita» 6 gusht 1961.
- — *Letra drejtuar Naum P. Veqilharxhit më 22 prill 1845 e nënshkruar nga Thanas Paskali dhe të tjerë nga qyteti Korça e Shqipërisë — (rumanisht), botuar në revistën «Balcania», Bukuresht 1938 Nr. 1.*
- — *Alfabetarja e Stambollit 1879*
- — *Alvanika Paraqona, Athinë 1880.*
- Brandi E.** — — *Hronografia tes Epeiron, vëll. II, Athinë 1854*
- Aravantinos P.** — —
- Auer I. A.** — — *Oie Schriftzeichen des gesamten Erdkraisens in 104 Alphabeten — 1847*

- Baia V.** — *L'dhëe kulturore Shqiptaro-Rumune*, — Buletini shkencor — Shkodër 1964.
- Bubani Gj.** — *Thërime ari*, Shqipëria e Re, 29.7.1923, Nr. 3
- Buda A.** — *Dokumenta për t'i shërbyer historisë së marrëdhënieve të popullit shqiptar me popujt fqinjë të Jugosllavisë* Buletini i shkencave shoqërore, 1948, Nr. 2-3.
- » » — *Traditat e miqësisë midis popullit shqiptar dhe popullit të madh rus*, Buletini i shkencave shoqërore 1955, Nr. 2.
- » » — *Të dhëna mbi lëvizjen kombëtare shqiptare në vitet 1859-1861*, revista Studime historike, bot. U.S.H.T., 1965, Nr. 2.
- Cabidan I. Th.** — Graüel Rumens 1928.
- » » — Les Macado — Roumanines Bucarest 1937.
- Deda B.** — *Dy fletë të historisë së mendimit pedagogjik shqiptar* Arësimi popullor 1963, Nr. 2.
- Dine S.R.** — *Shqipëtarët e farmakosur prej kishën greke*, në Valët e Detit, Sofie, 1908.
- Dorssa. V.** — Su gli albanesi 1847.
- Dozon. A.** — Manuel de la langue chipe di albanaise — (1878)
- Faulman** — Das Buch der Schrittr — Wienë 1880.
- Fotino J.** — Një histori e kryengritjes së vitit 1921.
- Frashëri K.** — *Mbi fillimet e lëvizjes kombëtare shqiptare*, konferenca e parë e studimeve albanologjike, Tiranë 1965.
- Fullani Dh.** — *Naum Veqilharxhi*, në — Letërsia e jonë, Tiranë 1952, Nr. 12.
- Dr. Geitler L.** — Die albanesischn und slavischen Schriften Wienë 1883 (Shih Petrotta).
- Dr. Hahn J.G.** — Albanesische studien Jena 1854.
- Haxhihasani A.** — *Disa ngjarje të viteve 1830-1845 dhe ushtrime e tyre në folklor*, nëndori 1955, Nr. 9.
- Historia e letërsisë shqipe, Vol. II, bot. U.S.H.T. 1960.
- Historia e Shqipërisë, Vol. I, bot. U.S.H.T. 1959.
- Historia e Shqipërisë, Vol. II bot. U.S.H.T. 1965.
- Irmscher I.** — *Shqiptarët në themelimin e shtetit grek* Konferenca e parë e studimeve albanologjike Tiranë 1965.
- d'Ystria. D.** — «Gli albanesi in Romania, Firenze 1873.
- Jorga. N.** — Historia des étata balcaniques a l'époques moderne Bucarest, 1914.
- Kodiku i Mitropolisë së Korçës dhe Selasfarit (dorëshkrim. A.H.J.N.G.J.T. traskriptuar nga origjinali greqisht Pepo P.)
- Kodra Z.** — *Dashuria për atdhe të rilindasit*, Letërsia jonë 1950, Nr. 4.
- Kristanov I.,** — Dr. Ivan Seliminski, Akademja e shkencave bullgare
- Pankov, Mas'ev S.** — So je 1962.
- Kurilla-Lavriotis E.** — Grigorios Argirokastritis, Athinë, 1935.
- Legrano. E.** — Bibliographie albanaise 1912.

- Lik. W.** — Travels in Northern Greece, London 1835.
— *Letërsia fetare e bektashinjve*, në Buletinin e shkencave shoqërore 1955 Nr. 2
- Luarsii S.P.** — *Fletë nga historia e shkencave të para shqipe*, revista nëndori 1957, Nr. 3.
- Mile L.K.** — *Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes sonë (1830-1870)* 1962.
- Myderizi O.** — *Letërsia shqipe në alfabetin arab*. Buletini shkencave shoqërore 1955 Nr. 2
- Nikolla N.** — Korça dhe fshatrat përçark, Sofje 1901.
- Papacostea V.** — *Sur l'abécédaire albanais de Vechilhardji*, Balcania I, Bucarest 1938.
- » — *La participation de l'écrivain albanais Vechilhardji a la Revolution de 1821*, në rev stën Balcania, VIII, Bucarest 1945
- Pepo P.** — *Fletë nga historia e marrëdhënieve miqësore bullgaro-shqiptare gjatë shek. XIX*, buletini U.S.H.T. Seria shkencat shoqërore Tiranë 1961 Nr. 2
- Maslev. S.** — *Një letër e korçarëve e vitit 1845, dërguar N. Veqilharxhit* Studime filologjike, Tiranë 1966, Nr. 1
- Pepo P.** — *Një letër e korçarëve e vitit 1845, dërguar N. Veqilharxhit* Studime filologjike, Tiranë 1966, Nr. 1
- Pollo S.** — *Mbi formimin e kombit shqiptar dhe lëvizjen nacionale shqiptare*, Buletini shkencave shoqërore Tiranë 1959 Nr. 2.
- Qafëzezi I.M.** — *Një histori të pedagogjisë dhe të kulturës në Shqipëri (1637-1902)*, në *Dhaskal Gjoka, Korçë* 1936.
- Surla E.** — *Epiri gjatë sundimit turk, Athinë* 1937 (përkthim dorëshkrim pranë A.H.I.H.G.J.T.)
- Shuteriqi Dh.S.** — *Anonimi i Elbasanit shkrimi shqip në Elbasan në shek. XVII-XIX dhe Dhaskal Todhri*. Buletini i shkencave shoqërore 1949 Nr. 1.
- » — *Bibliografia e letërsisë së vjetër shqipe*, Buletini shkencave shoqërore 1962 Nr. 1, 2, 3, 1963 Nr. 1.
- Shkodra Z.** — *Një dokument i ri që hedh dritë mbi disa aspekte të historisë politike shoqërore të vendit tonë në shek. XIX*, Buletin shkencave shoqërore 1967 Nr. 1.
- » — *Zhvillimi tregëtisë në Shqipëri në shek. XIX*, Buletin Shkencave Shoqërore, 1955 Nr. 1.
- Todorov N.** — Filiqi Eteria dhe bullgarët.
- Ubcini I.A.** — L. Univers, Historia et description de tous les peuples. Provinces Danubiennes et Roumaines.

III. Shtypi.

- Arbënia, viti 1937
- Dielli, gazetë — ca shënime për shqiptarët dhe për gjuhën shqipe, Boston — 1912, Nr. 4
- Dituria viti 1927
- Drita gazetë, burim më i madh i Shqipërisë 29.8.1937

- Gurra M.S.** — *Naum Veqilharxhi nga Vithkuqi i Korçës*, gazeta «Bashkimi i kombit», viti II, Nr. 16.
 — Kalendari kombiar, viti 1900
 — Kalendari kombiar, viti 1902
 — Kalendari kombiar, viti 1903
 — Kalendari kombiar, viti 1905
 — Kalendari kombiar, viti 1906.
- Konica F.**
Luarasi K. — *Nga shqiptarët e parë të Rilindjes shqiptare*, revista «Ylli i Mëngjezit», 1918.
- Myderizi O.** — *Kush është propagandisti i Rilindjes sonë kombëtare*, gazeta Populli, 18.I.1923.
 — Revista Opinga, *shkrimi shqip*, 1920, Nr. 1.
 — Revista Ora, *Kënga e Thanas Pipit nga Vunoj që luftoi në Vllah më 1820*, 1929-18 gusht.
 — Revista Pandhora, 1860.
- Qafëzezi I.M.** — *Shkrimi, këndimi i abetares së gjuhës shqipe*, në gazetën Drita, Sofie 18.XI.1903.
- Shuteriqi Dh.S.** — *Shkrimi shqipes dhe shkolla në bregdetin e Himarës gjatë shekujve XVII, XVIII*, gazeta Mësuesi, 28.VI. dhe 5.VII.1963.
- Zavalani F.** — *Naum Veqilharxhi dhe Naim Frashëri*, revista Për-pjekja shqiptare, 1936.

PËRMBAJTJA

	Faqe
Hyrje: Gjëndja e Shqipërisë në 30 vjetët e parë të shek. XIX.	7
Rinia e Naum P. Veqilharxhit — Pjesëmarrja në revolucionin e vitit 1821	13
Veprat.	35
Mendimet arësimore-kulturale dhe politike.	62
Fundi tragjik i Naum P. Veqilharxhit	79
Rëndësia historike e veprës së Naum Veqilharxhit.	86
Naum Veqilharxhi: Shkrime	89
Bibliografia	128

40895

LIBRARI I SHKOLLËS
SHKOLLËS